



PYETJET

E FËMIJËVE RRETH BESIMIT



Abdullah er Rakaf

Pyetjet e fëmijëve rreth besimit

Abdullah er Rakaf



ح) جمعية الدعوة والإرشاد وتوعية الجاليات بالربوة ، ١٤٤٣ هـ

فهرسة مكتبة الملك فهد الوطنية أثناء النشر

الركف ، عبدالله حمد عبدالعزيز
أسئلة الطفل الإيمان بالغة الألبانية. / عبدالله حمد عبدالعزيز
الركف ؛ مركز اصول -. الرياض ، ١٤٤٣ هـ

١٥٣ ص ؛ .سم

ردمك: ٩٧٨-٦٠٣-٨٣٥٢-٣٣-٥

١- التربية الإسلامية أ.مركز اصول (مترجم) ب.العنوان

١٤٤٣/٤٣٧٤

ديوي ٣٧٧،١

رقم الإبداع: ١٤٤٣/٤٣٧٤

ردمك: ٩٧٨-٦٠٣-٨٣٥٢-٣٣-٥



This book has been conceived, prepared and designed by the Osoul Centre. All photos used in the book belong to the Osoul Centre. The Centre hereby permits all Sunni Muslims to reprint and publish the book in any method and format on condition that 1) acknowledgement of the Osoul Centre is clearly stated on all editions; and 2) no alteration or amendment of the text is introduced without reference to the Osoul Centre. In the case of reprinting this book, the Centre strongly recommends maintaining high quality.

+966 11 445 4900

+966 11 497 0126

P.O.BOX 29465 Riyadh 11457

www.osoulcenter.com

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!



Hyrje

Të gjitha lavdërimet i përkasin Allahut, Zotit të botëve! Paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin për Profetin më fisnik dhe të Dërguarin më të mirë, Profetin tonë Muhamedin ﷺ, si dhe mbi gjithë shokët dhe familjen e tij!

Natyrisht, vitet e para të fëmijërisë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e vizionit të fëmijës për ekzistencën, me ç'rast botëkuptimet të cilat mbillen në mentalitetin e fëmijës gjatë kësaj faze llogariten si blloqet themelore të cilat më vonë do ta ndërtojnë personalitetin e njeriut në të gjitha aspektet, andaj ato duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesat psikologjike, sociale dhe shpirtërore (fetare) që i ka fëmija. Ato janë të rëndësishme në ndërtimin e plotë të fëmijës, duke e ndihmuar atë që të niset me këmbëngulje për t'i kaluar me sukses peripecitë e jetës, për të vazhduar më tutje nëpër shtigjet e saj si një person i balancuar, produktiv dhe aktiv. Fëmija e ndërton modelin e tij personal të kësaj bote përmes asaj që sheh dhe dëgjon, duke bërë që çdo gjë që mbetet pas kësaj, prej jetës së tij, s'është tjetër veçse proces i gdhendjes dhe përmirësimit të këtij vizioni esencial, varësisht prej rrethanave nëpër të cilat ai kalon.

Në të vërtetë, burimi informativ në të cilin fëmija mbështetet gjatë kësaj periudhe janë prindërit e tij; ndaj vend-mbjellja dhe vend-formimi i mirëqenies së fëmijëve është mirëqenia e edukimit të prindërve, pasi ata janë përgjegjësit kryesorë për mësimin e fëmijëve të tyre. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, ka thënë: *“Të gjithë ju jeni barinj dhe secili është përgjegjës për tufën e tij.”*⁽¹⁾ Kjo përgjegjësi i obligon ata që të jenë të përkushtuar dhe të zellshëm në edukim dhe mësim.

Duke qenë se po jetojmë në një epokë kur pasimi i qejfeve dhe përhapja e dyshimeve janë shtuar, prindërve u bëhet obligim që të përpiqen me zell të madh rreth edukimit të fëmijëve të tyre, me një përpjekje të mbushur me seriozitet, vullnet dhe shpenzim i të gjitha

mundësive, ngaqë ndoshta një farë e mbjellë nga prindërit në shpirtrat e fëmijëve rezulton në punë të vazhdueshme në llogari të prindërve pas largimit të tyre nga kjo botë, duke u shndërruar fëmija në vepra të vazhdueshme, mirësia e të cilave vazhdon pas vdekjes, siç ka thënë Profeti ﷺ: *“...ose një fëmijë të mirë i cili lutet për të.”*⁽²⁾

Fëmijët janë prej amaneteve të Allahut Lavdiplotë për prindërit, andaj i Lartësuari ka thënë: **“Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj...”** (Kuran, 4:11). D.m.th.: o ju prindër, vërtet fëmijët tuaj janë pasuri që u është lënë amanet, Allahu ju ka bërë mbikëqyrës të tyre, ashtu që të veproni për të mirën e tyre në këtë dhe në botën tjetër, t’i mësoni dhe t’i edukoni ata, t’i pengoni ata nga gjërat që iu bëjnë dëm atyre, t’i urdhëroni ata që t’i binden Allahut dhe të jenë të devotshëm në vazhdimësi; siç ka thënë i Madhëruari: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!”** (Kuran, 66:6). Pra, fëmijët qenkan amanet që u është lënë prindërve të tyre, ndaj ata ose do ta çojnë në vend këtë përgjegjësi, ose ajo do t’i humbasë ata duke bërë që ata vetë ta meritojnë kërcënimin dhe dënimin, e kjo njëkohësisht është tregues se Allahu i Lartësuar është më i mëshirshëm me robërit e Tij sesa vetë prindërit, duke qenë se Ai i obligoi prindërit ndaj fëmijëve, me gjithë dhembshurinë e plotë që ata kanë ndaj tyre.⁽³⁾

Rrjedhimisht, kur edukimi i fëmijës brenda familjes të ketë marrë një pamje të mirë, atëherë ai ka mundësi që të bashkëveprojë me botën e jashtme në mënyrë të shkëlqyer, sepse çdo mangësi e rolit të familjes në edukimin e fëmijës dhe ngritjes së tij të kënaqshme në aspektin e besimit, në një të ardhme të afërt, do të rezultojë në paaftësinë e fëmijës për të poseduar një sjellje të lavdëruar.⁽⁴⁾ Edukimi nuk nënkupton vetëm përmirësimin e gabimeve, por ai është njëkohësisht proces i mësimin dhe mbjelljes së kuptimeve, si dhe i prezantimit të bazave të fesë dhe dispozitave të Sheriatit. Gjithashtu, është proces i përdorimit të mjeteve të llojllojshme që ndihmojnë në ndërtimin e botëkuptimeve dhe rrënjësosjen e tyre në shpirta. Pastaj vjen edukimi përmes modelit (të mirë), këshillës, tregimeve, etj.,⁽⁵⁾ që rezultat i të gjitha këtyre të jetë një personalitet i balancuar, aktiv në jetë dhe në shoqëri.

Libri është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë ka të bëjë me edukimin rreth besimit, që përmban një mori bazash dhe kornizash të cilat do të jenë ndihmëse për prindërit në edukimin e fëmijëve të tyre - me lejen e Allahut -. E, sa i përket pjesës së dytë, ajo sillet rreth modeleve praktike të përgjigjeve ndaj pyetjeve të fëmijëve rreth besimit, e cila përmban një përmbledhje të pyetjeve më të shpeshta, duke marrë në konsideratë grupmoshat e ndryshme, në veçanti ato që kanë të bëjnë me gjashtë shtyllat e besimit, si dhe sqarimeve të mënyrës së qasjes ndaj pyetjeve si këto.

Allahu është Ai që jep sukses, Ai udhëzon në rrugën e drejtë!

Abdullah ibn Hamed er Rekaf

Përmbajtja

10

Edukimi
rreth
besimit



Edukimi
i fëmijës
rreth
besimit

26

52

Shtyllat
e besimit
përgjatë
edukimit





Parahyrje rreth
përgjigjeve

74

92

Modele praktike
të përgjigjeve ndaj
pyetjeve
të fëmijëve
rreth besimit



Edukimi rreth besimit






Edukimi

Edukimi është një domosdoshmëri njerëzore prej domosdoshmërive të ndërtimit të njeriut, ndaj ai është vegël për formësimin e fëmijës dhe stabilizimin e tij në të gjitha sferat e jetës. Përmes edukimit arrihet ndërtimi i personalitetit social, intelektual dhe shpirtëror të fëmijës. Para se të flasim për edukatën e besimit dhe rëndësinë e saj, është e udhës të njihemi me domethënien e vetë edukimit. Ç'është për qëllim me të? Çfarë kërkojnë përmes tij edukatorët?!

Domethënia e edukimit



Natyrisht se edukimi është një proces i qëllimshëm avancues i cili vihet në lëvizje nga rregulla dhe korniza të cilat synojnë formimin e zakoneve të mira përmes metodës së: orientimit, ushtrimeve, ngritjes së vetëdijes, përmirësimit dhe praktikës. Edukimi i kushton kujdes ruajtjes dhe mbikëqyrjes së natyrshmërisë së fëmijës, ndërtimit të talenteve dhe aftësive të tij, e pastaj

orientimit të kësaj natyrshmërie dhe këtyre talenteve së bashku drejt asaj që mundëson përmirësimin dhe plotësimin e tyre ashtu siç e meritojnë; gjë që ndihmon në përgatitjen e një njeriu të suksesshëm për ndërtimin e botës.⁽⁶⁾ Edukimi është vegël e cila prodhon udhëheqësi në të gjitha sferat e jetës.⁽⁷⁾

Rëndësia e edukimit rreth besimit



Besimi është qëllimi më i madh i ekzistencës dhe çështja më madhështore e njeriut. Ai është ndarësi i rrugëve gjatë shtegtimit të njeriut në jetën e kësaj bote: **“Disa besuan, kurse të tjerët mohuan.”** (Kuran, 2:253) Mbi të ndërtohen veprat dhe sjelljet e tij, duke qenë gjithashtu vendimtar për atë që i pret ata në botën e përtejme.⁽⁸⁾ Periudha e fëmijërisë është njëra prej periudhave më vendimtare në jetën e njeriut, duke qenë se ajo që do ta mbjellësh në shpirtin e fëmijës gjatë kësaj periudhe, prej: botëkuptimeve, vlerave, zakoneve dhe orientimeve, është vështirë - e ndoshta edhe e pamundur - që t’ia ndryshosh më vonë, e lëre më t’ia çrrënjosësh; e nuk është larg mendsh që gjurmët e saj t’i mbesin gjatë tërë jetës së tij.⁽⁹⁾ Për këtë arsye, edukimi rreth besimit gjatë fëmijërisë është prej fazave themelore mbi të cilën ndërtohet e gjithë jeta e njeriut në këtë botë.

Në përgjithësi, edukimi është përkushtim, ndaj s'mund të ketë edukim pa përkushtim, si pasojë, më e mira në ç'mund të shpenzosh përkushtimin tënd është në mbjelljen e besimit. Po e jetojmë një kohë kur përpjekja e shumicës së hulumtuesve është orientuar në aspektin mendor dhe trupor të edukimit, duke lënë anash aspektin e besimit dhe atij shpirtëror. Punimet e tyre shkencore ata i kanë orientuar nga realizimi i fitores dhe suksesit në këtë botë duke u mbështetur në standardet materiale, duke mos u angazhuar në rregullimin e asaj që dërgon tek lumturia e botës tjetër. Kjo na ka shtyrë që, prej këtij aspekti, teoria jonë kundrejt edukimit të ketë një dallim tejet të madh në krahasim me ta.⁽¹⁰⁾

Është e qartë se edukimi përreth besimit në Islam është një prej shtyllave mbi të cilat është e ngritur ndërtesa e edukimit në epokën e pastër profetike. Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcillet të ketë thënë se ka dëgjuar Profetin e Allahut ﷺ të ketë thënë: *“Të gjithë ju jeni barinj dhe secili prej jush është përgjegjës për kopenë e tij. Prijësi (imami) është bari dhe është përgjegjës për kopenë e tij. Gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse për kopenë e saj.”*⁽¹¹⁾. Pra, ai ﷺ tërhoqi vërejtjen për madhësinë e përgjegjësisë që ne bartim mbi supet tona. Çdonjëri është përgjegjës - s'ka shpëtim prej kësaj - për atë se çfarë u ka ofruar atyre që i ka nën përgjegjësinë e vet. Gjithashtu, është përcjellë prej Profetit ﷺ se ka thënë: *“Cilido rob të cilit Allahu ia ka nënshtruar një kope për t'i mbikëqyrur, e ai nuk e ka bërë atë që i takon për t'i këshilluar, nuk*



do ta ndjejë erën e Xhenetit.”⁽¹²⁾. Këtu njëkohësisht është vënë theks i veçantë në rëndësinë e ofrimit të këshillës me sinqeritet dhe besnikëri, asisoj që këshilla të jetë përmbledhëse dhe mbërthyesë e gjithë asaj për të cilën ka nevojë i këshilluari në çdo aspekt. Është përcjellë gjithashtu rreth kësaj teme nga Ibn Omeri (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) se ka thënë: “Edukoje fëmijën tënd, sepse ti je përgjegjës për të se me çfarë e ke edukuar?! Çfarë e ke mësuar?! Ndërsa ai është përgjegjës për bamirësinë ndaj teje dhe bindjen ndaj teje!”⁽¹³⁾. Ibn Omeri këtu pohon se përgjegjësia fillimisht bie mbi supet e prindërve, ata janë burimi primar i edukimit dhe mësimit. Është thënë se edukimi është më i mirë se lëmosha. “Ta edukojë dikush fëmijën e vet është më mirë sesa të japë lëmoshë një grosh”⁽¹⁴⁾ Ashtu siç është thënë: “T’ia mësosh fëmijës sjelljen e mirë është më e mirë se çdo lëmoshë.” “S’i ka dhuruar ndonjë prind fëmijës së vet, diçka më të mirë se edukata vetë.”⁽¹⁵⁾ Të gjitha këto tekste, si dhe të tjera,

tregojnë se angazhimi me edukim dhe mësime është prej gjërave më të rëndësishme dhe më të mëdha që një prind mund t’ia dhurojë fëmijëve të tij.

Në të kaluarën, fëmijët tanë i edukonim në një ambient pjesërisht të mbyllur, ndërsa sot po i edukojmë ata ndërkohë që dyert dhe dritaret e shtëpive tona janë të hapura ndaj botës, prej njërit skaj në tjetrin. Kjo natyrisht se i ka të mirat dhe të këqijat e veta, por nëse nuk do të jemi të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm mjaftueshëm rreth aktualitetit, atëherë të këqijat mund të dominojnë ndaj të mirave. Në të vërtetë, ne kemi mundësi që t’i kuptojmë veçoritë e ndryshimeve bashkëkohore vetëm atëherë kur të kemi përvetësuar virtytin e të qenit vigjilent ndaj ndryshimeve aq të shpejta që po ngjajnë përreth nesh, si dhe leximin e tyre nga horizonti i një të pajisuri me kulturë të gjerë, duke qenë se angazhimi i edukatorit me këtë ia imponon atij përpjekjen për t’ua ngulitur në thellësinë e shpirtit të



fëmijëve kuptimet e besimit, përmes ambientit familjar për të cilin e gjithë familja kontribuon në ndërtimin e tij; pastaj përmes zgjedhjes së çerdhes dhe shkollës e cila angazhohet për një gjë të tillë. Së këndejmi, pakujdesia ndaj të kuptuarit e asaj që ngjet rreth nesh nënkupton shkaktimin e dështimeve për të cilat s'do gjesh dot më vonë asnjë rrugë për t'i përmirësuar.⁽¹⁶⁾ Ndërkohë që përmes punës së vazhdueshme në edukim dhe durimit të vazhdueshëm, me lejen e Allahut, do t'i arrijmë rezultatet më të mira të mundshme, duke qenë të vetëdijshëm se për edukim nuk është e mjaftueshme këshilla kalimthi, por duhet përcjellje dhe konsultim të vazhdueshëm.⁽¹⁷⁾



Edukimi rreth besimit është domosdoshmëri



Rinia sot po përjeton një zhvillim të shpejtë psikologjik dhe intelektual, si dhe një hapje të paparë (ndaj botës). Gjërat tërheqëse që i rrethojnë ata nga çdo anë janë më të rrezikshme sesa t'i marrim për tallje. Ndërkohë që ne, në anën tjetër, jemi të obliguar me detyrën më të vështirë gjatë gjithë ekzistencës së njerëzimit - edukimin.⁽¹⁸⁾



Prej gjërave që e vërtetojnë domosdoshmërinë e edukimit rreth besimit të fëmijëve dhe nevojën e patjetërsueshme të komunitetit musliman për të, është se përkushtimi për mësimin e besimit njerëzve dhe thirrjes së tyre në të - e veçanërisht të vegjlit - është metodologji e profetëve *-paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për ta!* - dhe e reformatorëve që erdhën pas tyre. E kësaj natyre është edhe fjala e të Lartësuarit për Nuhun (*alejhis-selam*), gjatë thirrjes që ia bënte të birit të tij dhe tërheqjes së vërejtjes ndaj shoqërimit të njerëzve të devijuar: **“O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!”** (Kuran, 11:42). E gjithashtu thotë për Ibrahimin (*alejhis-selam*) kur ua la porosinë bijve të tij: **“Ibrahimi ua dha këtë porosi fëmijëve të tij, po ashtu edhe Jakubi: “O bijtë e mi! Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë musliman!”** (Kuran, 2:132). Pastaj në këshillën e parë që Lukmani ia dha birit të tij, duke ia tërhequr vërejtjen nga shirku, me ç’rast i kishte thënë: **“O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”** (Kuran, 31:13). Dhe ja ku e kemi Profetin tonë, Muhamedin ﷺ kur e këshilloi Ibn Abasin (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) duke i thënë: *“O djalosh, po t’i mësoj disa fjalë: Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu!”*⁽¹⁹⁾ Pra, në këtë ka nxitje për edukimin rreth besimit.⁽²⁰⁾

Prej gjërave që vënë në pah domosdoshmërinë e edukimit është të kuptuarit se mësimi i besimit është kreu i diturive dhe themeli i tyre. Kur fëmija e mëson besimin, sipas metodologjisë profetike, dhe ai mbillet në zemrën e tij, atëherë adhurimet dhe degët tjera të fesë vijnë vetvetiu. Pra, të kushtuarit rëndësi kësaj është shkaktar i suksesit dhe udhëzimit, me lejen e Allahut, sepse shumë çështje janë të lidhura ngushtë me besimin në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, ndaj dhe kur besimi të jetë prezent fuqishëm, e pengon njeriun të ndjekë rrugën e asaj prej së cilës është ndaluar.

Ngjashëm, rëndësinë e angazhimit me këtë çështje e rrit edhe më tepër ajo që shohim te disa prindër të cilët e neglizhojnë mësimin e besimit fëmijëve të tyre me arsyetimin se janë të vegjël, e, kur ata të rriten, s'kanë mundësi më t'i mësojnë. Prandaj, ai që nëpërkëmbë mësimin e fëmijës rreth gjërave që i bëjnë dobi dhe e le atë ashtu të padobishëm, ai i ka bërë atij një të keqe të madhe. Shumica e fëmijëve të shthurur, në të vërtetë, këtë shthurje e kanë marrë prej prindërve të tyre. Neglizhenca e tyre dhe braktisja e mësimit të tyre për obligimet fetare dhe sunetet (vullnetaret), i ka bërë ata të humbasin qysh në vegjëli duke mos i sjellë ndonjë dobi vetvetes dhe duke mos u sjellë ndonjë dobi as prindërve të tyre pasi të jenë rritur.⁽²¹⁾

Prej këtyre gjërave është edhe numri i madh i programeve të cilat janë bërë të qasshme për fëmijët nëpërmjet mediave (vizuale, të dëgjueshme apo të lexueshme), shumica e të cilave fusin në qarkullim imagjinata dhe botëkuptime të deformuara në shpirtat e fëmijëve. Së këndejmi, bëhet e detyrueshme që të ekzistojë një edukim rreth besimit që i kundërvihet kësaj vërsulje të shtrirjes mediatike, duke qenë se edukimi rreth besimit është të vepruarit e shkaqeve fetare të lejuara, duke u bërë faktor mbrojtës i cili e ruan fëmijën nga shumë prej problemeve të edukimit para se ato të ndodhin dhe duke marrë pjesë në trajtimin e tyre kur të ndodhin. Kjo është një prej përgjegjësive të prindit ndaj fëmijëve të tij, shkak prej shkaqeve të lumturisë në këtë botë dhe shkak i shpëtimit në botën tjetër, me lejen e Allahut, duke qenë njëkohësisht edhe shkak i dallimeve të mëdha të njerëzve atë ditë.⁽²²⁾

Së fundmi, edukimi rreth besimit ofron një stabilitet shpirtëror dhe siguri psikike tek fëmijët, sepse ofron përgjigje për pyetje të mëdha në jetën e njeriut, e të cilat s'janë gjë tjetër veçse fragmente të zgjedhura nga udhëzimi i Librit të Allahut dhe sqarim nga drita e udhëzimit të Profetit ﷺ, të cilat janë shquar me çiltërsinë e burimit, me qartësinë e metodës së pasuar, si dhe me shenjtërinë e qëllimeve, duke ia shtuar kësaj edhe familjarizimin me nevojat e fëmijës dhe ndërgjegjësimin me aktualitetin e tij dhe aktualitetin e edukimit,⁽²³⁾ në mënyrë që të arrihet plotësia dhe balancimi në personalitetin e fëmijës.

Qëllimet e edukimit rreth besimit



Natyrisht se qëllimi bazë i edukimit është arritja e adhurimit të vërtetë të Allahut të Lartësuar, qëllim ky që në vetvete ngërthen realizimin e shumë objektivave të tjerë anësorë, siç janë:

Së pari: Kalimi i të rinjve, bijve e bijave të shoqërisë islame, nëpër një edukim të shëndoshë të *akides* (kredos), për të ndërtuar kështu personin e devotshëm i cili e adhuron Allahun e Lartësuar mbi bazën e udhëzimit dhe vizionit të shëndoshë.

Së dyti: Që personi brenda një shoqërie islame të pajiset me sjellje të lavdëruar, duke pasuar kësisoj Profetin e Allahut ﷺ, për të cilin Zoti i tij Lavdiplotë dëshmoi me Fjalën e Tij: **“Vërtetë ti je me virtyte madhore.”** (Kuran, 68:4) dhe duke punuar me fjalën e tij ﷺ: *“Jam dërguar që t’i plotësojë virtytet e larta.”*⁽²⁴⁾.

Së treti: Mbjellja e ndjenjës së solidaritetit brenda pjesëtarëve të shoqërisë islame, duke bërë që tek ai të mbillen ndjenjat e përkatësisë në atë shoqëri, rrjedhimisht të brengoset për çështjet dhe brengat e saj, si dhe të lidhet me vëllezërit e tij, duke e praktikuar kështu fjalën e të Lartësuarit: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër.”** (Kuran, 49:10) dhe fjalën e Profetit ﷺ: *“Besimtari për besimtarin është sikurse një ndërtësë, e përforcojnë njëri-tjetrin;”*⁽²⁵⁾ si dhe fjalën e tij ﷺ: *“I sheh besimtarët, në mëshirimin, dashurinë dhe solidaritetin mes tyre, sikur një trup, nëse ankohet një gjymtyrë, i tërë trupi rënkon nga pagjumësia dhe ethet.”*⁽²⁶⁾; gjëra këto që i përforcojnë lidhjet e singerta vëllazërore nga ana e besimit midis bijve të umetit islam.

Së katërti: Formimi i një personaliteti mendërisht dhe emocionalisht të balancuar, gjë që ndihmon në formimin e një personi produktiv dhe një anëtar të dobishëm për komunitetin e tij, i cili ia del mbanë që të bartë mbi supe rolin dhe obligimet e tij karshi zhvillimit të vendit dhe shfrytëzimit të pasurive të tij, si dhe barrën e të qenit udhëheqës në tokë, bashkë me përgjegjësitë përkatëse.⁽²⁷⁾

Prej këtu shfaqet nevoja e të filluarit me edukimin rreth besimit, sipas kuptimit të tij të vërtetë, i cili në vazhdimësi kontribuon në gjenerimin e fuqisë shpirtërore, formimin e një motivuesi personal, forcimin e komanduesit të brendshëm, si dhe orientimin e shpirtit drejt fjalëve dhe veprave; nga këtu pastaj njeriut i lehtësohet kryerja e detyrave që kërkohen prej tij për t’i arritur qëllimet e edukimit shpirtëror dhe fizik.⁽²⁸⁾

Bazat edukative



Ekzistojnë një sërë bazash mbi të cilat mbështetet ndërtesa e edukimit; gjegjësisht ato mund të ndahen në dy baza:

- E para: Baza njohëse,
- E dyta: Baza e praktikës.

Bazën njohëse mund ta ndajmë në dy pjesë: *dituria* dhe *besimi*.

Pjesa e parë, dituria, përfaqëson çelësin më të madh të të kuptuarit dhe ndërtimit të mbrojtësve të identitetit, ndaj Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!’”** (Kuran, 39:9) Ndërkohë që Profeti ﷺ ka qenë shumë i zellshëm që shokëve të tij t’u mësonte dituri dobiprurëse, siç u mësoi atyre që të kërkonin mbrojtje nga Allahu prej dijes e cila nuk sjell dobi, me ç’rast në lutjen të cilën ua mësonte atyre thoshte: *“O Allahu im! Kërkoj nga Ty që të më mbrosh prej një diturie e cila nuk sjell dobi dhe prej një zemre e cila nuk të ka frikë Ty!”*⁽²⁹⁾.

Pjesa e dytë, besimi, përfaqëson gjithë çfarë mbretëron në zemrat e fëmijëve prej gjashtë shtyllave të besimit, duke e bërë atë që të jetë një kuptim përmbledhës i cili përfshin gjithë jetën dhe atë çfarë vjen pas saj. Profeti ﷺ ka nxitur që në zemrat e bijve të umetit të tij të mbillet një doktrinë e pastër dhe e qëndrueshme e besimit.



E, sa i përket **bazës së praktikës**, ajo mund të ndahet në tri pjesë: pjesa e *adhurimeve, praktika dhe edukata*.

Pjesa e parë, *adhurimet*,⁽³⁰⁾ patjetër duhet të jenë të ndërtuara prej së brendshmi me një vërtetësi të plotë, si dhe nga tipare të shquara të personalitetit, përmes së cilave do të kesh mundësi që të ndërtosh karakterin e fëmijëve në atë mënyrë që ata t'i qasen jetës me çiltërsi, gjithmonë duke qenë i lidhur me Zotin e tij, ashtu që identiteti dhe mendja e tij të jenë gjithmonë stabile, rrjedhimisht të qëndrojnë stoikisht edhe shpresat, edhe gjërat që ai i synon. Profeti ﷺ i ka thënë Muadhrit: *“Pasha Allahun, unë vërtetë të dua, ndaj mos e lër pa thënë pas çdo namazi: ‘O Allahu im! Më ndihmo që të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë!’”*⁽³¹⁾. Ai e mësonte atë se adhurimi është mirësi prej Allahut Lavdiplotë, e jo thjesht përpjekje njerëzore, porse përkrahje hyjnore gjithashtu; ashtu siç e mësonte se për ibadetin duhet që në vazhdimësi të kërkohet ndihmë nga Allahu, për t'ia rrënjosur atij në zemër se besimtari duhet që, në adhurimin që ia dedikon Zotit të tij, të kërkojë ndihmën e Tij dhe të mbështetet tek Ai, sepse Ai -Lavdiploti- është përkrahësi në adhurimin e Tij.

Pjesa e dytë, *zbatimi në praktikë*, sepse pa praktikë nuk ka dije, puna është vetë mjeti dallues i njerëzve në Ahiret. **“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.”** (Kuran, 99:7-8).

Pjesa e tretë, *moral i lartë*, metodologjia islame synon krijimin e një njeriu me moral të lartë, saqë edhe vetë Profeti ﷺ e kishte shprehur se mesazhi i tij, në përgjithësi, kristalizohet në një koncept të vetëm - moralin e lartë, si dhe edukimin për ta arritur atë, ndaj kishte thënë: *“Vërtetë jam dërguar për t'i plotësuar tiparet e një morali të lartë!”*.⁽³²⁾ Ai i nxiste ata të kenë moral të lartë me fjalët e tij: *“Më i dashuri për mua dhe më i afërti me mua në ulëse, Ditën e Gjykimit, është ai që është me moral më të mirë.”*.⁽³³⁾ Morali i mirë është produkt i një edukate të dalluar rreth besimit.⁽³⁴⁾

Modele të edukimit



Sjellja e modeleve praktike, shëmbëlltyrave është prej çështjeve më të rëndësishme që ndihmojnë në përforsimin e parimeve dhe vlerave. Këtu do të sjellim një prezantim të shkurtuar të një sërë modelesh të cilat sqarojnë se si ka qenë udhëzimi i Profetit ﷺ dhe shokëve të tij në formimin e ndërtesës së besimit tek fëmijët.⁽⁴⁴⁾

1. Përcillet nga Ibn Abbasi (*Allahu goftë i kënaqur me të!*) të ketë thënë se Profeti ﷺ kërkonte mbrojtje nga Allahu për Hasanin dhe Husejnin, duke thënë: “Vërtet, babai juaj (Ibrahimi *alejhi selam*) kërkonte mbrojtjen e Allahut për Ismailin dhe Is’hakun përmes kësaj lutjeje: ‘Eudhu bi-kelimâtillahi et-tâmmeti min kuli shejtanin ue hâmmetin ue min kuli ajnin lâmmeh.’ (Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut, prej së keqes së çdo shejtani dhe kafshe që vret me helmin e saj dhe prej të keqes së çdo syri të keq!)” ⁽³⁵⁾.



2. Përcillet nga Ebu Hurejra (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) se Profeti ﷺ ka thënë: “Çdo i porsalindur lind në natyrshmërinë e çiltër (fitra), pastaj prindërit e tij ose e bëjnë atë çifut, ose katolik, ose zjarrputist.”⁽³⁶⁾
3. Nga Umer ibn Ebu Seleme (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) përcillet të ketë thënë: “Isha djalosht nën mbikëqyrjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ, ndërkohë që dora ime vërtitej me pakujdesi nëpër pjatë, Profeti ﷺ më tha: ‘O djalosht! Përmende emrin e Allahut (thuaj: bismilah), ha me të djathtën dhe ha prej asaj që e ke pranë vetes!’”⁽³⁷⁾



4. Abdullah ibn Abasi (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Një ditë, ndërsa isha mbrapa të Dërguarit të Allahut ﷺ më tha: ‘O djalosht, po t’i mësoj disa fjalë: Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu! Gjithashtu, dije se, po qe se të gjithë njerëzit do të mblidheshin për të të bërë mirë, nuk do të mund të të bëjnë mirë, pos asaj që ta ka caktuar Allahu, dhe anasjellas, nëse bashkohen për të të bërë dëm, nuk do të mund të të dëmtojnë, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Tashmë lapsat janë ngritur dhe fletët janë tharë.’”⁽³⁸⁾
5. Hasan ibn Aliu (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “I dërguari i Allahut ﷺ m’i mësoi disa fjalë të cilat i them gjatë namazit të vitrit, në duanë e kunitit: ‘**Allahummeh-hdini fi men hedejte, ue ‘afni fi men ‘afejte, ue tevel-leni fi men tev-vel-lejte, ue barik li fi ma a’tajte, ue kini sherra ma kadajte, inneke takdi ue la jukda alejke, innehu la jedhil-lu men valejte, teberakte rabenna ue te’alejte!**’”⁽³⁹⁾(O Allah! Më bëj prej atyre që i ke udhëzuar në rrugën e drejtë! Më bëj prej atyre që i shpëton

nga të këqijat! Më bëj prej atyre që kujdesesh për ta! Ma bëj të begatshme gjithçka që më ke dhënë (si: jetën, pasurinë, njohuritë, punët)! Më ruaj nga sherri i asaj që Ti ke caktuar për mua! Vërtet Ti vendos, e askush nuk mund ta kthejë mbrapsht vendimin Tënd! Nuk mund të jetë i poshtëruar ai që Ti e ke miqësuar dhe nuk mund të bëhet krenar ai që Ti e ke armiqësuar! O Zoti ynë! Ti je i Bekuar dhe i Lartësuar.)

6. Enes ibn Maliku (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë se Profeti i Allahut ﷺ i ka thënë: “O djalosh! Kur të futesh tek familja jote përshëndeti me selam, që të ketë kështu bereqet për ty dhe për anëtarët e shtëpisë tënde!”⁽⁴⁰⁾.
7. Xhundub el-Bexhelij (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Ishim me Profetin ﷺ kur ishim djem të fuqishëm, e mësuam besimin para se ta mësonim Kuranin, e pastaj e mësuam Kuranin dhe me të e shtuam besimin.”⁽⁴¹⁾
8. Ummu Sulejm er-Rrumejsa, nëna e Enes ibn Malikut (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*) e pranoi Islamin gjersa Enesi ishte i vogël, ende ushqejej me qumësht gjiri. Ajo ia pëshpëriste Enesit: “Thuaj: ‘La ilahe il-Allah!’, thuaj: ‘Esh-hedu enne Muhammeden resulullah!’” dhe ashtu veproi.⁽⁴²⁾
9. Përcillet nga Ibrahim et-Tejmij (*Allahu e mëshiroftë!*) se ka thënë: “E preferonin që sapo të fillojë fëmija të flasë, t’ia mësonin atij ‘La ilahe il-Allah’ shtatë herë, në mënyrë që këto të jenë fjalët e para me të cilat flet.”⁽⁴³⁾



Edukimi i fëmijës rreth besimit





Natyrisht

Natyrisht se prej temave më të rëndësishme të edukimit, sa i përket përmbajtjes, është edukimi i fëmijëve rreth besimit, duke qenë se ai ndërtohet mbi themelimin e zakoneve të vyera dhe zhvillimin e tyre, ngulitjen e besimit (*akides*) të saktë në thellësitë e mendjes dhe zemrës, si dhe përforcimin e tij, orientimin nga morali i dalluar dhe aktivizimin e tij në çdo sjellje të tyre.⁽⁴⁵⁾ Gjatë kësaj periudhe kohore fëmija e ndërton vizionin e tij për botën, e rrjedhimisht sjelljen dhe moralin e tij, si dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët, e varësisht prej realizimit të kësaj në realitetin e tij vjen edhe lumturia e tij në këtë dynja dhe rezultati i fitores që do ta arrijë në botën tjetër. E përderisa kjo është detyra e baballarëve dhe nënave, Kurani e ka lavdëruar këtë, kur Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu ju urdhëron për fëmijët tuaj.”** (Kuran, 4:11). Ndërkohë që Profeti ﷺ e ka cekur këtë qartë kur ka thënë: **“Çdo i porsalindur lind në natyrshmërinë e pastër (fitra), pastaj prindërit e tij ose e bëjnë atë çifut, ose të krishterë, ose zjarrputist.”**⁽⁴⁶⁾ Ky hadith na i ka sqaruar disa gjëra:

- 1.** Natyrshmëria e njeriut është besimi (*imani*) dhe se ai që devijon prej kësaj, devijon për shkak të ndonjë sëmundje prej sëmundjeve njerëzore (të shpirtit).
- 2.** Hadithi e bëri të qartë përgjegjësinë e prindërve dhe rolin e madh të atyre dyve në edukim.
- 3.** Na e theksoi ndikimin e ambientit në procesin e edukimit.⁽⁴⁷⁾

Nga mirësia e Allahut ndaj njeriut është që ia mbolli njeriut besimin në zemër që nga dita e parë e lindjes së tij, pa pasur nevojë për dëshmi e argumente që të besojë.⁽⁴⁸⁾ Kësisoj, prindërit duhet të përpiqen në mënyrën më të mirë që ta mbrojnë këtë natyrshmëri, ta mbajnë të çiltër e të dëlirë duke i edukuar fëmijët e tyre sipas fesë së pastër e të vërtetë islame, të ngritur mbi Shpalljen Hyjnore nga Kurani e Suneti. Gjithashtu, prindërit duhet të bëjnë kujdes e të mos mbështeten në lënien e edukimit të fëmijëve të tyre nga ambienti fetar me ç'rast do t'i formojnë botëkuptimet nga rrethi në të cilin gjenden. Pasi pasimi i Islamit, si një traditë dhe jo si bindje, nuk i mbron ata nga shthurja në këtë kohë revolucionare të teknologjisë kur bota është shndërruar në një fshat të vogël, e as nuk i mbron nga tretja e identitetit apo nga dobësia e personalitetit të tyre.

Zemra e fëmijës së dëlirë i ngjan me të vërtetë një xhevahiri të çmueshëm të pastër nga njollat dhe gdhendjet, ndonëse ai është në pritje të gdhendjeve që do t'i bëhen. Nëse në të gdhendet dhe edukohet e mira, ai do të reflektojë lumturi e mbarësi në dynja e ahiret dhe në shpërblimet e tij do të kenë hise të gjithë ata që e edukuan, prindërit apo edukatorët. E nëse mbi të gdhendet e keqja dhe nuk edukohet më shumë se sa një trajtim që iu bëhet shtazëve, përfundim i tmerrshëm e shkatërrim do ta presë, do të jetë barrë e rëndë e varur mbi prindërit e kujdestarët e tij.⁽⁴⁹⁾ Përmirësimi më i mirë arrihet në vegjëli, sepse kur fëmija lihet pas dore, rritet, ushtrohet e piquet mbi vese të caktuara, atëherë drejtimi i tij nga rruga e shtrembër është e vështirë.⁽⁵⁰⁾

Fëmija i rritur në një familje fetare, me besim të lartë e të kapur për mësimet fetare islame të vërteta do t'i pasojë prindërit e tij në të voglën e të madhen, aq sa botëkuptimet e tij personale do t'i formojë duke i vështuar prindërit e tij. Por, hasim në raste kur kuptimet fetare dikush i përçon me një metodë të rreptë me vendosmëri aq sa shpie në rezultate të kundërta. Kështu, kur fëmija të rritet, ndërsa prindërit e tij i ka të mangët, nuk janë të përpiktë ndaj zbatimeve fetare, rrjedhimisht vështirë do të jetë që fëmija në të ardhmen të jetë i interesuar për fe, sepse në vegjëlinë e tij nuk ka hasur në ndikimin e fesë të prindërit e tij, e kështu tek ai nuk do të ketë shenja të praktikës së fesë.⁽⁵¹⁾



Zhvillimi fetar te fëmijët



Filizat e para të fesë te fëmijët fillimisht shfaqen si mendime, si p.sh.: ekzistenca e Allahut, më pas vërshojnë mendime të tjera në lidhje me krijesat, botën e ardhshme (ahiretin), engjëjt apo shejtanët. Shkëndijat e zhvillimit fetar te fëmijët vihet në pah në bazë të katër karakteristikave:

- A Realitet i prekshëm.** Botëkuptimeve fetare fëmija ua shton realitetin e prekshëm nga shqisat dhe gjersa fëmija rritet në mënyrë të përshkallëzuar i kupton të vërtetat fetare në mënyrën e duhur dhe në moshën e adoleshencës ua jep të drejtën që iu takojnë këtyre kuptimeve fetare.

- B Formale.** Në këtë etapë fëmija i vogël e imiton dhe pason të madhin në adhurimet dhe lutjet e tij në mënyrë formale duke mos i kuptuar apo përjetuar shpirtërisht ato. Është mundësi e volitshme për edukatorin që ta shfrytëzojë interesimin e fëmijës në këtë periudhë që t'ia mësojë shtyllat e Islamit dhe moralin e tij, shtyllat e besimit dhe ndikimi që rrjedh prej tyre.
- C Dobishmëri, sipas interesit.** Fëmija e kupton gëzimin e prindërve apo mësuesve të tij përreth me veprimin e tij të disa adhurimeve, me ç'rast i bën ato vepra në kërkim të përfitimit të dashurisë së tyre, apo për arritjen e disa qëllimeve të tij, apo edhe për shfajësimin e tij duke e zmbarsur ndonjë dënim që mund ta pranojë.
- D Fanatike.** Fëmija e mbron fenë e tij me fanatizëm emocional i shtyrë nga kërkesa e instinktit dhe natyrshmërisë së tij për shoqëri, miqësi e dashuri, ndërsa nga format më të larta të shoqërisë është miqësia për hir të Allahut të Lartësuar.⁽⁵²⁾

Nga ajo që u cek më sipër na bëhet e qartë rëndësia e të përqendruarit në edukimin e fëmijëve rreth besimit. Prindërit dhe edukatorët e kanë obligim që të përpiqen me të gjitha forcat që t'ua përafrojnë dhe lehtësojnë mësimin e besimit rinisë - veçanërisht në këtë kohë kur janë shtuar sprovat, shpërqendrimet dhe dëfrimet joshëse me të gjitha format e reja.

Nga gjërat më të rëndësishme që mund t'i ndërmarrin prindërit karshi fëmijëve të tyre është, *së pari*, ushqyerja dhe nxitja e natyrshmërisë të fëmija e cila arrihet duke ia mësuar fjalën e *teuhidit*, besimit të njëshmërisë në Zot. Më pas, *së dyti*, mbështetja dhe përkrahja e besimit me gjashtë shtyllat e tij, që manifestohet me ngulitjen e dashurisë ndaj Allahut të Lartësuar dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, dhe mësimin të Kuranit fisnik.⁽⁵³⁾

Pra, ekzistenca e natyrshmërisë fetare në shpirta është ndihmesë e madhe për prindërit në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre, me ç'rast natyrshmëria e çiltër dëfton për instinktin fetar. Ky instinkt, sikur instinktet e tjera, nuk pranon zëvendësimin, por pranon vetëm orientimin dhe zhvillimin. Rrjedhimisht kjo natyrshmëri mund të përdoret duke u drejtuar në caqe të tjera, të ndryshme nga ato për cilat është krijuar. Ndërsa feja islame bën thirrje që kjo natyrshmëri të drejtohet rreth caktit të vërtetë për të cilën është krijuar.⁽⁵⁴⁾

Nga çështjet më të rëndësishme për të cilat duket të edukohet fëmija janë gjashtë shtyllat e besimit, sidomos më e rëndësishmja, besimi në Allahun. Ngase besimi në Allahun e Lartësuar dhe dashuria ndaj Tij është ajo kur pasi të arrihet, rrjedhin të gjitha shtyllat e tjera të besimit. Allahu e caktoi dashurinë ndaj Tij si një nga kushtet kryesore të besimit dhe bindjes ndaj Tij. Me fjalë të tjera, dashuria ndaj Tij është e pandashme nga bindja ndaj Tij dhe armiqësimi i armiqve të Tij,

aq sa Allahu e caktoi dashurinë ndaj Tij të jetë supreme mbi çdo dashuri të kësaj bote, kur i Lartësuari tha: **“Thuaj: ‘Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.’”** (Kuran, 9:24). Gjithashtu, kur i përshkroi robërit ndaj të cilëve është i kënaqur, cilësinë e parë që caktoi për ta ishte që ata e duan Atë: **“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.”** (Kuran, 5:54). Po ashtu, Allahu e sqaroi që njëshmëria e pastër nuk arrihet vetëm se atëherë kur të njësohet Allahu me dashuri absolute, gjersa tha: **“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre).”** (Kuran, 2:165). Arsyeja që Allahu na krijoi ne, pra, që ta adhurojmë atë, është shkalla më e lartë e dashurisë. Me ç’rast esenca e adhurimit dhe thelbi i tij është vërtetësia e dashurisë vetëm për Allahun. Në të vërtetë në brendësi ky është adhurimi, aq sa nuk plotësohet njëshmëria derisa të plotësohet dashuria e robit për Zotin e tij, e kështu duke i mposhtur dhe paraprirë të gjitha dashurive tjera, në mënyrë të atillë që dashuria e robit për Zotin e tij të jetë kryesorja, e më pas, çdo gjë që do rob i të jetë reflektim i kësaj dashurie për Zotin e tij në të cilën gjendet lumturia dhe shpëtimi i robit.⁽⁵⁵⁾

Dashuri kjo e ndërtuar mbi besim është nga shkaqet më madhore për edukimin dhe përmirësimin e sjelljeve të fëmijëve, për përforcimin e tyre të paepur në fenë islame, nën bindjen e Allahut dhe të Profetit të Tij ﷺ. Kur në zemrën e dikujt mbillet dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e tij, atëherë besimi i tij, adhurimet e tij dhe morali do të jenë të lavdëruara e në mënyrë të duhur. Sado që të nxë, të bjerë në gabime, të harrojë e të shpërqendrohet në pjesëza e çështje të ndryshme, dashuria e mbjellë në brendësinë e tij do ta kthejë në rrugën e drejtë, me lejen e Allahut,⁽⁵⁶⁾ sepse dashuria ka shtytës të brendshëm dhe jo vetëm të jashtëm.

Këndvështrimin të cilin e paraqet doktrina islame, pra besimi islam përreth ekzistencës veçohet me një pajtueshmëri të plotë mes natyrshmërisë së çiltër të njeriut në njërën anë dhe në mënyrë simetrike në anën tjetër të arsyes së shëndoshë, duke mos pasur kurrfarë kundërtënie mes tyre. Gjithashtu, doktrina islame karakterizohet me veçori të tjera të cilat nuk ndodhen në besimet e tjera, asilloy ku janë plotësuar të gjitha pikëpamjet ideologjike, doktrinale, etike dhe

legjislative. Ky këndvështrim, një pikëpamje ideologjike dhe doktrinale, na e sqaron në mënyrë gjithëpërfshirëse zanafillën e kozmosit, vijueshmërinë e tij dhe të vërtetat që ndodhën brenda dhe jashtë tij. Po ashtu, shpjegon fillimin e jetës së njeriut dhe mbarimit të saj, më pas sqaron arsyen përfundimtare të krijimit të kozmosit dhe cakun final të krijimit të njeriut, duke u përgjigjur në pyetjet e njeriut rreth ekzistencës, për të cilën njeriu nga natyrshmëria e tij do të pyesë domosdo, aq sa nuk mund të gjejë prehje në këtë jetë derisa të marrë përgjigje të mjaftueshme, bindëse, gjersa të qetësohet për ato pyetje, në të kundërtën do të jetojë në dyshime e dilema stresuese të vazhdueshme, sepse nuk e ka hasur kuptimin e vërtetë të kësaj jete.⁽⁵⁷⁾



Frytet


e edukimit rreth besimit



Shumë fryte mund të vilen nga edukimi i fëmijëve rreth besimit, siç mund të cekim disa në vijim:

- 1** | Nxitimi dhe shpejtimi i tyre drejt veprave të mira, sepse ai do të trokasë në çdo derë të mirësisë që e afron atë afër kënaqësisë dhe mëshirës së Allahut.
- 2** | Fuqizimi i ndërgjegjes qortuese, sepse besimi i gjallëruar është ai që vë nën kontroll sjelljet e njeriut.
- 3** | Asketizmi nga kjo botë, aq sa zemra e tij nuk lidhet me dynjanë, që të arrijë të bëhet ajo preokupimi e tij kryesor dhe pikënisja e veprimeve të tij.
- 4** | Ndhima hyjnore, në mënyrë të atillë që Allahu i Lartësuar i merr përsipër çështjet e robit të Tij besimtar duke ia përmbushur dobisë e tij të vërteta e kështu duke e lumturuar atë në të dy botët.
- 5** | Dëshira për Allahun, që sa më shumë që i rritet besimi, aq më shumë i shtohet bindja e robit për Zotin e tij të Madhëruar, interesimi për Të dhe pavarësimi nga krijesat e Tij.
- 6** | Fshehja e fenomeneve negative dhe pakësimi i problemeve mes anëtarëve të familjes, kështu që sa më shumë që rritet besimi në zemra, izolohet ndikimi i epshit në veprime, dhe kështu forcohet vullneti duke e shpënë vepruesin drejt moraleve të larta e të lavdëruara.
- 7** | Ndikimi pozitiv të njerëzit, në mënyrë të atillë që besimtari i fortë synon përmirësimin e vetvetes dhe të të tjerëve.
- 8** | Ndjenja e prehjes dhe e qetësisë sa herë që përforcohet bindja e besimi në zemrën e robit, zhduken nga ai frika e paniku të cilat i terrorizojnë njerëzit.⁽⁵⁸⁾


Boshtet e edukimit rreth besimit



Më të vërtetë prindërit e kanë për detyrë që t'ua mësojnë fëmijëve atë që ua ngulitë besimin e tyre, drejton moralin dhe sjelljet e tyre, ua përforcon ndjenjën e të qenit pjesëtar të umetit të Muhamedit ﷺ.

Siç do t'i trajtojmë në vijim disa pika që rrjedhin nga kjo tematikë:

1. Mësimi i gjashtë shtyllave të besimit dhe besimit në përgjithësi gjithëpërfshirës të fesë, Sheriatit, me gjithë lidhshmërinë e tij me natyrshmërinë e çiltër njerëzore. Duke pasur kujdes gjatë mësimit nga mënyrat tradicionale, formale nga të cilat humb gjallëria e besimit; pra, duke u përpjekur që të jetë mësimi me metoda praktike nga të cilat zgjohen zemrat, lëvizin mendjet dhe drejtohen sjelljet.
2. Edukimi i fëmijëve përreth dashurisë ndaj Profetit ﷺ, familjes së tij, grave të tij që janë nënat e besimtarëve dhe të gjithë shokëve të tij, duke mos u sforcuar e tepruar në dashuri ndaj tyre, por assesi duke u treguar i shkujdesur dhe i padrejtë.
3. Edukimi i fëmijëve për madhërimin e fesë, shenjave të saj dhe manifestimeve të saj, duke ua tërhequr vërejtjen nga përbuzja apo mosrespektimi ndaj fesë, apo mosinteresimi e injorimi ndaj saj.⁽⁵⁹⁾
4. Edukimi i fëmijëve se besimi i kërkuar nuk plotësohet vetëm se me bërjen e veprave të mira, rrjedhimisht, pra besimi shtohet me veprimin e punëve të mira dhe pakësohet kur veprohen gjynahet. Nga kjo kuptojmë që edukimi i fëmijëve rreth besimit është një domosdoshmëri në mënyrë të atillë që të çelin frytet e tij në moral, sjellje dhe adhurime.⁽⁶⁰⁾



5. Gdhendja e besimit për Ditën e Gjykimit në shpirtrat e tyre, madhërimi i kësaj Dite dhe sqarimi i lidhshmërisë së shpërblimit të veprave të mira, të cilat robi i bën në këtë botë dhe rezultatit në botën tjetër, ai që vepron mirë do të shpërblehet me Xhenet, ndërsa ai që bën keq, Xhehenemi do ta presë.
6. Theksimi i mbikëqyrjes së Allahut të Lartësuar ndaj robërve të tij që Ai i shikon ata, i dëgjon dhe nuk i fshihet asgjëje nga gjendjet e tyre.
7. Ngulmimi i ndjenjës se ai ndodhet në të vërtetën, asisoj që kjo do ta shpirë që të jetë krenar dhe i bindur me fenë e tij.⁽⁶¹⁾



Metodika të edukimit për mbjelljen e besimit

Këto metoda mund t'i ndajmë në dy kategori: e para, para moshës së pjekurisë⁽⁶²⁾ të fëmijët, dhe e dyta, pas moshës së pjekurisë.

Nga gjërat që të ndihmojnë për gdhendjen e besimit te fëmija para moshës së pjekurisë janë:

1. Komentimi rreth emrave fetarë të cilët fëmija i dëgjon në rrethin që jeton. P.sh.: emrin Abdullah (rob i Allahut), Abdurrahman (rob i të Gjithëmëshirshmit), Abdulkërim (rob i më Bujarit), etj., duke u përpjekur për sqarimin e kuptimeve të tyre shkurtimisht. Të pasurit kujdes që fëmija ta dëgjojë ezanin. Më pas fëmijës t'i mësohen disa nga lutjet e caktuara ditore (*dhikret*), duke u kujdesur që t'i thotë ato. Në rast se harron, atëherë vetë prindi në prezencën e tij duhet t'i thotë ato.⁽⁶³⁾ Gjithashtu, të kujtojë begatitë e Allahut ndaj nesh, sidomos përgjatë ngrënies së ushqimit, pasi përsëritet vazhdimisht. Në këtë rast ia mëson atij përmendjen e emrit të Allahut në fillim të ushqimit duke thënë *bismilah* dhe falënderimit të Allahut pas përfundimit të ushqimit.
2. Nxitja e fëmijës për nxënien përmendsh të disa sureve të Kuranit, duke ia sqaruar që Kurani është fjala e Allahut të Lartësuar. Së pari duhet t'i mësohet surja *el Fatiha*, më pas *el Ihlas*, e pastaj suren *el Felek* dhe suren *en Nas*. Gjithashtu, duke ia shtuar kësaj, më pas mund t'i mësohen disa poezi apo ilahi nga të cilat përmes tyre nxitet mësimi i kuptimeve të sakta të besimit te fëmija.
3. Duhet të merret parasysh që emri i Allahut duhet t'i përmendet fëmijës kur ai është në çaste gëzimi e hareje dhe assesi t'i përmendet emri i Allahut të Lartësuar i krahasuar me ashpërsinë apo dënimin në moshë të vegjëlisë; pra, nuk duhet shtuar shumë biseda për zemërimin e Allahut, dënimin e Tij apo Xhehenemin.

4. Udhëzimi i fëmijës drejt bukurive të krijesave, forcës së tyre, që ta ndiejë madhështinë e Krijuesit dhe fuqinë së Tij, e kështu ta dojë Atë, ngase Allahu e do atë, siç ia nënshtron atij disa nga krijesat.

5. Ushtrimi i fëmijës ndaj moraleve dhe sjelljeve të lavdëruara, gjithashtu ushtrimi i mësimit të mëshirës, ndihmës, bashkëpunimit, kulturës së bisedës dhe artit të të dëgjuarit, praktikave islame me anë të shëmbëlltyrave të mira, me ç'rast do të jetojë në një ambient ku mbizotëron mirësia dhe kështu do të marrë nga të mirat përreth tij.⁽⁶⁴⁾



Pas moshës së pjekurisë, këtyre metodave iu shtohen të tjera metoda, duke ia bashkangjitur të menduarit dhe të arsyetuarit, siç mund të cekim:

- 1.** Mësimi i fëmijës për madhësinë madhështore të këtij kozmosi, precizitetin e tij, pajtueshmërinë dhe përkryerjen e tij, me qëllim që ta lavdërojë Allahun e Lartësuar dhe ta madhërojë Atë. Allahu i Madhëruar thotë: **“E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë.”** (Kuran, 27:88)
- 2.** Kujtimi i urtësive të Allahut në veprimet e Tij dhe në krijesat e Tij, që ta dojë Allahun dhe ta lavdërojë Atë. P.sh.: urtësia e krijimit të natës e të ditës, krijimit të Diellit e Hënës, krijimit të shqisave, dëgjimit, shikimit, shijimit e kështu me radhë. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar.”** (Kuran, 30:8).⁽⁶⁵⁾
- 3.** Shfrytëzimi i mundësive të përshtatshme për orientimin e fëmijës përmes ngjarjeve të përditshme me urtësi që ta dojë mirësinë e ta urrejë të keqen. P.sh.: kur të sëmuret, duhet t’ia lidhim zemrën me Allahun që Ai është Shëruesi, t’ia mësojmë lutjen, t’ia mësojmë mendimin e mirë për Allahun, metodën e shërimit me Kuran, *rukjen*. Ndërsa nëse ia shërbejmë atij ndonjë frutë që e kërkon, ia përkujtojmë falënderimin e Allahut për këtë begati duke ia theksuar që kjo begati vjen nga Ai. Prindërit duhet ta braktisin mësimin e kuptimeve të besimit përgjatë ndodhive të dhimbshme për fëmijën, ngase ai nuk është i pjekur plotësisht që të kuptojë e arsyetojë.⁽⁶⁶⁾
- 4.** Patjetër duhet që fëmija t’i mësojë veprat islame përmes praktikës së vazhdueshme. Kësisoj duhet që edukatori të jetë ai i pari shëmbëlltyrë i këtyre veprave. Në të vërtetë lidhshmëria mes fesë dhe vlerave të larta të moralit përgjatë sjelljeve në praktikë dhe bashkëveprimit e bën edukimin frytdhënës e të pasur për dallim nga teoritë e thata.⁽⁶⁷⁾
- 5.** Të përfuturuarit nga tregimet me kuptime të bukura duke e nxitur fëmijën në gjërat e pëlqyeshme dhe duke e larguar nga të urryerat. Përgjatë rrëfimit të tregimeve duhet të kemi parasysh që të bëhen në mënyrë dramatike, ndikuese, duke i shfaqur udhëzimet dhe vlerat e lavdëruara që i përmban tregimi. Gjithashtu përmes poezive të bukura mund të përçohen shëmbëlltyrat e larta dhe moralet fisnike. Po ashtu, mund të njihet fëmija me Profetin ﷺ duke ia rrëfyer biografinë e tij, që ta dojë atë e t’i bindet dhe të lidhet me të që nga vegjëlja. Duke i vënë në pah sjelljet e tij ﷺ me fëmijët, butësinë e tij ﷺ me ta, duke e përshkruar pamjen e tij, si dhe rrëfimi i ndodhive që na tregojnë moralin e tij të lartë e fisnik. Duke ia shtuar këtyre edhe tregimet për sahabët, nënat e besimtarëve dhe anëtarëve të familjes së tij ﷺ, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!⁽⁶⁸⁾

6. Pasimi i mesatares përgjatë edukimit fetar të fëmijëve, duke mos i ngarkuar me ato gjëra të cilat nuk mund t'i përballojnë. Nuk duhet të harrojmë që argëtimi dhe zbavitja janë bota kryesore e fëmijës. Pra, nuk i rëndojmë asisoj që zhvillimi i tyre normal të marrë drejtim të kundërt, duke u shtuar atyre përgjegjësi e kësisoj duke ua shumëfishuar ndalesat që i privojnë nga nevojat themelore fëmijërore. Ekzagjerimi në këtë çështje dhe teprimi i qortimit shpie në ndikim negativ duke e bërë të ndihet fajtor. Zakonisht kjo ndodh me fëmijën e parë, si pasojë e entuziazmit të prindërve në kërkim që fëmija i tyre të bëhet shembullor.
7. Fëmija duhet të lihet në natyrshmërinë e tij, duke mos i ndërhyrë vazhdimisht të mëdhenjtë, në mënyrë të atillë që t'i përgatiten atij aktivitete që ai vet t'i zbulojë sipas aftësive të tij, duke u njoftuar me ambientin që e rrethon. Kështu i zhvillohet atij dashuria për zbulim dhe kuriozitet dhe i rriten aftësitë e tij.



8. Inkurajimi i fëmijës ka ndikim shumë të mirë tek ai. Nxitet që të nxjerrë më të mirën e tij në veprimet dhe përmbushjen e punëve të dëshiruara. Çdoherë kur sjelljet e fëmijës të jenë në përpikëri me udhëzimin e tij të ngritur mbi bazat e dashurisë dhe shpërblimit, atëherë do të shpjerë tek stolisja e fëmijës me sjellje të duhura me metodën më të mirë. Gjithashtu, duhet t'i ndihmojmë fëmijës ta dijë se çfarë është e drejta e tij, çfarë i përket atij e çfarë jo, çfarë është e lejuar të bëhet e çfarë jo. Gjithnjë duke e bërë të ndihet krenar me pozitën e tij, duke ia shoqëruar mesataren e lavdëruar në sjellje e duke e mënjanuar nga llastimi.⁽⁶⁹⁾
9. Mbjellja e pozitës së lartë të Kuranit në zemrën e fëmijës, admirimin dhe respektimin e tij. Kështu ai do ta përjetoj shenjtërinë e tij e do t'i nënshtrohet urdhrave që gjenden në të. Rekomandohet të përdoren metoda tërheqëse, të lehta, p.sh.: t'i tregohet fëmijës se nëse e përkryen leximin e Kuranit do ta arrijë gradën e engjëjve të ndershëm. Të insistohet që fëmijës t'i mësohet trajtimi i Kuranit, edukata përgjatë leximit - duke kërkuar mbrojtën e Allahut nga shejtani i mallkuar para leximit, më pas fillimi i leximit duke përmendur emrin e Allahut, *bismilah*, ta nderojë *mus'hafin* dhe të jetë i vëmendshëm gjatë dëgjimit të tij -, duke ia mësuar kështu dëgjimin e disa ajeteve nga Kurani, me qëllim që ta ketë më të lehtë mësimin e tij dhe t'i përmirësohet leximi. Njëherazi mund t'i mësohen disa kuptime të ajeteve apo sureve të shkurtra që përmbajnë kuptime rreth besimit, sidomos nga ato suret që i di përmendësh, siç është surja *el Fatiha*, *el Ihlas*, *el Felek* dhe *en Nas*. Edhe rrëfimi i regjimeve kuranore sa më shumë duke i thjeshtësuar që të jenë sa më të lehta për t'u kuptuar përmes metodave të ndryshme.⁽⁷⁰⁾

10. Mund të përdoret gjithashtu metoda e pyetjes dhe përgjigjes, duke u munduar që vet pyetja gjithashtu të ketë informata të dobishme të cilat synojmë t'ia përçojmë fëmijës. Ndërsa përgjigjja të jetë e shkurtër, që të jetë e përshtatshme për moshën e fëmijës dhe të kuptuarit e tij. Kjo seriozisht ka një ndikim mbresëlënës te fëmija për përfitimin e vlerave të larta, moralit të lavdëruar dhe përmirësimit të sjelljes së tij.
11. Nga metodat e mësimdhënies mund të përdoret po ashtu zbavitja përgjatë ngjyrosjes, duke përdorur imazhe me kuptime rreth besimit duke i ripërtërirë ato çdoherë. Gjithashtu mësimdhënia mund të jetë edhe përmes konkurseve e garave të ndryshme, ku hapësira këtu është e gjerë. Mund të theksojmë se pëlqehet që garat sfiduese të përmbajnë aktivitete fizike, ngase fëmijët e duan gjallërinë.⁽⁷¹⁾





12. Fëmijëve ua shpjegojmë disa hadithe apo pjesë prej tyre që kanë të bëjnë me besimin, duke marrë parasysh atë që i përshtatet fuqisë së tij intelektuale, me metoda të lehta e të pëlqyera, duke zgjedhur shprehje të shkurtra që t'i kapë mendja i tij.⁽⁷²⁾ Gjithashtu mund të përdoret metoda e përsëritjes së shprehjeve të caktuara përgjatë mësimdhënies, siç bie fjala shprehja: “Caktimi i Allahut” dhe “Ai bën çfarë të dojë.”, “Allahu ka mundësi dhe fuqi të bëjë çdo gjë.”, “Mbështetu në Allahun.” e të tjera me radhë, gjersa fëmija pastaj do t'i përdorë ato vetvetiu. Me ndihmën e prindërve apo edukatorit mund t'i ofrohet fëmijës mundësia që ta zbukurojë e stolisë dhomën e tij apo klasën me shprehje të bukura rreth besimit; p.sh.: “Unë jam musliman”, “Unë e dua Zotin tim”, “Shtyllat e besimit”, etj. Këto mënyra të edukimit dhe mësimdhënies lenë gjurmë në mendjen e fëmijës, si pasojë e shikimit të shumtë të tij.⁽⁷³⁾

13. Edukimi i fëmijës se nga sprovat nuk shpëton njeri. Të gjithë njerëzit në këtë botë i sprovon Allahu me sprova e vështirësi. Por, duhet t'ia mësojmë se Allahu nuk cakton diçka vetëm se si pasojë e dijes së Tij absolute dhe urtësisë së Tij të plotë. Duke ia theksuar që Ai që i sjell mirësitë është Allahut dhe Ai që i largon dëmet është, po ashtu, Allahu. Mëshira e Tij ia ka kaluar zemërimit të Tij, duke ia cekur që lehtësimi e shpëtimi vjen pas vështirësisë e mundimeve; ky është pra ligji i Allahut. Duke ia madhëruar fëmijës mendimin e mirë për Allahu dhe se ky është adhurim në vetvete. Zgjedhja e Allahut për neve është më e mirë se sa zgjedhja jonë për vetët tona, ndërsa njeriut nuk i mbetet vetëm se të zbukurohet me durim, duke i mbledhur shkaqet e legjitimuar afetare se si t'i përballojë sprovat, duke u stolisur me kënaqësinë dhe duke shpresuar në shpërblimin e Allahut. Dhe, së fundi, ia mësojmë atij të shtrënguarit pas lutjeve drejtuar Allahut, pasi kjo është një tregti me Allahun, ku robi del gjithnjë fitimtar.⁽⁷⁴⁾

Mjetet edukuese



Në vijim do t'i përmendim disa nga mjetet më të rëndësishme edukuese për kultivimin e besimit te fëmijët:

- 1. Shëmbëlltyra e mirë** - Modeli shembullor, shëmbëlltyra e mirë llogaritet nga shkaqet më madhështore që ndikojnë thellë te fëmija. Për rëndësinë e modelit të mirë na ka tërhequr vërejtjen edhe Profeti ﷺ, siç është përmendur në hadithin e Abdullah ibn Amir (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) i cili thotë se një ditë e kishte thirrur nëna, ndërkohë që Profeti ﷺ ishte tek ata.

- Abdullah! Eja, kam për të të dhënë diçka! - tha nëna.
- **Çfarë deshe t'i japësh Abdullahit?** - e pyeti Profeti ﷺ nënën e Abdullahit. Ajo u përgjigj dhe tha se donte t'i jepte një hurmë.
- *Sikur mos t'i jepje hurmën do të të shkruhej ty një gënjeshtër.* - tha Profeti ﷺ.⁽⁷⁵⁾ Ndërsa një transmetim tjetër i hadithit ka ardhur: *"Kush i thotë fëmijës, eja të të jap diçka dhe më pas nuk i jep asgjë, i llogaritet si gënjeshtër."*⁽⁷⁶⁾ Pra, shëmbëlltyra e mirë është nga metodat efektive të edukimit. Gjithashtu nga hadithi kuptojmë për rëndësinë e së vërtetës me fëmijët veçanërisht.⁽⁷⁷⁾

- 2. Këshillimi i singertë** - Dhënia e këshillës ka metoda të ndryshme, mund të jepet në formën e njohur, drejtpërdrejt, por mund të jepet gjithashtu përmes shembujve apo përgjatë rrëfimit të ndonjë tregimi, apo nga ana e bashkëbisedimit e kështu me radhë. Ne na përket të përkujdesemi kur ta këshillojmë fëmijën që të mos mërzhitet.⁽⁷⁸⁾



3. **Inkurajimi dhe kërcënimi** - Mund të quhet kjo metodë edhe sikurse shpërblimi dhe dënimi. Singerisht kjo metodë llogaritet si një nga metodat më të dukshme emocionale jo rastësisht, ngase kjo prek thelbin e natyrshmërisë së çiltër të njeriut të cilën Allahu ia caktoi, e ajo është dashuria për dobinë dhe arritjen e saj dhe, në anën tjetër, urrejtja e së dëmshmes dhe mënjanimin e saj. Duhet të kemi kujdes gjatë kësaj metode, sepse duhet të bëhet me masë dhe me saktësi, duke mos e shpërdoruar atë e duke mos i kaluar kufijtë. Fëmija ka natyrë të shtalpët e të ndjeshme, nuk do të duhej t'i futet frika në palcë e të traumatizohet, pasi shpirti i tij mund të ndikohet anasjelltas. Kësisoj duhet të mbizotërojë metoda e inkurajimit, pasi fëmija në vegjëli më shumë ka nevojë për shpërblim se sa për dënim.⁽⁷⁹⁾
4. **Ushtrimi, praktika** - Stërvitja e fëmijës që të jetë vigjilent në kërkim të kënaqësisë së Allahut, frikës e turpit nga Ai, që të mbështet tek Ai për çdo gjë dhe çdoherë, edhe që çdo çështje është në duar të Tij. Të gjitha këto e pajisin atë me fuqi e fortësi që t'i bëjë ballë çdo sprove dhe me kënaqësi e bindje duke iu qetësuar zemra e kështu të gjejë lumturinë.
5. **Rikujtimi dhe përsëritja** - Këto dyja, sipas njohurive bashkëkohore dhe përvojave njerëzore, janë nga mjetet më të zellshme për ngulitjen e diturisë në mendjen e njeriut.⁽⁸⁰⁾
6. **Dialogu dhe bashkëbisedimi** - Biseda me fëmijën ia zgjeron atij diapazonin e të kuptuarit, ia hap atij horizontet e njohurive. Duhet patjetër që t'i respektohet mendimi i fëmijës dhe qëndrimi i tij, shtuar kësaj edhe dëgjimin e tij me vëmendje si dhe diskutimi me të me qetësi. Kësisoj pra, që të jetë bashkëbisedimi i suksesshëm dhe të lërë gjurmë te fëmija mundet që përmes tij të arrihet tek edukimi i fëmijës dhe orientimi i tij.⁽⁸¹⁾
7. **Libri** - Për shkak të rëndësisë së skajshme duhet të përgatitet një kënd i librave, bibliotekë familjare e përshtatshme për kërkesat edukative, kulturore dhe fetare për fëmijën. Është e udhës që të jetë kjo bibliotekë e llojllojshme në përmbajtje, të ketë libra fizik, të prekshëm, të incizuar me zë dhe elektronik. Shtuar kësaj që të përmbajë gjithashtu edhe një përmbledhje të librave me tregime, për shkak të rolit të rëndësishëm të tregimeve që kanë në sferën e edukimit⁽⁸²⁾, me ç'rast në biografinë e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) ka shumë ndodhi e rrëfime të dobishme.⁽⁸³⁾
8. **Teknologjia dhe mjetet edukative moderne** - Këto janë mjete që na ndihmojnë në përçimin e mendimeve, përf forcimin dhe përafrimin e tyre te fëmijët. Me qëllim që të bëhet i aftë t'i kuptojë dhe t'i përvetësojë kuptimet e tyre. Me këtë fëmijës i prezantohen këto mendime dhe koncepte përmes teknologjisë në mënyra tërheqëse me ngjyra e shenja të cilat e tërheqin atë drejt tyre dhe e joshin që t'i pranojë me kënaqësi.

- 9. Shtytësit natyror** - Te fëmija gjenden shumë shtytës të cilat mund të përdoren për edukimin e tij. Prej tyre mund të përmendim: lojën, bashkëpunimin, imitimin e të tjerë. Nga loja p.sh.: fëmija mund ta zbulojë botën përreth tij, duke i përshkruar përfytyrimet e tij dhe caqet e të kuptuarit të tij. Kësisoj mund të përdoret kjo më sipër në sqarimin e kuptimeve të vërteta e të sakta të jetës dhe gjithësisë, apo të mbjelljes së vlerave të larta në moralin e fëmijës duke përdorur metoda të thjeshta e të përshtatshme. Vërejtja dhe shfrytëzimi i ndodhive, që ngjajnë përreth fëmijës, janë nga pasuritë më të mira që nëse investohen në mënyrën e duhur, për ta orientuar dhe udhëzuar fëmijën, përbëjnë një ndikim të fuqishëm në personalitetin e fëmijës.⁽⁸⁴⁾
- 10. Lutja** - Duaja drejtuar Allahut është provë për varfërinë e robit kundrejt Zotit të tij, për nevojën e tij për Të dhe për shpresën e tij për mirësitë që gjendet tek Ai. Allahu i ka inkurajuar robërit e Tij që t'i luten atij dhe u ka premtuar përgjigjen e Tij ndaj lutjeve. I Lartësuar i tha: **“Zoti juaj ka thënë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!’”** (Kuran, 40:60). Lutja është sinjerisht nga mjetet më madhështore që edukatori t'i arrijë qëllimet e tij të edukimit. Është mjeti të cilin e kanë përdorur edukatorët më të mëdhenj të historisë njerëzore, kush tjetër pos Profetëve (alejhim selam), nën kërkimin e qëndrueshmërisë së paepur në besimin dhe njëshmërinë e Allahut. Siç e përshkruan Allahu i Lartësuar lutjen e Ibrahimit (alehis-selam): **“(Kujtoje) kur Ibrahim i tha: ‘O Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!’”** (Kuran, 14:35). Pra, lutja për fëmijën është nga të mirat më të mëdha që mund të bëjë prindi për edukimin e fëmijës së tij.⁽⁸⁵⁾

- 11. Aktrimi dhe imitimi** - Nga natyrshmëria fëmija e pëlqen imitimin, kështu që duke e shfrytëzuar këtë pikë të tij mund t'i kërkohet ta luajë rolin e imamit të xhamisë që të falet e të këndojë Kuran, apo të luajë rolin e ligjëruesit sikurse në mimber, apo të mësuesit duke dhënë mësim, e kështu me radhë. Kjo ka një ndikim të bukur te fëmija duke ia gdhendur kuptimet e bukura dhe duke e bërë që t'i respektojë ato pozita duke jua ruajtur vlerën.



Cilësitë e edukatorit



1. Mëshira dhe butësia - Nuk mund t'i vjelësh frytet e ëmbla të edukimit përveçse nëse ajo arrihet të bashkërendohet me moralin e butësisë e kështu të përfitohen zemrat me mëshirë. Akra ibn Habis po e vëzhgonte të Dërguarin e Allahut ﷺ i cili po i puthte Hasanin dhe Husejnin, e më pas thotë: “Unë i kam dhjetë fëmijë, të cilët nuk i kam puthur ata fare.” Profeti ﷺ tha: “Ai që nuk mëshiron nuk mëshirohet.”⁽⁸⁶⁾ Gjithashtu tha ﷺ: “I Gjithëmëshirshmi do t'i mëshirojë ata që mëshirojnë, mëshironi ata që janë në tokë, do t'ju mëshirojë Ai që është në qiell.”⁽⁸⁷⁾

2. Butësia dhe falja - Profeti Muhamed ﷺ ka arritur kulmin e këtij virtyti të lavdëruar, siç përcillet nga Enes ibn Malik (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) i cili ka thënë: “Isha duke ecur me Profetin ﷺ, kishte të veshur një pallto (pardesy) me skaje të trasha nga Nexhrani, ndërkohë një beduin e takoi atë dhe e tërhoqi për pallton e tij aq fort sa i vëreja që supet e tij u lënduan nga tërheqja e vrazhdë e skajeve të palltos së tij. Më pas i tha: “O Muhamed më jep nga pasuria e Allahut që gjendet tek ti.” Pastaj Profeti Muhamed ﷺ u kthye nga ai dhe buzëqeshi, pastaj urdhëroi që t'i jepet atij diçka nga pasuria.”⁽⁸⁸⁾

Gjithashtu me virtytin e butësisë lidhet ngushtë edhe falja, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Trego mëshirë (falje), urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!”** (Kuran, 7:199). Që të arrihet butësia, i Dërguari i Allahut ka nxitur që të mos zemërohem duke na ndaluar prej tij, siç përcillet në hadithin e vërtetë kur një njeri i tha Profetit ﷺ: “Më këshillo!”, Profeti ﷺ tha: “Mos u zemëro!”, ky rikërkonte disa herë, porse i Dërguari i Allahut ﷺ gjithnjë i thoshte: “Mos u zemëro!”⁽⁸⁹⁾

3. Durimi - Edukatori duhet të stoliset me virtytin e durimit dhe mosnxitimit përgjatë edukimit të tij apo mësimdhënies së fëmijëve apo nxënësve të tij. Po ashtu, mos t'i përshpejtoj rezultatet dhe arritjen e qëllimeve, e pastaj ta kaplojë dëshpërimi dhe ndjenja e dështimit. Edukatori pa durim i ngjason udhëtarit pa pajisje të udhëtimit.



- 4. Drejtësia** - Nëse bën dallime mes personave, pa ndonjë shkak të vërtetë, atëherë do të zvogëlohet bashkëveprimi dhe do të humbë harmonia në mes të fëmijëve. Padrejtësia kudo që gjendet vetëm se e ka shëmtuar e turpëruar atë gjë.
- 5. Besnikëria** - Edukatori duhet të jetë i besueshëm, besnik përgjatë edukimit të tij të fëmijëve, pasi besnikëria është nga virtytet e profetëve. Është nga gjërat kryesore të kërkuara për kualitetin e punës, përsosjen e saj, arritjen e caqeve të saj dhe korrijen e suksesit.
- 6. Devotshmëria** - Ai që i bindet Allahut në zbatimin e urdhrave të Tij dhe largohet nga ndalesat e Tij, do t'i japë Allahu sukses nga ajo anë që fare nuk e pret. Devotshmëria është e lidhur ngushtë me shpëtimin, përmirësimin dhe suksesin në këtë botë dhe botën tjetër.
- 7. Sinqeriteti** - Sikur puna të mos jetë për hir të Allahut, ajo është e refuzuar dhe vepruesi i saj nuk do të korrrë asgjë pos lodhjes e dëshpërimit.
- 8. Dituria** - I dituri është syhapur për gjendjen e tanishme dhe përfundimet e saj, për dallim nga naivi që e humb të tanishmen dhe e prish të ardhmen.

- 9. Urtësia** - Atëherë kur edukatori ta vendos çdo gjë në vendin e kërkuar, atëherë edukimi do të nxjerrë frytet e tij. Kështu pra, detyra e edukatorit është të depërtojë në brendësinë e fëmijës duke mbjellë në të udhëzimin e orientimin.
- 10. Besimi në punën e edukimit** - Edukimi është proces i dhënies së shpirtit dhe vetvetes, ai që nuk beson në procesin e edukimit nuk arrin dot të japë këtë lloj edukate.⁽⁹⁰⁾
- 11. Zhvillimi** - Edukatori përkujdeset për mundësitë dhe aftësitë e tij me qëllim që të arrijë gradën e preferuar që të luajë rolin e një edukatori të mirëfilltë.







Shtyllat e besimit
përgjatë
edukimit⁽⁹¹⁾



SHTYLLA

Shtylla e parë:

Besimi në Allahun

Shtylla e dytë:

Besimi në engjëjt

Shtylla e tretë:

Besimi në libra

Shtylla e katërt:

Besimi në profetët

Shtylla e pestë:

Besimi në Ditën e Gjykimit

Shtylla e gjashtë:

Besimi në paracaktimin e Allahut

Shtylla e parë:

Besimi në Allahun



Për ekzistencën e Allahut dëshmojnë: natyrshmëria e pastër njerëzore, logjika e shëndoshë dhe legjislacioni i saktë. Çdo krijesë është e inspiruar që me natyrshmërinë e saj të pastër të besojë në Krijuesin e vet. Si prova logjike, të gjitha këto krijesa duhen medoemos të kenë një Krijues. Sipas legjislacionit të saktë hyjnor, që të gjitha fetë qiellore miratojnë ekzistencën e Krijuesit. Kështu pra, besimi në Allahun përfshin katër gjëra:

- *E para*: ekzistimin e Allahut.
- *E dyta*: besimi në zotërimin e Tij (*rububije*), që Ai është Zoti, Krijuesi, Sunduesi, Urdhëruesi, Furnizuesi.
- *E treta*: besimi në njëshmërinë e Tij (*uluhiyen*), se vetëm Allahu është i Adhuruari i Vërtetë që e meriton adhurimin.
- *E katërta*: besimi në emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta.⁽⁹²⁾

Këto katër gjëra ia mësojmë fëmijës duke e edukuar nën njohjen e Allahut, madhërimit të Tij dhe dashurisë për Të. Kjo është shtylla kryesore krahas shtyllave pasuese të tjera të besimit.

Pse t'i mësojmë fëmijët ta duan Allahun e Lartësuar?!

- 1.** Allahu i Madhëruar është Ai që na krijoi nga hiçi, e përsosi krijimin tonë, na ngriti e nderoi mbi shumë krijesa të tjera, na begatoi me begatinë më madhështore, fenë islame. Na furnizoi me shumë mirësi të cilat nuk i meritojmë, Ai është Allahu që na premtoi Xhenetin, si shpërblim të veprave tona të cilat, gjithashtu, janë begati dhe furnizim nga Ai; pra, Ai është Allahu që na bën nder e mirësi në fillim e fund.
- 2.** Nga dashuria për Të rrjedh nderimi, madhërimi dhe respektimi për Të, haptazi e fshehurazi. Ah, sa shumë kemi nevojë që fëmijët tanë ta respektojnë Zotin e tyre dhe ta nderojnë Atë në vend që lidhja e tyre me Zotin të jetë e ndërtuar vetëm mbi frikën nga dënimi i tij apo nga zjarri i Xhehenemit, por të jetë adhurimi i tyre ndaj Tij, kënaqësi shpirtërore që e jetojnë duke i ruajtur ata nga rrëshqitjet.
- 3.** Ai është Allahu i Gjalli, i Përrjetshëm, Mbajtësi i gjithçkaje, i cili nuk vdes kurrë. Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Ai është me ta kudo që të jenë, Ai është që i vështron, i ruan dhe përkujdeset për ta më shumë se sa

prindërit e tyre. Rrjedhimisht, të lidhurit e fëmijëve me Zotin e tyre duke e dashur Atë llogaritet një domosdoshmëri, e kështu ta njohin që kanë një mbështetje të fuqishme, e Ai është Allahu i Madhëruar.

4. Kur ata ta duan Allahun e Lartësuar do ta duan Kuranin famëlartë, do të jenë të kujdesshëm për namazin. Kur ta dinë që Allahu është i Bukur dhe e do të bukurën, atëherë do të bëjnë çdo gjë që është e bukur. Kur ata ta dinë që Allahu i do ata që shumë pendohen, pastrohen, janë vepërmirë, japin lëmoshë, janë durimtarë, mbështeten në Allahun, janë të devotshëm, e kështu me radhë, atëherë do të përpiqen që të stolisen me këto virtyte në kërkim të dashurisë dhe kënaqësisë së Tij, në kërkim të mbështetjes, përkrahjes dhe mbrojtjes së Tij ndaj tyre.⁽⁹³⁾ Kur ta dinë që Allahu nuk i do tradhtarët, jobesimtarët, mendjemëdhenjtë, të padrejtët, zullumqarët e keqbërësit, do të largohen nga këto cilësi me gjithë forcat e tyre gjithmonë në kërkim të dashurisë së Allahut dhe ëndjen për kënaqësinë e Tij.
5. Dashuria ndaj Allahut lind ndjenjën se Allahu na përkrah, me ç'rast nga kjo rrjedh ndjenja e qetësisë, prehjes dhe qëndrueshmërisë, mosbrenjosjes dhe mërziisë. Kështu arrihet shpëtimi i shpirtit dhe trupit nga sëmundjet psikike dhe fizike dhe më e rëndësishmja: shpëtimi nga gjynahet dhe gabimet.⁽⁹⁴⁾



Si t'i mësojmë fëmijët që ta duan Allahun e Lartësuar?


1. Mësimi përmes botës së shqisave llogaritet të jetë rruga e vetme për mbjelljen e çështjeve të besimit te fëmija. Kësisoj pra, ne mbështetemi në shqisat për përforcimin e besimit të fëmijës në Krijuesin e tij. Duke i përdorur fenomenet natyrore përreth nesh për arritjen e objektivave, p.sh.: përmes Diellit, erës, shiut i mësojmë fëmijës se ekziston Krijuesi që e drejton këtë kozmos. Në të njëjtën kohë e inkurajojmë fëmijën që të pyesë e të kërkojë sqarime.⁽⁹⁵⁾ Ne përpiqemi që t'u vendosim fëmijëve thjerrëza besimi në sytë e tyre, që të aftësohen t'i vërejnë provat e ekzistencës së Allahut në çdo gjë që analizojnë apo mësojnë nga horizontet e njohurive të tyre.⁽⁹⁶⁾ Asisoj mundohemi që të shfaqim fuqinë e hatashme të Allahut dhe krijimin e Tij të përsosur. Bie fjala mund ta përdorim porosinë hyjnore të Allahut për shikimin e pikënisjes së krijimit të njeriut, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar.”** (Kuran, 86:5). Nxitja për shikim në ushqimin e njeriut, si e krijoji Allahu atë, etapat të cilat i kaloi ai ushqim para se t'i shërbehej fëmijës, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet.”** (Kuran, 80:24). Gjithashtu theksimin e fuqisë madhështore të Allahut të Lartësuar nga rruga e shikimit të krijesave të tij që tregojnë për Madhësitin e Tij, siç thotë Ai i Madhëruari: **“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po Tokën, se si është shtrirë?!”** (Kuran, 88:17-20). Të gjitha këto kuptime madhështore në kohën tonë bashkëkohore mund të përcillen te fëmijët pa marrë parasysh moshën e tyre me anë të pajisjeve teknologjike të cilat na ofrojnë sqarime të qarta të llojllojshme.⁽⁹⁷⁾ ***Fëmija me natyrshmërinë e tij të padjallëzuar do ta dojë Krijuesin e gjithë këtyre krijesave madhështore të cilat i ka nënshtruar për të.***
2. Mësimi i emrave të bukur të Allahut dhe cilësitë e Tij të larta që tregojnë për bukurinë dhe përsosmërinë e Tij. Allahu është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëbërësi, mëshira e të Cilit ka kapluar çdo gjë. Ai është Falësi i madh i Cili i fal gabimet, po ashtu ai është Falësi që pos faljes së gjynaheve edhe t'i mbulon ato e nuk të turpëron. Ai ***është Allahu, më Bujari***, Ai është Allahu që i udhëzon robërit e tij për te të gjitha dobitë. Ai është i Dashuri që e duan dhe i do. Këto njohje për Allahun janë singerisht ndihmë e madhe që fëmija ta dojë Allahun, pa asnjë dyshim!⁽⁹⁸⁾
3. Duhet të kesh kujdes dhe të mos e përsëritësh frazën: “Nëse nuk më bindesh dhe nuk i dëgjon fjalët e mia, atëherë Allahu do të të dënojë ty.” Ka dallim në mes mësimi të fëmijës që Allahu i dënon ata që bëjnë gjynahe dhe nuk i binden Atij dhe në mes lidhjes së dënimit të Allahut me dëgjimin e fëmijëve ndaj prindit vazhdimisht dhe duke e kërcënuar atë për këtë mosdëgjim. Kjo,

me të vërtetë, fëmijën e privon nga mendimi i thellë në fuqinë e Allahut dhe madhështinë e Tij. Nuk është e udhës që përgjatë edukimit të fëmijës të mbështetemi në frikësimin e fëmijëve me Allahun, por duhet t'i mësojmë ta duan, ta madhërojnë dhe ta admirojnë Allahun.⁽⁹⁹⁾ Pra, nuk i atribuojmë Allahut çdo gjë që ndikon në këndvështrimin e fëmijës për Allahun e Lartësuar.

4. Kur fëmija i shikon prindërit se sa të kujdesshëm janë ata për faljen e namazit, apo se si largohen nga të ndaluarat, zakonisht do të pyesë nga kureshtja për arsyen e saj. Atëherë, përgjigjja duhet patjetër të përmbajë përmendjen e dashurisë për Allahun dhe bindjen ndaj tij. Kështu që ky do të jetë edukimi përmes shëmbëlltyrës së mirë për dashurinë ndaj Allahut të Lartësuar, pasi fëmija i pason prindërit e tij. Çfarë ia shton fëmijës dashurinë për Allahun është t'i rrëfesh atij se çfarë ka përgatitur Allahu për banorët e Xhenetit, prej begative të përhershme.
5. Kur fëmija ta arrijë moshën që t'i kuptojë çfarë do të thotë të jetë e detyrueshme, atëherë i mësohet obligimi i kësaj dashurie, për shkak se Allahu i Madhëruar është Ai që na ka krijuar neve, ka përsosur krijimin tonë, na ka furnizuar dhe nderuar mbi shumë prej krijesave të tij dhe na ka begatuar me fenë islame.⁽¹⁰⁰⁾ Shtuar kësaj edhe mësimin e fëmijës që çdo begati që shikon përreth tij është nga Allahu. I mësojmë se si duhet të falënderojë Allahun dhe se si të kërkojë më shumë që Allahu t'ia shtojë këto begati. Kjo mënyrë e diskutimit të begative është mjaft shtytëse drejt dashurisë për Allahun e Lartësuar.⁽¹⁰¹⁾
6. Duhet t'i mësojmë fëmijës të gjitha metodat ndihmëse përmes së cilave e përfiton dashurinë e Allahut dhe dashurinë e të Dërguarit të Tij ﷺ, prej fjalëve, veprave dhe gjendjeve.⁽¹⁰²⁾



Shtylla e dytë: Besimi në engjëjt



Besimi në engjëjt do të thotë të besojmë në ekzistencën e tyre, emrat e tyre të cilët i dimë, çdo rrëfim të saktë për to dhe që t'i duam ata. Nga kuptimet më të rëndësishme të cilat duhet të mendojemi t'i kultivojmë te fëmijët për engjëjt janë si në vijim:

1. T'u mësojmë që engjëjt janë krijesa të krijuara nga drita. Përcillet nga Aishja (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Janë krijuar engjëjt nga drita, xhindet janë krijuar prej flakës së zjarrit, ndërsa është krijuar Ademi ashtu siç ju është përshkruar juve.”⁽¹⁰³⁾ Mjafton që përshkrimi për engjëjt të jetë i përgjithshëm duke mos u futur në detajet e natyrës së krijimit të tyre.
2. T'u mësojmë emrat e engjëjve të cilat janë përmendur në shpallje, p.sh.: Xhibrili është më besniku nga engjëjt dhe prijësi i tyre, është ai që zbriti Kuranin prej Allahut. Mikaili është engjëlli i autorizuar për zbritjen e shiut. Israfil është engjëlli i autorizuar për fryrjen e surit. Nga engjëjt janë edhe mbajtësit e Arshit, shkruajtësit e veprave, ruajtësit dhe lloje tjera të engjëjve.
3. Të sqarohet që numri i tyre është shumë i madh, aq sa nuk e di numrin e tyre askush pos Allahu të Lartësuar. Engjëjt janë krijesa të cilat janë të krijuara që t'i binden Allahut dhe kryerjes së urdhrave të Tij; pra, çdo engjëll ka detyra të caktuara të cilat i përmbush ato me përpikëri.
4. T'u mësojmë që engjëjt janë të mbrojtur nga mosbindja ndaj Allahut, prandaj ata e adhurojnë Allahu vazhdimisht, adhurojnë të tillë pa u plogështuar, pa u mërzhitur, duke mos treguar mendjemadhësi. Ata i duan besimtarët, i ndihmojnë ata, luten për ta dhe i ruajnë. Gjithashtu janë prezentë në tubimet që përmendet Allahu dhe i përcjellin ato tubime.

5. Nxitja e fëmijëve që t'i duan engjëjt përmes prezantimit të natyrës së tyre të mirë, kujdesit dhe interesimit të tyre për muslimanët, rrjedhimisht do të frymëzohen që t'i duan këto krijesa të mira e të bekuara. Shtuar kësaj edhe që engjëjt kërkojnë falje, luten dhe i përmendin besimtarët, i përgëzojnë besimtarët të cilët ishin të paepur në udhën e vërtetë duke besuar e bërë vepra të mira me Xhenete të begatshme. Gjithashtu i ndihmojnë dhe i përforcojnë besimtarët⁽¹⁰⁴⁾, i ruajnë veprat tyre, siç i dërgon Allahu ata që t'i ruajnë robërit, Allahu i Lartësuar thotë: **“Njeriu ka përcjellës (engjëj), para tij dhe pas tij, që e mbikëqyrin atë me urdhrin e Allahut.”** (Kuran, 13:11).
6. Besimi në engjëjt e obligon madhërimin dhe nderimin e tyre, pasi ata janë robër të nderuar, i binden Allahut në çdo gjë që i urdhëron, bëjnë çdo gjë që urdhërohen, gjithashtu duhet të zhvishen engjëjt nga çdo cilësi që nuk përkon me ta.
7. Inkurajimi dhe nxitja për pastërtinë personale, pasi engjëjt dëmtohen nga çfarë dëmtohen njerëzit. Siç përcillet nga Xhabir ibn Abdullah se Profeti ﷺ ka thënë: “Kush ha nga këto perime, hudhra p.sh., dhe një herë tha: kush ha qepë, hudhër apo presh; atëherë mos t'u afrohet xhamive tona, sepse engjëjt dëmtohen mu ashtu siç dëmtohen njerëzit.”⁽¹⁰⁵⁾
8. Ekzistenca e engjëjve dhe besimi në ta ka urtësia të shumta, prej tyre theksojmë: njeriu e kupton gjerësinë e diturisë së Allahut të Lartësuar, madhësitinë e fuqisë së Tij, urtësinë e Tij të mahnitshme. Po ashtu, muslimani ndihet i qetë dhe i sigurt, pasi e di që Allahu ka ushtarë që e ruajnë atë dhe e ndihmojnë me urdhrin e Allahut.⁽¹⁰⁶⁾
9. Lidhshmëria e engjëjve me ne që nga pikënisja e krijimit tonë, kujdesi i tyre ndaj nesh, e bën njeriun ta kuptojë se çfarë rëndësie dhe vlere të madhe ka kjo lidhshmëri. Në anën tjetër njohja e rëndësisë së kësaj lidhshmërie e privon njeriun të mendojë për ndonjë fjalë boshe apo nënçmimi ndaj tyre, kështu që kupton vlerën e vetes së tij, e atëherë nxiton me zell të madh që ta zbatojë rolin e tij madhështor të kërkuar nga ai.⁽¹⁰⁷⁾

Shtylla e tretë:

Besimi në libra

Besimi në libra ngërthen në vete disa çështje, si vijojnë:

1. Besimi për ekzistencën e librave të cilat kanë zbritur prej Allahut, gjë kjo që tregon për mëshirën madhështore të Allahut për robërit e Tij. Ai iu zbriti libër çdo populli që të udhëzohen me të, duke jua përshtatur atyre ligjet dhe dispozitat. Kësisoj i sqarohet fëmijës se zbritja e librave nga Allahu është nga begatitë më madhështore. Pasi librat hyjnorë na njoftuan ne për Allahun, botën tjetër, të mirën dhe të keqen.
2. Besimi në librat të cilët i njohëm emrat e tyre, siç janë fletët e Ibrahimit (*alejhis-selam*), Teurati i cili i zbriti Musës (*alejhis-selam*), Zeburi i cili i zbriti Davudit (*alejhi-selam*), Inxhili i cili i zbriti Isës (*alejhis-selam*) dhe Kurani i cili i zbriti Muhamedit ﷺ.
3. Këta libra nuk bien në kundërshtim në mes tyre, por secili e vërteton dhe miraton se çfarë gjendet në tjetrin, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre.”** (Kuran, 5:48).



4. Besimi i ndodhive të vërteta që gjenden në librat e mëhershëm. Duhet t'i bëhet me dije fëmijës se librat qiellorë të mëhershëm kanë pësuar ndryshime dhe shtrembërime, si pasojë që ato libra ishin të kufizuara në kohë dhe Allahu nuk e kishte marrë përsipër mbrojtjen e tyre siç, bëri me Kuranin famëlartë.
5. Të besuarit që Kurani i ka shfuqizuar të gjitha librat e mëparshëm dhe të punuarit me dispozitat e Kuranit fisnik është obligim deri në Ditën e Gjykimit. Duhet t'i bindemi urdhrave të tij dhe të largohemi nga ndalesat e tij. Ta llogaritim të ndaluar çdo gjë që ka ndaluar ai dhe ta pranojmë si të lejuar çdo gjë që ka lejuar ai. Të punuarit me ajetet e qarta që kanë kuptim të drejtpërdrejtë dhe të dorëzuarit para ajeteve që nuk janë të tilla dhe duke u ndalur para kufijve të ndalesave dhe mësimëve të tij.⁽¹⁰⁸⁾

Nga çështjet e rëndësishme të cilat janë pjesë e besimit në libra, llogaritet edhe çështja e nxitjes së fëmijëve ta mësojnë Kuranin famëlartë përmendsh që nga vegjëlia e tyre. Vlerësohet nxënia përmendsh e Kuranit fisnik nga aktivitetet më të rëndësishme për zhvillimin e inteligjencës të fëmijët. Sikur të dijë edukatori të gjallërojë në shpirtin e fëmijës frymën kuranore në mënyrën më të mirë, atëherë Kurani famëlartë do të na ftonë që të mendojmë dhe të meditojmë në krijimin e qiejve e të Tokës, në krijimin e njeriut dhe të gjitha krijesave përreth nesh. Rrjedhimisht do të na shtojë besimi, do të çiftëzohen dituria me punën. Nxënia përmendsh e Kuranit famëlartë dhe njohja e kuptimeve të tij e ngenë njeriun në një nivel të lartë të inteligjencës.⁽¹⁰⁹⁾ Gjithashtu, fëmijës (arab) ia zgjidh gjuhën që të flasë gjuhën standarde të pastër (arabe). Kjo arrihet nga përmirësimi i leximit të tij të gjuhës arabe përmes rregullave të leximit të Kuranit. Kurani ia mëson fëmijës përjetimet hyjnore të frikës, prehjes, shpresës, zbutjes së zemrës dhe ndjenjave të tjera. Ia mëson fëmijës

punën me porositë e shenjta kuranore, moralin e tij në të gjitha sferat e jetës ditore të tij. E edukon fëmijën për një jetë të qëndrueshme dhe virtyte të lavdëruara, duke mos i harruar dobritë e shpërblimeve madhështore dhe mirësitë e mëdha të Allahut të lartësuar të cilat i arrin personi në vendtubimet e nxënies përmendsh të Kuranit.⁽¹¹⁰⁾



Si ta nxisim fëmijën që ta mësojë Kuranin përmendsh?

1. Duke ia sqaruar mirësitë dhe begatitë e Kuranit, mirësitë e nxënies së tij përmendësh, leximit të tij, mësimit të tij, dhe të punuarit me të. Siç është fjala e Profetit ﷺ: “Lexojeni Kuranin sepse ai do të vijë në Ditën e Gjykimit si ndërmjetësues për lexuesit e tij.”⁽¹¹¹⁾ Gjithashtu fjala e tij ﷺ: “I thuhet atij që mësoi Kuranin, lexo, ngrihu dhe këndo ashtu siç këndoje Kuran në dynja, pasi pozita jote do të jetë tek ajeti i fundit që do ta lexosh.”⁽¹¹²⁾ Po ashtu, fjala e tij ﷺ: “*Besimtari që e lexon Kuranin, i shëmbëllen trigjethëshit: aromën e ka të mirë, por edhe shijen e ka të mirë. Besimtari që nuk e lexon Kuranin, i shëmbëllen hurmës: ndonëse nuk ka aromë, shijen e ka të ëmbël. Ndërkaq, hipokriti (munafiku) që e lexon Kuranin i shëmbëllen borzilokut: aromën e ka të mirë, porse shijen e ka të hidhur; e hipokriti (munafiku) që nuk e lexon Kuranin i shëmbëllen kungullit të egër: aromë nuk ka fare e shijen e ka të hidhët.*”⁽¹¹³⁾ Dhe fjala e tij ﷺ: “*Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve.*”⁽¹¹⁴⁾ Shtuar kësaj edhe disa shëmbëlltyra të të parëve tanë të mirë me lidhjen e tyre me Kuranin, pasi janë nga shtytësit më të lartë të ambicieve.⁽¹¹⁵⁾
2. Duke e regjistruar fëmijën në shkolla të nxënies përmendsh të Kuranit, apo në xhami ku mësohet Kurani përmendsh, apo duke e kërkuar për të një mësues që t’ia mësojë Kuranin. Duke ia bashkangjitur kësaj iniciative edhe shtytës të tjerë nga dhuratat apo krijimi i një ambienti garues e sfidues në mes të fëmijëve apo nxënësve.⁽¹¹⁶⁾





3. Duhet patjetër në fillim thjeshtimi i çështjes së nxënies së Kuranit përmendsh për fëmijën, derisa të bëhet kjo gjë e dashur për të. Në fillim le të fillohet me mësimin përmendsh të pjesës së fundi të Kuranit, *xhuzit amme*, ngase karakterizohet me ndërprerje të shkurtra dhe me rimë të përshtatshme dhe kjo lehtëson ngulitjen në mendjen e fëmijës.⁽¹¹⁷⁾ Këto sure përmbajnë shtyllat e besimit, kështu që ia përmirëson atij besimin dhe ia drejton atij sjelljen, madje ia ruan shëndetin dhe qetësinë e fëmijës. Kurani famëlartë gjithashtu është përmendje e Allahut (*dhikr*) dhe shërim (*rukje*).
4. Përgjatë leximit të Kuranit nga fëmija apo nxënies së tij përmendsh duhet të interesohemi t'ia shpjegojmë fëmijës disa kuptime të thjeshtëzuara të Kuranit, në mënyrë të atillë që kuptimet kuranore t'ia hapin zemrën dhe ndriçojnë mendjen. Mos të gabojë ndokush të mendojë që fëmijës së vogël nuk i takon t'i shpjegohet, pasi fëmija përmban fuqi të çuditshme në mësim përmendsh dhe gjithashtu në nxënie të kuptimeve.⁽¹¹⁸⁾
5. Ia mësojmë fëmijës se Kurani është shërim, mëshirë dhe i gjithi bereqet. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët.”** (Kuran, 17:82). Gjegjesisht ai që e mëson Kuranin përmendsh apo ndonjë pjesë të tij, atëherë e ka të lehtë që t'i lexojë Kuran vetes me qëllim të shërimit (*rukje*) kur të sëmuret dhe po ashtu t'ua lexojë të tjerëve përreth.

Shtylla e katërt:

Besimi në profetët



Besimi në profetët nënkupton të besuarit e vërtetësisë së tyre dhe vërtetësisë së ndodhivë të sakta që janë përcjellë prej tyre. Po ashtu, të besuarit në profetët, të cilët i njohim me emrat e tyre, është se Allahu i ka përzgjedhur nga popujt e tyre si të veçantë e të dalluar që ishin në moralin dhe zgjuarsinë e tyre, që ta përcjellin mesazhin hyjnor nga Zoti i tyre. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t’u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit).”** (Kuran, 14:4). Sikur të ishte profeti i dërguar engjëll nuk do ta kuptonin. E kemi për detyrë të mos bëjmë dallime në mes të profetëve, me fjalë tjera: që t’iu besojmë disave dhe disa të tjerë t’i përgënjeshtrojmë, por u besojmë të gjithëve. Pra, të gjithë profetët ishin të saktë në përcjelljen e shpalljes së Zotit. Ishin besnikë në këshillimin e popujve të tyre, ata janë të mbrojtur nga gabimet në lidhje me përcimin e shpalljes nga Zoti. Ndërsa ne nuk e kemi për detyrë të punojmë vetëm se me legjislacionin e Profetit të fundit prej tyre, që ai është Muhamedi ﷺ.⁽¹¹⁹⁾



Nga kuptimet edukuese të cilat është e udhës t'i kultivojmë fëmijëve në lidhje me besimin në profetët janë siç vijojnë:

- 1.** Të sqaruarit e fëmijëve që Allahu i Lartësuar për çdo popull ka dërguar profet nga mesi i tyre, me qëllim që t'i thërrasin popujt e tyre që ta adhurojnë vetëm Allahun e Lartësuar, që meriton adhurimin, dhe mohimi i adhurimit të çdogjëje tjetër pos Tij. Dhe duke ua sqaruar që të gjithë profetët ishin të sinqertë, të vërtetë, të çiltër, bamirës, të drejtë, besnikë e të devotshëm.
- 2.** Sqarimi që esenca e thirrjes së të gjithë profetëve ishte një, e përbashkët, që është njeshmëria e Zotit, të veçuarit vetëm të Allahut të Lartësuar me të gjitha llojet e adhurimeve, me besim në zemër, me gjuhë dhe gjymtyrë. Gjegjësisht duke i mohuar të gjithë që adhurohen në vend të Tij.
- 3.** Sqarimi i urtësive të Allahut në dërgimin e profetëve të krijesat e Tij. Prej tyre mund të cekim: adhurimi i Allahut të Madhëruar dhe njësimi i Tij, udhëzimi i njerëzve për të udha e drejtë, t'ua mësojnë njerëzve fenë dhe gjërat e tjera të jetës së kësaj bote, nxjerra e njerëzve nga errësira në dritë, udhëheqja e popullit dhe zbatimi i ligjeve të Allahut, edhe të qenit e tyre shëmbëlltyrë, me qëllim që të pasohen gjurmët e tyre të rrugës së drejtë.

4. Dituria për mëshirën e Allahut të Lartësuar për robërit e Tij dhe kujdesin e Tij ndaj tyre, sa që dërgoi të dërguar me qëllim që t'i udhëzojë ata për tek udha e Allahut të Lartësuar. Përkujtimi që duhet falënderuar Allahun për këtë begati madhështore dhe që duhen dashur të gjithë profetët, pasi ata e përcollën Shpalljen dhe i këshilluan robërit e Allahut. Njerëzve sado që iu është dhënë zgjuarsia dhe mençuri, atyre asnjëherë nuk mund t'iu pavarësohen mendjet e tyre për vendosjen e një rregulli të përgjithshëm përmirësues të umetit nga të gjitha anët, për dallim nga umeti islam që është i kapur, i bashkuar dhe i barabartë në dhënien e së drejtës gjithsecilit siç i takon sipas mësimave hyjnore. Pra, profetët u mësojnë njerëzve çfarë u bën dobi dhe çfarë i dëmton.⁽¹²⁰⁾
5. Mbjellja e dashurisë për të Dërguarin e Allahut ﷺ që t'i binden atij, t'i pasojnë gjurmët e tij, ta madhërojnë dhe mos ta parakalojnë në dashuri dikë tjetër pos tij ﷺ. Të dashurit e të gjithë atyre që e duan të Dërguarin e Allahut dhe të armiqësuarit e të gjithë atyre që e armiqësojnë atë.⁽¹²¹⁾ Shtuar kësaj, nderimin e emrit të tij kur të përmendet duke dërguar *salavate* dhe *selame* për të ﷺ, duke i vlerësuar virtytet dhe mirësitë e tij, siç ishte shumë i mëshirshëm, mëshironte e ndjente keqardhje.⁽¹²²⁾

Si t'ia mësojmë fëmijës dashurinë për Profetin ﷺ?

1. Duhet që patjetër t'ia theksojmë se Allahu i Lartësuar e do të Dërguarin e Tij ﷺ, e ka përzgjedhur atë dhe e ka ngritur dhe nderuar mbi të gjithë njerëzit. Allahu na obligoi ne që ta duam atë, dhe t'ia mësojmë fëmijëve që dashuria për Profetin ﷺ është nga shenjat e dashurisë për Allahun e Lartësuar, në mënyrë që ai që e do të Dërguarin e Allahut, ai e do Allahun me dashuri të singertë.⁽¹²³⁾
2. T'ua kujtosh fëmijëve që Profeti ﷺ u dërgua si mëshirë për të gjitha botët, me udhëzimin dhe përcjelljen e kësaj feje. Gjithashtu, do të jetë mëshirë për besimtarët kur të ndërmjetësojë për ta në Ditën e Gjykimit.
3. Duke iu lexuar fëmijëve biografinë e bukur të Profetit ﷺ. T'i qartësohet fëmijës se i Dërguari i Allahut ﷺ është shëmbëlltyra më e lartë që duhet pasuar nga të gjithë njerëzit. Përmendja e disa nga shenjave dhe mrekullive të profetësisë së tij ﷺ, moralit të tij madhështor, ndihmesa e tij ndaj të shtypurve, butësia e tij ndaj të varfërve, porosia e tij për jetimin, mëshira dhe ndjeshmëria e tij për të dobët, etj.⁽¹²⁴⁾ Është e udhës që gjuha jonë e bisedës me fëmijët të jetë e përshtatshme me zhvillimin e fëmijës, duke u mjaftuar me çështje të cilat i percepton niveli i tij intelektual, me qëllim që ta kuptojë sa më mirë. Gjithnjë duke u munduar për ndryshimin e metodave të prezantimit duke i pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të cilat i përshtaten periudhave të moshës së fëmijës, shtuar kësaj edhe kujdesin për natyrën e ndryshimeve individuale dhe kushteve të rrethit që e rrethon.⁽¹²⁵⁾

4. Duke e vërejtur fëmija në prindërit e tij, apo rrethin që jeton madhërimin e Profetit ﷺ, madhërimin e trashëgimisë profetike dhe fjalëve të tij. Zellin në pasimin e tij dhe gjurmëve të tij, kujdesin e vazhdueshëm të çuarjes së *salavateve* për të kurdo që i përmendet emri i tij ﷺ. Sjellja e prindërve, zbatimi i tyre praktik, udha e tyre është ndikuesi më i madh në edukimin e fëmijëve. Atëherë kur prindi t'i zbatojë sunetet dhe veprat vullnetare duke i treguar fëmijës se kjo ishte praktika e të Dërguarit të Allahut ﷺ, atëherë pra, edukimi përmes shëmbëlltyrës do t'i japë frytet e saj më të mëdha përgjatë rritjes dhe zhvillimit të duhur nën edukimin e besimit të shëndoshë. Profeti ﷺ është shëmbëlltyra jonë më e mirë dhe më e lartë, të cilin edukatorët duhet ta pasojnë dhe të ecin gjurmëve të tij të udhëzimit, zbatimit praktik të të gjitha porosive të tij bashkërisht me fëmijët e tyre.⁽¹²⁶⁾
5. Inkurajimi i fëmijëve për mësimin e disa haditheve të sakta të cilat vënë në pah përsosurinë dhe bukuritë e fesë islame, virtytet dhe cilësitë e Profetit ﷺ apo vlerën e sahabëve (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*). Hadithet kanë një ndikim të madh në besimin, moralin dhe ndërtimin e personalitetit, për t'i inkurajuar fëmijët që t'i mësojnë hadithet, atëherë pëlqehet të zgjidhen hadithe të shkurtra, të qarta për t'u kuptuar, që përmbajnë morale të rëndësishme për moshën e tyre,⁽¹²⁷⁾ me këtë rast mund të përdoren garat dhe konkurset për t'i nxitur, duke përdorur metoda që ngjallin interes e duke ia bashkangjitur disa dhurata e shpërblime.
6. Rrëfimi i tregimeve të sahabëve në raportet e tyre me Profetin Muhamed ﷺ, theksimi i madhërimit të tyre karshi tij ﷺ dhe xhelozinë e tyre për të. Sidomos tregimet e sahabëve të rinj, siç është rrëfimi i Enesit dhe zelli e tij i madh në pasimin e të Dërguarit të Allahut ﷺ, siç tregon Enesi që një rrobaqepëse ftoi Profetin ﷺ për një ushqim të cilin e kishte përgatitur. Thotë Enesi: “Shkova bashkë me Profetin ﷺ për tek ai ushqim. Rrobaqepësi i shërbeu Profetit ﷺ një copëz buke nga elbi dhe supë që përmbante kungull dhe mish të tharë. (vazhdon Enesi të rrëfejë) E pash Profetin ﷺ që e ndiqte kungullin rreth e përqark pjatës. Prej atij momenti vazhdoj ta pëlqej kungullin.” Gjithashtu, përcjell Thumameh nga Enesi (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*) i cili thotë: “Atëherë e mblidhja kungullin dhe e vendosja përpara tij ﷺ.”⁽¹²⁸⁾ Kësisoj kujdeset edukatori ta vë në dukje se si e donin sahabët (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*) Profetin ﷺ dhe se si sakrifikonin për të, duke e ilustruar me tregimet e tyre.⁽¹²⁹⁾

7. Të sqaruarit se çfarë ndikimi rrjedh nga dashuria për të ﷺ. Përcillet në hadithin e Enesit (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) se një njeri e pyeti Profetin ﷺ për Ditën e Kiametit: “Kur do të ndodhë Kiameti?”. Profeti ﷺ iu përgjigj: “Çfarë ke përgatitur ti për të?” Atëherë ai tha: “Nuk kam përgatitur shumë, përveçse unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e tij ﷺ?” Profeti ﷺ tha: “Ti do të jesh me atë që e do.”. Thotë Enesi: “Nuk jemi gëzuar më shumë se sa gëzimi për fjalët e Profetit: “Ti do të jesh me atë që e do.” dhe unë e dua Profetin ﷺ edhe Ebu Bekrin, edhe Omerin dhe shpresoj të jem me ta me dashurinë time për ta, ndonëse nuk kam punuar siç kanë punuar ata.”⁽¹³⁰⁾
8. Përkrahja e fëmijës në krijimtarinë e tij për dashurinë ndaj Profetit ﷺ. Bie fjala: të shkruarit e poezisë, ndonjë tregimi, artikulli apo përgatitja e ndonjë ligjërimi, si dhe duke ia shoqëruar nxitjes së tij me gara e konkurse të ndryshme rreth tematikës së dashurisë për të Dërguarin e Allahut ﷺ.⁽¹³¹⁾



Shtylla e pestë:

Besimi në Ditën e Gjykimit

Të besuarit në Ditën e Gjykimit do të thotë të besosh vdekjen, ringjalljen, llogaridhënien, shpërblimin apo ndëshkimin, Urën e Siratit mbi Xhehenem, Peshoren, Xhenetin dhe Xhehnemin. Fëmija pas moshës së pjekurisë fillon t'i kuptojë disa çështje të Ditës së Gjykimit. Ndërsa para kësaj moshe është e preferuar që tematikat e kësaj dite t'i përmenden shkurt e të përmbledhura, duke ia qartësuar fëmijës se ekziston një jetë tjetër në botën e ardhshme, pos kësaj të cilën e jetojmë, dhe që Allahu e ka krijuar Xhenetin vendbanim të përhershëm për besimtarët dhe Xhehenemin për jobesimtarët.⁽¹³²⁾

Nga kuptimet më tërëndësishme të edukimit që duhet gdhendur te fëmija në lidhje me besimin në Ditën e Gjykimit janë siç vijojnë:

1. T'i sqarohet fëmijës që Allahu i Lartësuar do t'i ringjallë njerëzit pas vdekjes së tyre që t'i shpërblejë apo ndëshkojë për punët e tyre në këtë botë, nëse kanë bërë vepra të mira atëherë shpërblehen me Xhenet, e nëse kanë bërë vepra të këqija atëherë do të ndëshkohen me Xhehenem.
2. T'i sqarohet fëmijës që Allahu i Lartësuar e ka caktuar Xhenetin si vendbanim i përhershëm i lumturisë dhe dinjitetit. Allahu i Lartësuar e ka krijuar atë që t'i shpërblejë me të robërit e tij besimtarë, ndërsa e ka krijuar zjarrin e Xhehenemit si ndëshkim për jobesimtarët. Gjithnjë, qartësimi ndaj fëmijës të jetë përmes inkurajimit dhe nxitjes në begatitë e Xhenetit dhe se çfarë u ka përgatitur Allahu në të besimtarëve të Tij.
3. Të biseduarit me fëmijën rreth vdekjes dhe botës tjetër me një mënyrë të butë që e vë në dukje mëshirën e Allahut, faljen dhe dashamirësinë e Tij për robërit e Tij, në atë mënyrë që mos ta kaplojnë fëmijën mendime ngacmuese.⁽¹³³⁾ Gjegjësisht mund t'i lidhet tematika në fjalë me të gjitha krijesat e tjera të gjalla që do t'i kalojnë këto etapa, por njeriun Allahu e dalloi duke i ngarkuar detyrën e adhurimit të Tij, ndërsa të gjitha krijesat e tjera ia nënshtroi atij dhe i premtoi që do ta shpërblejë.
4. T'i qartësosh fëmijës se Allahu nuk e miraton zullumin dhe zullumqari nuk i shpëton dot dënimit. Gjithashtu, edhe atij që i është bërë padrejtësi nuk do ta lërë Allahu pa ia dhënë drejtësinë e merituar edhe se çdo vepërmirë do t'i korrë shpërblimet e veprave të tij. Ne, çdo ditë, shohim në jetën e kësaj bote se si jetojnë disa zullumqarë dhe vdesin si të tillë, prandaj patjetër që ekziston jeta e botës tjetër, përveç kësaj jete të cilën e jetojmë, me ç'rast gjithsecili do të marrë të drejtën e tij, punëmiri do të shpërblehet e keqbërësi do të dënohet.⁽¹³⁴⁾

Shtylla e gjashtë:

Besimi në paracaktimin e Allahut



Të besuarit në paracaktimin e Allahut nënkupton besimi në diturinë e plotë të Allahut, të shkruarit e Tij, dëshirën e Tij dhe të krijuarit e Tij. Fëmija në fillim të moshës së vegjëlisë nuk arrin ta kuptojë paracaktimin e Allahut. Disa thonë se nuk arrin ta kuptojë këtë tematikë deri pas moshës nëntë vjeçare, afërsisht.⁽¹³⁵⁾ Mirëpo, disa kuptime edukative në lidhje me kapitullin e paracaktimit të Allahut duhet t'i gdhenden fëmijës, si për shembull:


1. Baza për këtë kapitull është hadithi i përcjellë nga Abdullah ibn Abasi (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) i cili ka thënë: “Një ditë, ndërsa isha mbrapa të Dërguarit të Allahut ﷺ më tha: ‘O djalosh, po t’i mësoj disa fjalë: *Ruaje Allahun, që Ai të të ruajë ty! Ruaje Allahun, që ta kesh pranë! Kur të lypësh, lypi Allahut e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu! Gjithashtu, dije se, po qe se të gjithë njerëzit do të mblidheshin për të të bërë mirë, nuk do të mund të të bëjnë mirë, pos asaj që ta ka caktuar Allahu dhe anasjellas, nëse bashkohen për të të bërë dëm, nuk do të mund të të dëmtojnë, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Tashmë lapsat janë ngritur dhe fletët janë tharë.*”⁽¹³⁶⁾ Në një transmetim tjetër, thuhet: “*Ruaje Allahun, që ta kesh para vetes! Njihe Allahun kur të jesh në rehati, që të të njohë kur të jesh në vështirësi! Gjithashtu, dije se ajo që nuk të ka goditur, nuk do të mund të të godiste dhe se ajo që të ka goditur, nuk do të mund të të mos godiste. Po ashtu, ta dish se fitorja është me durimin, shpëtimi me mundimin dhe vështirësia me lehtësimin.*”⁽¹³⁷⁾ Ky hadith profetik, sinqerisht, llogaritet burim i edukatës që përfshin shumë udhëzime të mira nga Profeti bujarë ﷺ për umetin e tij që të jenë të kujdesshëm ndaj fëmijëve të tyre, në mënyrë që të rriten e të edukohen nën hijen e besimit të shëndoshë.⁽¹³⁸⁾
2. Në esencë duhet shmangur kjo temë e diskutimit me fëmijën në moshë të vegjëlisë së tij, ndërsa në anën tjetër fëmijës duhet t’i flitet dhe sqarohet gjerësia e hershme e diturisë së Allahut, fuqia e Tij, gjithpërfshirja e Tij, vullneti e dëshira dhe krijimtaria e Tij; gjithnjë duke ia shoqëruar kësaj miratimit e vullnetit të lirë të njeriut, përgjegjësinë e tij të plotë për veprat e zgjedhura prej tij. Gjegjësisht të arritjes së shpërblimit apo ndëshkimit sipas veprave të tij, shkurtimisht. Ndërsa nëse kjo çështje ia mbulon horizontin e të menduarit fëmijës, atëherë edukatori e ka për detyrë aq sa të ketë mundësi t’ia sqarojë në një mënyrë të thjeshtësuar që ta kuptojë mendja e tij.

3. Edukimi i fëmijës që kërkesat t'ia parashtrojë Allahut të Lartësuar dhe të mos i kërkojë dikujt tjetër pos Tij, të kërkojë ndihmë vetëm prej Tij, lutjen t'ia drejtojë vetëm Allahut të Madhëruar. I mësohet, gjithashtu, që të mbështet në Allahun, duke ia mësuar durimin në caktimet e Allahut.
4. T'i mësohet fëmijës që, me të vërtetë, Allahu ia do të mirën atij. Ai ndodhet në këtë jetë në pritje të caktimeve të Allahut. Kësisoj fëmija nuk do të mërzhitet e as pikëllohet, por i përballon vështirësitë me shpirt të kënaqur me caktimet e Allahut, duke qenë i bindur që fjalën e të Lartësuarit: **“Thuaj: ‘Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu.’”** (Kuran, 9:51).
5. T'i mësohet fëmijës që ndodhitë e çështjeve janë në dorë të Allahut të Lartësuar dhe që Ai bën çfarë të dojë dhe zgjedh çfarë të dojë. Atij i takon pushteti absolut mbi krijesat e tij. Kjo shpie te forcimi i lidhjes së fëmijës me Krijuesin e tij dhe nxitimi drejt Tij, e rrjedhimisht do t'i lidhë të gjitha shpresat, synimet, lutjet e tij me Të, Allahun e Lartësuar.




- 6.** Besimi në këtë shtyllë të besimit e përmbush qëndrueshmërinë e zemrës së fëmijës. Kur besimtari ta ndiejë se çfarëdo që i ndodhë atij, qoftë mirë apo keq është mirësi për të dhe që nuk ekziston ndonjë e keqe absolute, atëherë ai do të ndiejë qetësi e prehje shpirtërore dhe qëndrueshmëri. Kjo do ta bëjë fëmijën që të përballet me problemet, lodhjet, brengat e tij me një zemërgjerësi ndaj caktimeve të Allahut, e kështu do t'ia dorëzojë çështjet e tij Allahut dhe do të jetojë me zemër të qetë e mendje rehat.⁽¹³⁹⁾ Ai që beson në paracaktimin e Allahut të Lartësuar nuk do të pikëllohet, nuk do të jetë i padurueshëm dhe nuk inatoset përgjatë sprovave dhe fatkeqësive, por ai i nënshtrohet caktimit të Allahut dhe llogarit shpërblimin e Tij, duke e kujtuar fjalën e Allahut në goditjen e parë të sprovës: **“Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: ‘Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!’ Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!”** (Kuran, 2:155-157).⁽¹⁴⁰⁾
- 7.** Mund të ndihmohemi me disa tregime e ndodhi që u kanë ngjarë njerëzve të cilët në fillim i llogaritën si fatkeqësi të mëdha caktimet e Allahut për ta, e më pas u qartësuan atyre mirësitë e fshehura pas atyre caktimeve të Allahut të Lartësuar, aq sa gjendja dhe çështjet e tyre u përmirësuan më mirë se sa që ishin.
- 8.** Besimi në paracaktimin e Allahut përmbledhet në atë se Allahu i Lartësuar është më i Dituri për çdo gjë në përgjithësi dhe veçanti dhe që Ai i shkroi nga dituria e Tij e hershme e pafillim caktimet e krijesave se çfarë do të ngjajë deri në Ditën e Kiametit në Pllakën e Ruajtur dhe se të gjithë krijesat dhe gjërat nuk do të ndodhin pa vullnetin dhe krijimin e Tij.





**Parahyrje rreth
përgjigjeve**



Krijuesi

Krijuesi i Madhëruar e ka inspiruar fëmijën që t'i dojë pyetjet, në atë mënyrë që të shtojë në bagazhin e mendjes së tij sa më shumë që të ketë mundësi nga botëkuptimet dhe informatat aq sa llogaritet etapa e fëmijërisë sikur etapa e pyetjeve, pasi shumica e bisedës së fëmijës në këtë moshë është në formë të pyetjeve.⁽¹⁴¹⁾ Kështu, fëmijët ndiejnë sikur asgjë nuk kuptojnë nga gjërat përreth tyre dhe, meqë mosdija prodhon frikë, atëherë fëmijët me të gjitha forcat e tyre hidhen në sulm që të mësojnë. Siç mund të hasim fëmijën tre-vjeçar i cili iu drejtohet prindërve apo vëllezërve të tij të mëdhenj me dhjetëra e dhjetëra pyetje çdo ditë. Padyshim, përgjigjet e tyre do të ndikojnë tek ai, siç vihet në pah tek ai kalimi prej një gjendje në tjetrën, si dëshmi ai vazhdimisht ndryshon formën e pyetjes apo temës për të cilën interesohet.⁽¹⁴²⁾ Ti do t'i dëgjosh vazhdimisht nga fëmija pyetjet: Çfarë? Ku e ka vendin? Si ndodhi? Nga arriti? Kush është ai? Kush është ajo? A e di...?, etj. Singërisht ai do të dijë çdo gjë që ia tërheq vëmendjen atij, ka ëndje t'i kuptojë gjërat të cilat i shikon apo i dëgjon, ndonëse mund t'i kuptojë përgjigjet, por edhe mund të mos i kuptojë ato. Ndodh që të dëgjojë mjaftueshëm sa t'i përgjigjesh, por ndodh edhe e kundërta.⁽¹⁴³⁾

Fëmija, në të vërtetë, është një kureshtar i madh që e do zbulimin e gjërave. Kjo kureshtje e tij mund të rritet sipas ambientit në të cilin jeton, apo sipas hapësirës së dhënë atij. Këtë e vërejmë më së miri se si çuditemi me pyetjet e fëmijëve të kohës së sotme, kur i krahasojmë me pyetjet tona në vegjëli. E gjitha kjo si dallim i kohës, vendit dhe zhvillimeve bashkëkohore të njohurive. Padyshim, metodat e zgjedhura të edukatorëve për trajtimin e pyetjeve të fëmijës ndikojnë në vetë dukuritë e pyetjeve, në shtimin apo pakësimin e tyre. Rrjedhimisht edukatori që i jep hapësirën e duhur pyetjeve të fëmijëve dhe i pranon pyetjet e tyre me hare e gëzim, atëherë do ta ketë mundësinë të zhytet thellë në personalitetin e fëmijëve, në dallim nga ai që nuk i duron pyetjet e fëmijëve, i refuzon ato, apo i pranon me bërtitma e britma, atij nuk do t'i shfaqet asgjë nga fëmijët.⁽¹⁴⁴⁾ Gjithsesi, ne pajtohemi që jo çdo gjë i tregohet fëmijës, nuk është për të mirën e tij dhe as e pranueshme që fëmijët të njoftohen për gjithçka. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që fëmija të mos frikësohet që të pyesë për disa gjëra të cilat ndikojnë në jetën e tij. E rëndësishme është që fëmijët të mos ndiejnë mosprezencën e tyre, mungesën e vëmendjes së mjaftueshme apo që nuk janë të besueshëm. Ndërsa edhe më e rëndësishme është që fëmijët të ndiejnë zemërgjerësinë dhe bujarinë e prindërve, ndërkohë që flasin me ta.⁽¹⁴⁵⁾

Arsyet e pyetjeve të shumta të fëmijëve




Arsyet më të rëndësishme që e shtyjnë fëmijën t'i parashtojë pyetjet e shumta janë siç vijojnë:

1. Dëshira e flaktë e fëmijës për të zbuluar dhe hulumtuar, si mjet i ngopjes së kërkesave të zhvillimit mendor.⁽¹⁴⁶⁾
2. Nevoja e fëmijës që t'i kuptojë të gjitha gjërat të cilat e rrethojnë sipërfaqësisht.
3. Paniku dhe frika e fëmijës karshi gjërave për shkak të mos përvojës së tij me to; p.sh.: fëmija frikësohet nga disa kafshë, edhe nëse nuk e sulmojnë ato, kështu ai pyet shumë që të ndihet i sigurt.

4. Zhvillimi i aftësive gjuhësore te fëmijët, kështu kur shtron ndonjë pyetje, e pason atë me një pyetje tjetër, ndonëse jo nga dëshira për përgjigje se sa nga dëshira që ta praktikojë gjuhën, të krenohet me aftësitë e tij dhe nevoja e tij për të qenë pjesë e shoqërisë.
5. Hapësira e komunikimit dhe pjesëmarrja emocionale në mes të prindërve dhe fëmijëve.
6. Zhvillimi i guximit të fëmijës dhe besimit të tij në prindërit dhe respektimi i vetvetes.⁽¹⁴⁷⁾

Natyra e pyetjeve te fëmijët



Që ta kuptojmë natyrshmërinë e pyetjeve të fëmijës në mënyrë sa më të mirë, duhet doemos të bëjmë dallimin në mes pyetjeve logjike a gjuhësore dhe atyre psikike. Lloji i parë ka të bëjë me përpjekjet e fëmijës që të njohë ndonjë gjë apo të rrëfejë për të. Shtytës i llojit të dytë të pyetjeve është kërkimi i prehjes shpirtërore dhe qetësisë; pra nuk është caku vetëm përgjigja. Kësisoj patjetër duhet të qartësojmë një të vërtetë esenciale: pyetja sigurisht ka anën e saj dëftuese. Me fjalë të tjera: ne nuk arrijmë ta kuptojmë rëndësinë e pyetjes, apo ta kuptojmë, apo kufizojmë qëllimin e saj vetëm se përmes ndodhisë së caktuar që e ka shpënë fëmijën që të pyesë. Pra, pyetja, në vetvete, nuk ka ndonjë peshë të madhe, por ajo e merr vlerën, peshën, fuqinë dhe rëndësinë e saj si pasojë e natyrës së ndodhisë apo gjendjes përreth saj. Pyetjet, në të vërtetë, kanë tri funksione të rëndësishme, nga ana e të cilave formohen:

1. Arritja e baraspeshës shpirtërore te fëmija; kështu që shumica e pyetjeve të fëmijës kanë pikënisjen psikike.
2. Mendësia hulumtuese; kështu që fëmija përpiqet të arrijë te njohuritë e reja duke i ndërtuar ato mbi njohuritë e vjetra apo duke i lidhur mes tyre.
3. Njohja e ambientit që e rrethon dhe e çështjeve të rëndësishme të jetës; prej tyre: njohja me vlerat e moralit dhe sjelljeve, të cilat ngjajnë brenda ambientit kulturor dhe shoqëror në të cilën jeton fëmija.⁽¹⁴⁸⁾

Llojet e pyetjeve te fëmijët



Është mjaft e rëndësishme që të kategorizohen pyetjet që parashtrojnë fëmijët. Kësisoj përgjigjet do të varen në bazë të llojit të pyetjeve. Pyetjet e fëmijëve mund t'i kategorizojmë në këtë mënyrë:

1. **Pyetjet të cilat kanë natyrë gjuhësore**, ngjashëm me: Pse janë emërtuar gjërat me këta emra? Pse të mos ua ndërrojmë emërtimet? Pse të mos e zbulojmë një gjuhë tjetër të re?
2. **Pyetje të lidhura me ekzistencën**, ku në këtë frymë vijnë pyetjet e ngjashme si: Prej nga kemi ardhur? Ku do të shkojmë? Prej nga vijnë fëmijët? Çfarë do të thotë vdekja? Po gjithësia çfarë është?... etj.
3. **Pyetje rebelimi**, të cilat fokusohen sipas idesë: Pse nuk u lejohe fëmijëve çështjet që u lejohe të të rriturve? Këto pyetje vijnë më shumë si përpjekje e fëmijëve të ngjasojnë me të rriturit se sa që u ngjasojnë formës së pyetjeve në të vertetë.
4. **Pyetje provokuese**, janë ato të cilat fëmijët i sprovonë aftësitë e anëtarëve të familjes duke i kundërshtuar më pas pikat e dobëta të cilat i hasin te ta. Në shumicën e rasteve janë përzierje e krahasimeve mes familjes dhe familjeve të shoqërisë së tij, që zakonisht sillen rreth vatrës së mundësive ekonomike dhe fizike të familjes.

5. **Pyetje të shqetësimeve fëmijërore**, shpesh herë fëmijët i parashtrojnë këto lloje pyetjesh në kompensim të ndjenjave shqetësuese që gjenden tek ata, me ç'rast nga pyetjet me të shpeshta që i mundojnë fëmijët janë pyetjet përreth mungesës së ndonjërit prej prindërve, apo dukuri tjera të braktisjeve.
6. **Pyetjet hulumtuese përreth fizionomisë trupore**, ku në fillim të këtyre pyetjeve hulumtuese të shtruara nga fëmija prijnë pyetjet që kanë të bëjnë me dallimet e fizionomisë trupore në mes të dy gjinive.

Nga ky kategorizim i pyetjeve mund të ndihmohen prindërit apo edukatorët që t'i kuptojnë prapavijën e pyetjeve të shtruara nga fëmijët e tyre; pra ngaqë fëmijët nuk pyesin vetëm se për ndonjë arsye të cilën mundohen ta kuptojnë.⁽¹⁴⁹⁾

Pse ndodh që prindërit mos t'i përfillin pyetjet e fëmijëve?

Në të vërtetë mospërfillja e pyetjeve të fëmijëve nga ana e prindërve apo mërzitja prej tyre nuk është vetëm për arsye të mos njohurive që t'iu përgjigjen atyre, e as si pasojë e mosnjohjes së rëndësisë shpirtërore dhe edukative tek ata, por për arsye të tjera, siç do të mundohemi t'i përmendim në vijim më të rëndësishmet prej tyre:

1. Habia e të rriturit me llojin e pyetjes së të voglit, apo me mendjelehtësinë e tij, apo mos seriozitetin e tij. Kjo e bën të madhin të mos interesohet shumë dhe të mos i kushtojë vëmendje të voglit. Rrjedhimisht i rrituri bie pre e nëpërkëmbjes së të drejtave të të vegjëlve në mënyrën e veçantë të të menduarit të tyre, i cili veçohet me thjeshtësi e qartësi. Dhe kjo nëpërkëmbje manifestohet si dukuri e fuqisë së zgjuarsisë së të mëdhenjve, duke harruar që fëmija bën pyetje të thjeshta, të padjallëzuara i shtyrë nga kureshtja e çiltër për njohuri, apo që të zbulojë botën përreth tij, e le më qëllimin shpirtëror të nxituar të pyetjes së tij me anë të së cilës kërkon të gjejë balancimin shpirtëror të humbur nga ndonjë ndodhi e caktuar.
2. Perceptimi i të rriturve të vështirësive të pyetjes së shtruar nga fëmija, sidomos atëherë kur pyetja është e lidhur me ndonjë anë të ndalesave shoqërore apo është e lidhur me ndalesat morale, brenda një rrethi të caktuar kulturor. Në këtë rast nuk lejohet të diskutohen këto pyetje vetëm se në një moshë të caktuar, e kështu vështirësitë e pyetjeve të fëmijëve dhe ngjyrimi i tyre me siklet i shpie të rriturit në huti. Prandaj të rriturit duhet të përgatiten shumë mirë për t'iu dhënë përgjigje të shëndoshë fëmijëve në pyetjet e tyre.
1. Ndonjëherë pyetjet e shumta të fëmijëve formohen njëra pas tjetrës si ndonjë shkak i mospërfilljes së të mëdhenjve. Por, sikurse të mëdhenjtë ta kuptonin rëndësinë e pyetjeve të fëmijëve nga ana shpirtërore, atëherë sigurisht do të mbanin qëndrim tjetër karshi tyre, do t'i nxisnin fëmijët e tyre që të vazhdojnë të pyesin, që pothuajse mendimet e tyre të jenë të dëgjueshme.

- 4.** Nga shkaqet që i bëjnë prindërit të mos u kushtojnë vëmendjen e duhur disa pyetjeve të fëmijëve është se ato shtrohen nganjëherë në formë përmbajtjesore dhe jo të drejtpërdrejtë.
- 5.** Ndodh të jetë shmangia e prindërve nga pyetjet e fëmijëve si pasojë e mos njohurive të tyre për atë çfarë fëmija dëshiron të njohë. Kësisoj u themi prindërve që e keni për detyrë të kërkonit përgjigje për pyetjet e fëmijëve tuaj dhe t'i njoftoni ata me besnikëri dhe vërtetësi.⁽¹⁵⁰⁾
- 6.** Lënia pas dore e pyetjeve të fëmijëve, si pasojë e kufizimit të aftësive të të kuptuarit të tyre, të cilat kërkojnë përgjigje shumë të thjeshtësuara që vështirë arrihen. Në këtë rast prindërit fillojnë të mendojnë se si t'ia përçojnë fëmijës përgjigjen e më pas e lenë pas dore pyetjen e tij.⁽¹⁵¹⁾



Si duhet të sillen prindërit karshi pyetjeve të fëmijës?

Detyra e prindërve është paraqitja e përgjigjeve të vërteta të sakta ndaj pyetjeve të fëmijëve. Shtuar kësaj, ata duhet të bëjnë gati terrenin e dialogut dhe bisedës rreth paqartësive të fëmijëve të tyre në tematikat e besimit, gjithashtu të ndihmuarit e tyre që t'i vënë në dukje mendimet e tyre rreth fesë. Kjo për shkak që të përçojnë tek ata sigurinë, prehjen dhe të kuptuarit e drejtë të fesë, me ç'rast e ruajnë balancën e tyre fetare larg lënies pas dore në njërën anë dhe teprimit të shtrengimit të fesë në anën tjetër.⁽¹⁵²⁾ Nuk do të thotë që prindërit t'i kenë të gjitha përgjigjet e sakta për pyetjet fetare të fëmijëve të tyre, mirëpo atyre u përket t'ua sqarojnë shtyllat e besimit, derisa të rritet e bëhet djalosh/vajzë me besim të fortë në Allahun e Madhëruar.⁽¹⁵³⁾

Sa bukur do të ishte sikur prindërit ta angazhonin fëmijën më të madh të tyre që t'i regjistrojë pyetjet e fëmijëve të vegjël. Zakonisht do ta marrë këtë detyrë me gëzim, sidomos nëse inkurajohet dhe e ndjen rëndësinë e saj. Gjithashtu, edhe prindërit do të gjenin kënaqësi në këtë aktivitet. Pra, nga njëra anë do të mbjellim në personalitetin e fëmijës së madh rëndësinë e pyetjeve në përgjithësi dhe peshës së tyre dhe kështu ata do të pyesin pa ngurrim, dhe do të gdhendim në ta kujdesin ndaj pyetjeve të fëmijëve të tyre në të ardhmen, atëherë kur vetë të bëhen prindër. Ndërsa në anën tjetër neve na mblidhen pyetje të cilat na hyjnë në ndihmë për kërkimin e përgjigjeve ndaj tyre dhe na ndihmojnë për pyetjet e mundshme që mund t'i bëjnë vëllezërit apo motrat pas tyre, e kështu duhet përgatitur për to. Sa do të gëzohet fëmija kur shpejtojmë t'i përgjigjemi në ndonjë pyetje prej pyetjeve të tij të kaluara! Pra, kujdesi për një përgjigje bindëse të mirë për pyetjet e tij do të ketë ndikim të madh, me lejen e Allahut, tek ai dhe në lidhjen tonë me të. Kësisoj do të bëhen prindërit burimi kryesor i njohurive për fëmijën, burim i sigurt për vitet e ardhshme në vend që t'i marrë njohuritë nga burime të dyshimta, sidomos përgjatë moshës së adoleshencës.⁽¹⁵⁴⁾

Vlen të ceket një pikë ndaj së cilës është e udhës që prindërit të tregojnë kujdes, e ajo është domosdoshmëria e dallimit të pyetjeve të fëmijëve.

Së pari, pyetjet këmbëngulëse të cilat i vërejmë që fëmija po i përsërit shpesh ato, aq sa mund t'ua parashtrojë më shumë se një personi prej anëtarëve të familjes, ku prej saj mund të lindin edhe pyetje të tjera.

Së dyti, pyetjet e atypëratyshme, ku sikur t'ia ndërrojmë temën fëmijës përgjatë bisedës do ta harrojë atë pyetje. Prandaj, në llojin e pyetjeve të para nuk është nga mençuria të lihen pas dore, kësisoj përpiqemi në përgjigjen ndaj tyre, duke e kërkuar përgjigjen e saj apo gjurmimin e ndonjë personi i cili e zotëron atë përgjigje më mirë. Ndërsa lloji i pyetjeve të atypëratyshme, nuk ka problem edhe sikur të shmangen, sidomos kur kanë të bëjnë me çështje që fëmija nuk i kap dot.

Parimet e trajtimit të pyetjeve të fëmijëve



Përgjatë përgjigjeve të pyetjeve të fëmijëve prindërit duhet t'i kenë parasysh disa parime dhe vlera që duhet kujdesur për to, siç do i cekim disa në vijim:

- 1. Parimi i respektit.** Prindërit të cilët i dëgjojnë me vëmendje pyetjet e fëmijës e bëjnë atë të ndihet se prindërit e tij po i qajnë hallet e tij, po e respektojnë dhe e vlerësojnë atë. Ky bashkëpunim i prindërve me fëmijën e bën atë të ruaj balancën shpirtërore dhe prehjen e qetësinë, si rrjedhojë shumë shpejt bie në sy zëri i tij i vetëbesimit, qartësia në shtrimin e pyetjeve dhe përcjellja logjike përgjatë bisedës.
- 2. Parimi i besimit dhe besnikërisë.** Prindërit e gjurmojnë precizitetin në përgjigjet e dhëna fëmijëve të tyre duke i zgjedhur shprehjet e duhura gjuhësore, të njohura dhe të zakonshme për ta; gjithnjë duke i thjeshtëzuar këto njohuri nën korniza të diturive të sakta. Vërtetësia e përgjigjes në, fund të fundit, do të thotë arritja e qëndrueshmërisë, besimit dhe sigurisë shpirtërore.
- 3. Parimi i trajtimit të shtytësve të veçantë të fëmijët.** Këta shtytës lindin si pasojë e kontekstit të ndodhive në të cilat jeton fëmija. Të marrim shembull, fëmija i cili ndihet i shqetësuar dhe i irrituar si pasojë e foshnjës së re në familje, do të pyesë: prej nga vijnë fëmijët? Atëherë, edhe nëse do të pranojë një përgjigje shkencore nuk do të pushojnë shqetësimet e tij. Ai ka nevojë që t'i trajtohet zanafilla e problemit të tij të vërtetë që e shtyu të shtronte atë pyetje, pra ai ka nevojë për kujdes të posaçëm dhe t'i kushtohet vëmendje e mjaftueshme.⁽¹⁵⁵⁾

Gjëja më e vlefshme që arrijnë prindërit t'u japin fëmijëve të tyre është ndihmesa për ndriçimin e mendjeve të tyre. Jo vetëm përmes tregimeve, rrëfimeve dhe urtësive, por më tepër përmes ushtrimit të tyre që të mendojnë, të japin propozime e sugjerime. T'i mësojnë që të mos mjaftohen me gjërat sipërfaqësore, t'i nxisin që të meditojnë çfarë fshihet pas gjërave sipërfaqësore që u duken atyre.⁽¹⁵⁶⁾ Gjithashtu, bashkëveprimi duhet të jetë pozitiv, biseda ndërtuese, dialogu i qetë dhe shkëmbim të mendimeve nga të dy palët.⁽¹⁵⁷⁾ Shtuar kësaj prindërit duhet t'i iniciojnë pyetjet që u ngacmojnë mendjet fëmijëve.

Përveç kësaj përgjigjet ndaj pyetjeve mund të kërkohen nga një masë më e gjerë; p.sh.: prindërit të kërkojnë nga fëmija i tyre duke i sugjeruar atij që ta parashtrojë pyetjen e tij në mbledhjet familjare, e më pas t'i lihet hapësira secilit anëtar të familjes që të përgjigje, sidomos kur pyetja të jetë e thjeshtë jo e ndejshme, që nuk ka nevojë shumë për thellësi. Mirëpo, është shumë e rëndësishme që fëmija të mos tronditet nga përqeshjet e anëtarëve të mëdhenj të familjes me pyetjen e tij qesharake në sytë e tyre. E nëse ngjan kjo atëherë prindërit duhet t'i dalin zot atij, t'ia mbajnë krahun atij duke e lavdëruar dhe duke i dhënë kurajë. Pastaj duke e sqaruar nevojën e të gjithëve që të parashtrojmë pyetje, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”** (Kuran, 17:85). Në përgjigjet grupore arrijmë përmbushjen e shumë dobive të cilat si pikënisje e tyre janë pyetjet e fëmijës.



Edukimi përmes bisedës



Metoda më e përshtatshme për fëmijët është përmes bisedës së ndërtuar në formën e dialogut pyetje dhe përgjigje, pasi i ndihmon fëmijës në zgjidhjen e gjuhës së tij dhe ndërton tek ai aftësitë e të mësuarit. Biseda është ajo që i përafron çështjet dhe arrihen përmes saj qëllimet,⁽¹⁵⁸⁾ prandaj duhet patjetër që fëmija përgjatë bisedimit të respektohet, gjegjësisht kjo shpjen që fëmija të lirohet nga emocionet e tij siç janë: stresi, frika dhe konfliktet e brendshme shpirtërore. Kur fëmija të ndihet rehat shpirtërisht përgjatë bisedës e dialogut, ai do të nxjerrë çdo gjë që e mundon dhe e lodh e që fshihet në brendësinë e tij. Kur dy palët të arrijnë t'i kufizojnë arsyet e problemit, duke biseduar sinqerisht, edhe fëmija shpalos çdo gjë që përmban në veten e tij, e, atëherë zgjidhja është e lehtë dhe suksemi i arritshëm.⁽¹⁵⁹⁾ **Biseda në mes fëmijës dhe prindërve sjell dobi të mëdha për familjen, siç mund t'i theksojmë:**

- **Njoftimi.** Fëmija do të jetë më i afërt ndaj anëtarëve të tjerë të familjes.
- **Shoqërimi.** Biseda mes anëtarëve të familjes ua forcon shoqërinë, do të duhen më shumë dhe do të jenë më të afërt për njëri-tjetrin.
- **Dashamirësia.** Ne nuk duam nga biseda që të ketë një frymë zyrtare të komunikimit, por kërkojmë një bisedë me plot kuptimin e fjalës së saj, me fjalë të ëmbla e dashamirësie mes njëri-tjetrit.

Nga ajo që u cek më sipër përfitojmë që edukimi përmes bisedës është proces që karakterizohet me disa gjëra, siç janë:

1. Fëmijës i dhurohet liria në mendime dhe të zbuluarit e gjërave vetvetiu, kurse kjo ia nxit atij kreativitetin dhe ia zhvillon personalitetin.
2. Është e lehtë dhe nuk kërkon mund të madh, kur fëmija bashkëvepron me qejf duke mos u turpëruar.
3. Fëmijës i fut gëzimin dhe ndjehet që është prezent dhe i mëson artin e dëgjimit të të tjerëve.

4. I jep fëmijës mundësitë për kërkim dhe mendim të pavarur, e kështu i sheh gjërat nga një kënd tjetër dhe i mëson të arsyetuarit e logjikshëm.
5. I ngjall fëmijës vigjilencën dhe e largon nga ai plogështinë dhe hutinë,⁽¹⁶⁰⁾ e kështu e shtyn atë të jetë bashkëpjesëmarrës dhe aktiv.

Format e pyetjeve të një bisede



Gjenden shumë pyetje të cilat mund t'ua parashtrojmë fëmijëve, ndër to mund të theksojmë:

- **Çfarë po ndodh?** Kjo formë e pyetjes e stimulon fëmijën të bëhet kureshtar se çfarë po ngjan përreth tij, gjegjësisht i ndihmon atij të përshkruajë atë çfarë shikon drejtpërdrejt.
- **Çfarë po kërkon?** Kjo formë e pyetjes e ndihmon fëmijën t'i specifikojë me përpikëri kërkesat e tij.
- **Si po e bën këtë?** Kjo formë e pyetjes e ndihmon fëmijën që të mendojë lirshëm dhe ia nxit atij imagjinatën në kërkim të përgjigjes.
- **Pse po ndodhë kjo?** Kjo mënyrë e bën fëmijën t'i kapërcejë gjërat sipërfaqësore e kështu të mendojë për shkaqet e atyre ndodhjeve, me ç'rast fillon t'i analizojë dhe të kërkojë lidhshmërinë në mes të gjërave.
- **Çfarë do të bëjmë nëse do të ndodhë kjo?** Kjo mënyrë e ndihmon atë që t'i formulojë mendimet dhe vështrimin e gjërave nga një kënd tjetër.

Këto ishin vetëm disa nga format e pyetjeve përgjatë një bisede me fëmijën, sigurisht format e pyetjeve janë të shumta, por veçoritë më të rëndësishme të pyetjeve të cilat janë frutdhënëse përgjatë edukimit me anë të bisedës me fëmijën, mund t'i cekim siç vijon:

1. Pyetjet të jenë sa më të shkurtra, sipas mundësive.
2. Të jenë të qarta dhe precize në një ide të caktuar

3. Të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijës, kohën, vendin dhe ndodhive në të cilat po kalon ai.
4. Të mos jenë pyetjet që mund t'u përgjigjet me një fjalë saktë apo gabim, por të jenë të atilla që e vënë në lëvizje inteligjencën e fëmijës duke ia hapur horizontet e tij, t'i jepet hapësira që ta imagjinojë përgjigjen.⁽¹⁶¹⁾



Mënyrat e përgjigjeve ndaj pyetjeve të fëmijëve



Nga ajo që cekëm më herët qartësuam disa nga format e pyetjeve, llojet e tyre e të ngjashme. Ndërsa këtu, do të flasim rreth përgjigjeve, me ç'rast ndryshojnë format e përgjigjeve ndaj pyetjeve të fëmijëve sipas kohës, vendit apo ndodhive ku është parashtruar pyetja. Nga format më të njohura të përgjigjeve mund të cekim siç vijon:



- 1. Përgjigje të drejtpërdrejtë.** Kjo formë e përgjigjes është nga më të shpeshtat, ku fëmija pyet dhe më pas prindërit i përgjigjen atij drejtpërdrejt. Në përgjithësi veçori e këtyre përgjigjeve është që janë të shkurtra dhe të shpejta.
- 2. Përgjigja përmes rrëfimit të ndonjë tregimi të shkurtër.** Kjo metodë njihet si mënyrë e përgjigjes jo të drejtpërdrejtë, gjithsesi duhet të jetë rrëfimi i përshtatshëm për llojin e pyetjes së parashtruar. Zakonisht fëmijët i duan këto lloj përgjigjesh dhe i dëgjojnë me shumë dëshirë e kënaqësi.
- 3. Përgjigje të ilustruara.** Disa pyetje të cilat i bëjnë fëmijët ndodh që duhet t'iu përgjigjemi duke përdorur ilustrime të qartësuar; p.sh.: pyetjet shkencore për të cilat ilustrimet njihen si burim kryesor për njohjen e tyre, sidomos kur janë të ngjyrosura dhe tërheqëse.
- 4. Përgjigja përmes vrojtimit.** Fëmija mund të bëjë ndonjë pyetje që përgjigja e saj të jetë praktike përmes shoqërimit të tij te vendi i përgjigjes, me qëllim të vrojtimit të çështjeve praktikisht dhe nxjerrjes së përgjigjes. Sa për ilustrim, mund të jetë pyetja e fëmijës për kafshët: si jetojnë? Si ushqehen? Si shumohen? Etj.⁽¹⁶²⁾

Këshilla të përgjithshme që do duhet t'i marrim parasysh përgjatë përgjigjeve



- 1.** Kujdesu për përçimin e bindjes duke përdorur rrugën e diskutimit, pyetjes dhe kërkimit të informacioneve, e assesi të mbështetesh vetëm në formën e ligjërimit të përgjigjes. Pra, kur të përfundosh së sqaruari përgjigjen për fëmijën, kujdesu që ta vërtetosh arritjen e bindjes së fëmijës me përgjigjen tuaj në një nivel të kënaqshëm.
- 2.** Ji i singërtë në përgjigjen tuaj ndaj fëmijës, kurrësi mos gënje përgjatë përgjigjes në emër të ikjes nga një pozitë kinse e pa lakmueshme. Shtuar kësaj, kujdesu të mos i japësh fëmijës informata të gabuara - sido që të jenë arsyet -, përgjigjja e saktë dhe e kapshme është boshti i besimit të fëmijës tek ti.
- 3.** Mundohu aq sa të kesh mundësi ta thjeshtësosh përgjigjen tënde, që të kuptohet me lehtësi dhe t'i përshtatet mentalitetit të të voglit. Largohu sa të mundësh nga turbullirat që mund ta shpërqendrojnë mendjen e fëmijës. Gjithashtu, kujdesu që të mos i japësh fëmijës informata të cunuara, duke u arsyetuar që fëmija është ende i vogël dhe nuk ka aftësi të mjaftueshme për ta kuptuar drejt, sepse këto informata do të gdhenden në mendjen e fëmijës.⁽¹⁶³⁾
- 4.** Mos u sill me fëmijën sikurse të jetë ai një mendjelehtë, pasi ai e kupton fare mirë atë që do t'ia përçosh; vetëm përsose mënyrën. Bëj kujdes që përgjigjja jote të jetë shkurt e shqip pa i bërë bisht asaj, që fëmija të mos hyj në labirinte të jashtme që mund të përmbajë përgjigjja.
- 5.** Mos e dëno fëmijën tënd të vogël, mos e qorto e as mos e përqesh për pyetjen e tij, pa marrë parasysh rrethanat, përkundrazi bëje ta kuptojë që ju çdoherë jeni i gatshëm për të, që do t'i përgjigjeni atij në çdo pyetje.⁽¹⁶⁴⁾ Përqeshja e fëmijës e bën të ndihet i shpërfillur, të mos jetë guximtar dhe e privon atë nga ëndja e kureshtjes së hulumtuarit të gjërave.
- 6.** Mos u brengos nga pyetjet e fëmijës tuaj rreth Krijuesit dhe as nga paaftësia e tij e njohjes së ekzistencës së Tij. Mos i ik përgjigjes së fëmijës, pasi ikja jote mund ta shpjëjë atë në kërkim të burimeve të njohurive në vende të tjera.

7. Mos u zbraps nga kërkimi i përgjigjes edhe në qoftë se duhet të zgjerohet kërkimi i saj, pasi të shfaqesh para fëmijës tënd si kërkues i njohurive është më mirë sesa të luash rolin e të dijshtmit e në të vërtetë nuk e di. Nuk është e metë t'i thuash fëmijës, më prit pak ta kërkoj për ty përgjigjen e saktë.⁽¹⁶⁵⁾
8. Pranoji pyetjet e fëmijëve me vëmendje, trego ndaj tyre interesim dhe mos i neglizho ato duke u treguar i shkujdesur. Rritja e fëmijës, përvetësimi dhe edukimi i tij psikik dhe realist e ndihmojnë shumë atë që ta pranojë shpjegimin tuaj të gjërave, ndonëse në fillim i kishte vështirë t'i kuptonte.⁽¹⁶⁶⁾
9. Nëse me të vërtetë je i zënë, atëherë është e udhës që t'ia qartësosh që kjo kohë nuk është e përshtatshme që t'i përgjigjesh në pyetjet e tij. Por, tregohu i vëmendshëm që të jesh iniciator e t'i përgjigjesh atij menjëherë sapo të lirohesh.
10. Evitoje çdo stërzgjatje të panevojshme të sqarimeve dhe detajeve të stërholluara, sepse përgjigjet për pyetjet e fëmijës gjashtë vjeçar duhet të jenë më të shkurtra se sa për atë dhjetë vjeçar; dhe kështu me radhë. Kjo sa i përket pyetjeve të cilat duan përgjigje të zgjeruar me argumente e prova, siç janë pyetjet për botën e fshehtë dhe pyetjet e ndjeshme. Ndërsa përgjigjja ndaj disa pyetjeve është e përcaktuar, e kështu u thuhet të gjithë fëmijëve pa dallim moshe.⁽¹⁶⁷⁾
11. Provo aq sa të kesh mundësi t'i lidhësh përgjigjet e pyetjeve me gjëra reale që i percepton fëmija. Dhe në anën tjetër largohu nga gjëra abstrakte të cilat vështirë që i kupton fëmija në këtë moshë. Sipas mundësive, gjithnjë mundohu t'i mbështetësh përgjigjet e tuaja me argumente e prova që t'i përforcohen informatat fëmijës; pra, përgjigjet të jenë të logjikshme.⁽¹⁶⁸⁾
12. Rënia dakord e prindërve në dhënien e njohurive ndaj fëmijës. Nuk duhet që të ketë kundërthënie të mendimeve në mes prindërve kur t'ia shfaqin informatat fëmijës.
13. Të mos kthehet përgjigjja ndaj pyetjeve të fëmijës me një pyetje tjetër. Me fjalë të tjera, sikur t'i drejtohet prindi fëmijës së tij: "Për çfarë e ke fjalën? Ku e ke qëllimin?" Këtu fëmija ndihet i thyer, sepse nuk ka arritur t'ia përcjellë pyetjen prindit. Fëmija beson që prindërit duhet ta kuptojnë atë pa pasur nevojë ai për shpjegim a shtjellim të fjalëve të tij. Ndërsa nëse ndonjëri prej prindërve do të verifikojë qëllimin e pyetjes së fëmijës së tij, atëherë më mirë është të përdorë këtë lloj të shprehjes: "E ke për qëllim këtë apo jo?"
14. Prindërit të mos tregojnë qëndrim prej tirani me mendimet e tyre kur i përgjigjen ndonjë pyetjeje të caktuar të fëmijës, atëherë kur fëmija të merr njohuritë nga ndonjë burim tjetër informatash, por nga një rrugë tjetër

ndryshe prej asaj të prindërve. Kështu që prindërit duhet të bindin fëmijën për përgjigjen e saktë me metodikë të lehtë, të thjeshtësuar me qëllim që t'ia përfitojnë besimin e tij, e jo të ndodhë e kundërta.⁽¹⁶⁹⁾

- 15.** Përpiku të jetë përgjigjja në formë të bashkëbisedës dhe jo të ligjëratës. Shto sa më shumë përdorimin e tregimeve, shembujve dhe përdorimit të enciklopedive shkencorë të ilustruara, me qëllim të zbërthimit të njohurive dhe përçimit të tyre në mendjen e fëmijës.⁽¹⁷⁰⁾ Gjithashtu, përdori: lojërat fizike, aktrimin, vizatimin, mendimin, këndimin, shkëmbimin e ideve, lojërat e ndryshme logjike, ilustrimet, prerjet e figurave dhe ngjitjen e tyre, e të tjera të ngjashme.⁽¹⁷¹⁾ Llojllojshmëria e ndërton dhe zhvillon zgjuarsinë e fëmijës dhe ia gdhend atij njohuritë.
- 16.** Disa lloje të pyetjeve nuk u përgjigjet menjëherë, porse përgjigjja ndahet pjesëza-pjesëza, në mënyrë të përshkallëzuar, nëse fëmija kërkon më shumë sqarime, atëherë i shtohet sqarimi sipas moshës, llojit të pyetjes dhe aftësisë së tij të kuptuarit.⁽¹⁷²⁾
- 17.** Atëherë kur fëmija pothuajse arrin pjekurinë, është e pëlqyer që kur të parashtrojë ndonjë pyetje, t'i kërkohet së pari atij mendimi; pra, të njëjtën pyetje ia parashtrojmë atij. Kështu e kuptojmë se si do të reagojë ai ndaj saj, rrjedhimisht e ndërtojmë përgjigjen tonë për të sipas reagimit të tij. Duhet të ndalemi së kërkuari që fëmijët të mendojnë sipas mendjeve tona, pasi kjo e shpie fëmijën në një kornizë së cilës nuk i përket.⁽¹⁷³⁾



Gabimet edukative përgjatë përgjigjes



Nga gabimet më të shpeshta edukative të cilat i bëjmë kur iu përgjigjemi fëmijëve tanë, janë si vijojnë:

- Mospërfillja e anëve të ndryshme të edukimit, si: anën e besimit, anën e moralit dhe anën e diturisë.
- Mbivlerësimi i njërës anë dhe lënia pas dore të tjetrës, apo mosbalancimi mes tyre.
- Mos përshkallëzimi përgjatë edukimit, shtuar kësaj kritikave të mëdha, qortimi i tepërt dhe vënia në pah e të metave.
- Dëshira jonë që t'u binden fjalëve tona pa diskutuar.
- Moskëshillimi me specialistët e fushës në fjalë, me njerëzit me përvojë, nxitimi dhe dobësia e përcjelljes.
- Ngurtësimi përgjatë edukatës dhe udhëzimit, kundërthënia në mes fjalëve dhe veprave tona, porositë tona negative të pashpresa.⁽¹⁷⁴⁾

Të gjitha këto janë gabime të cilat ndikojnë në ndërtimin e mirëfilltë edukativ rreth besimit te fëmijët.

**Modele
praktike
të përgjigjeve
ndaj pyetjeve
të fëmijëve
rreth besimit**



Përgjigjet

Përgjigjet të cilat gjenden në këtë kapitull, në esencë, u drejtohen prindërve dhe të gjithë atyre të cilët luajnë rolin e edukatorit apo përmirësuesit, prej mësuesve. Në të vërtetë, ajo që kërkojmë nga ta është përshtatja e përgjigjes sipas moshës së fëmijës dhe aftësive të tij të të kuptuarit. Ne nuk mund t'i kufizojmë përgjigjet njëlloj për të gjitha moshat e fëmijëve, duke ditur që aftësitë e tyre të të përpunuarit të përgjigjeve dallojnë.⁽¹⁷⁵⁾ Kësisoj ajo çfarë na intereson neve është shpirti i përgjigjes, përmbajtja e tyre dhe jo t'u përcillet atyre fjalë për fjalë.⁽¹⁷⁶⁾ Gjithashtu, llojllojshmëria e të ligjëruarit të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, që të kemi mundësi t'ia paraqesim përgjigjen lexuesit të nderuar sa më gjithëpërfshirëse, që më pas lexuesi të kapë thelbin e tyre dhe t'ia ndryshojë formën dhe ia përshtat në mënyrën më të mirë që përputhet me fëmijën e tij.

Për t'u përgjigjur pyetjeve të fëmijëve, që kanë të bëjnë me shtyllat e besimit, duhet që prindërit të kenë së paku njohuritë themelore fetare, të cilat ua mundësojnë atyre bartjen e këtyre kuptimeve deri te fëmijët e tyre, duke u shpjeguar dhe përshtatur aftësive të tyre të të kuptuarit. Sfidë, me të cilën ballafaqohen edukatorët në përgjithësi, nuk është gjetja e njohurive, por sfidë për ta është përcimi i këtyre njohurive deri te fëmijët në atë formë që t'u përshtatet mentalitetit të tyre, me metoda që i përputhen kohës, vendit apo ndodhive në të cilat jetojnë ata.

Në vijim kemi prezantuar disa nga pyetjet, jo të gjitha normalisht, por më të rëndësishmet dhe më të shpeshtat të parashtruara nga fëmijët. Jemi përpjekur të zgjedhim përgjigjet më të mira sipas këndvështrimit tonë dhe assesi nuk pretendojmë se janë përgjigjet më shembullore, por janë modele nga të cilat prindërit mund të fillojnë pikënisjen e tyre e të vazhdojnë më tej. Gjithsesi, këto përgjigje mund të përmirësohen, korrigjohen, fshihen apo t'u shtohen elemente të tjera.

Vërejtje!

Kushdo që mendon se parashtrimi i këtyre pyetjeve të vështira nga fëmijët është si pasojë e ndonjë të mete përgjatë edukimit të tyre, ai gabon, pasi kjo gjendje te fëmijët llogaritet si fenomen që tregon shëndetin e tyre të plotë, zhvillimin e tyre normal dhe ndërtimin e rrjedhshëm të mentalitetit të tyre dhe aftësive të tyre logjike. Të metat edhe nëse gjenden, ato janë në paaftësitë e prindërve në përthekimin e zhvillimit të fëmijës, hapjes së horizonteve të mendjes së tyre dhe njoftimit të tij me përbërësit e këtij kozmosi dhe krijesave përreth tij.⁽¹⁷⁷⁾ Rrjedhimisht, prindërit e kanë për detyrë që të bashkëveprojnë me fëmijën me zell të madh dhe të ofrojnë përgjigje sa më bindëse, qofshin edhe pjesërisht, pasi përgjigjet bindëse qofshin edhe pjesërisht do ta ndihmojnë fëmijën të qëndrojë i paepur në të gjitha sferat si mendore, psikike apo shoqërore, në dallim nga përgjigjet e shtrembra apo replikat e mprehta të gabueshme, të cilat fëmijës vetëm se ia shtojnë dyshimet dhe përshtjellimet. Nga këto dyshime e paqartësi do të rrjedhin ngatërresa në sjellje e të meta në mendime.

Të metat e mëdha nuk vijnë papritmas me hov përnjëherë. A nuk e ke parë se si zjarri ndizet nga shkëndija të vogla? Kështu pra, shumë nga cilësitë e urryera te njerëzit mbijnë si filiza të njoma që ujiten me shpërfillje e zvarritje, e më pas rriten nga injorimi përgjatë jetës derisa të piquen e të çelin sythet e lulëzojnë dhe kështu rrënjët i kanë shtrirë në personalitet, por tashmë është vështirë largimi dhe çrrënjësja e tyre.⁽¹⁷⁸⁾

Pyetjet që kanë të bëjnë me besimin në Allahun ﷻ (179)



Me të vërtetë pyetjet më të shpeshta që vërtiten në mendjet e fëmijëve në fillim të vegjëlisë së hershme të tyre, janë pyetet që përqendrohen rreth Allahut të Lartësuar. Në vijim do të prezantojmë pyetjet më të shpeshta që ua parashtrojnë fëmijët prindërve të tyre.

Kush është Allahu?

Fillimisht, është e udhës që mos ta presim fëmijën të na pyesë për Allahun, por të jemi ne iniciatorë që të flasim për Allahun gjithnjë, në çdo ndejë tonën. Singërisht, përgjigjja e duhur dhe e saktë për pyetjen e fëmijës për Allahun dhe cilësitë e Tij do të gdhend në zemrën dhe mendjen e tij besimin në Allahun dhe njëshmërinë e Tij ﷻ. Kësisoj, mënyra më shembullore është t'i largohet fëmijës vëmendja nga vetë Qenia e Allahut te vëmendja në krijimtarinë e Tij, krijesat e Tij magjepsëse që tregojnë për Të, si p.sh.: qielli, retë, yjet, Dielli, Hëna, deti, pemët e të tjera.⁽¹⁸⁰⁾ Theksimi i mirësisë së Allahut dhe begatisë së Tij ndaj krijimit të tij (fëmijës), gjymtyrëve të tij, syve, veshëve, gojës, gjuhës, duarve, këmbëve dhe gjithë trupit të tij. I tregojmë atij që këtë qiell e ka krijuar Allahu, këtë tokë e ka krijuar Allahu, këto pemë i ka krijuar Allahu, derisa të mësohet me këto fjalë e të gjejë prehje në to. E, atëherë kur të na pyesë, kush është Allahu?! I përgjigjemi me shumë thjeshtësi: Allahu është Ai që ka krijuar çdo gjë përreth nesh dhe mbi ne, duke i dhënë shembuj të pafundë rreth krijesave.



Atëherë kur fëmijës ia kumtojmë dhe bëjmë me dije të gjitha këto krijesa magjepsëse, qiellore apo tokësore qofshin, dhe ia zbulojmë fshehtësitë e këtij sistemi të mahnitshëm dhe të këtij rregulli të përpiktë, i themi atij: A po e vërën këtë përsosmëri? Ai që i ka vendosur ligjet dhe ka rregulluar gjërat në këtë mënyrë të përkryer është Allahu ﷻ. Më pas fëmija do ta njohë Zotin e tij me dituri e prova. I tregojmë atij, gjithashtu, që është Allahu Ai që ka krijuar çdo gjë dhe Asgjë nuk i shëmbëllen Atij, Ai është Mëshirëbërësi, Furnizuesi, më Bujari, Ai i ka të gjithë emrat dhe cilësitë më të mira dhe më të bukura. Ai është i vetmi që meriton të adhurohet, i pa shok. Ai Allahu, i do fëmijët dhe i ka urdhëruar të mëdhenjtë që të përkujdesen për ta, t'u bëjnë mirë e dobi atyre dhe gjithë njerëzve. Gjithashtu, Allahu do të na marrë në llogari për veprat tona; për të mirat do të na shpërblejë dhe për të këqijat do të na ndëshkojë. Ai është Allahu që e shpërblen punëmirin për veprat e tij të mira dhe e dënon punëkeqin për veprat e tij të këqija. Është e rëndësishme, po ashtu t'u mësohen fëmijëve suret e shkurta nga fundi i Kuranit, pasi ato përmbajnë përgjigjet më të mira për qenien e Allahut dhe cilësitë e Tij, **“Ai (Allahu) as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”** (Kuran, 112:3-4).⁽¹⁸¹⁾

Mund t'i parashtrojmë fëmijës pyetje, duke i thënë:

- Kush është ai që ta ka blerë këtë rrobë kaq të bukur?
- Babai im, – do të thotë fëmija.
- Po në shkollë kush të dërgon?
- Babai im, – do të pohojë ai.
- Po kur sëmuresh kush të shoqëron për te mjeku?
- Babai im, – do të përgjigjet ai.
- Po në pushime kush ta bën qejfin nëpër shëtitje?
- Babai im, – do të vazhojë të përgjigjet ai...
- Pra, yt atë qenka ai që kujdeset për të gjitha gjërat e tua?
- Po, – do të miratojë fëmija.
- Kësisoj është Allahu, ndonëse Atij i takon shembulli më i lartë, Atij i takon i gjithë sundimi, të gjithë ne jemi nën kujdesin e Tij, Ai është Allahu Krijuesi i çdo gjëje, çdo gjë që e sheh përreth teje është nga krijimtaria e Allahut. Dielli, Hëna, retë, detet, kodrat, njerëzit, kafshët, shpezët, të gjitha Ai i krijoi, po ashtu Ai i ka krijuar engjëjt edhe shejtanët. Allahu është Krijuesi i tërë gjithësisë, Ai është më Bujari, i Gjithëmëshirshmi që kujdeset dhe na mbikëqyrë neve, na do dhe na sjell vazhdimisht të mira e dobi.



A ka Allahu pamje si të njeriut?

Jo, Ai Allahu nuk është si ne. Asgjë nuk i shëmbëllen Allahut, është Ai i cili më ka krijuar mua, ju ka krijuar juve, i ka krijuar të gjithë njerëzit, i ka krijuar pemët, lumenjtë, detet dhe çdo gjë që ekziston në këtë botë. Ai është burimi i fuqisë, nëse Ai do të bëjë diçka, mjafton t'i thotë asaj gjëje, bëhu dhe do të bëhet. Allahu është ndryshe nga njeriu, njeriu nuk ka mundësi të krijojë qenie njerëzore, kurse Allahu ka mundësi t'i krijojë ata dhe mund të bëjë çdo gjë që Ai do. Meqë askush në këtë botë nuk mund ta shikojë Allahun, kështu nuk mund ta përshkruajë se si duket Ai. Ne nuk kemi aftësi ta shikojmë Allahun me gjithë Madhërinë dhe Dritën e Tij, pasi aftësitë tona janë të kufizuara.

Më pas kërkojmë nga fëmija që të provojë t'i shikojë rrezet e Diellit pa i rrudhur apo i mbyllur sytë, duke e pyetur: a mundet që të vazhdojë dhe më tej ta shikojë Diellin pa ia hequr fare sytë atij? Sigurisht që jo, - do të përgjigjet. Atëherë i themi se ngjashëm është shembulli i shikimit në Allahun, o xhan! Dritën që buron nga Allahu nuk kemi mundësi ta përballojmë, por kur të hyjmë në Xhenet, do ta shohim Allahun me lejen e Tij, të Lartëmadhëruarit.

Mund të shfaqet nga fëmija këtu një farë mosbindje e plotë, duke thënë: Si nuk është asgjë sikur Ai, si nuk i shëmbëllen asgjë Atij? Atëherë, këtu duhet ta bindim atë me qetësi, duke i thënë se mendjet tona sado që të jenë të mëdha e të zgjuara, mbesin mendje njerëzish, të mangëta, do të dish vetëm atë që Allahu dëshiron që të dish, fundi i fundit, ne njerëz do të mbesim.

Mund t'i themi pastajse i pastër është Allahu nga çdo e metë! Por, sikur Allahu t'i ngjasonte njeriut do të sëmurej si ne, do ushqehet dhe do pinte si ne, do të vdiste pasi njerëzit vdesin. Prandaj, Allahu nuk sëmuret, nuk ha e as nuk pi, nuk vdes, por Ai është i Gjalli përgjithmonë, Ai është Krijuesi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje në këtë kozmos, për këtë arsye nuk i shëmbëllen asgjë Atij.

Përsëri mund ta pyesim fëmijën se a mundemi ne njerëzit t'i themi ndonjë gjëje, bëhu e pastaj ajo të bëhet? Sigurisht që jo, - do të përgjigjet. Kështu do të vijmë në përfundim me fëmijën që Allahu nuk është si njeriu, por Ai është Krijuesi Madhështor.

Gjersa vazhdojmë të bisedojmë, i themi fëmijës se të dëgjuarit tanë është i kufizuar, ne nuk dëgjojmë vetëm se brenda një frekuence dhe largësie të caktuar, sepse sikur të dëgjonim çdo gjë, do të stërmundoheshim. Shikimi ynë është i kufizuar, ne nuk shohim vetëm se nga një distancë e caktuar, po ashtu ne nuk mund të shohim prapa objekteve të ngurta, murit p.sh. Rrjedhimisht, sikurse që dëgjimi dhe shikimi ynë është i kufizuar, po ashtu edhe mendjet tona janë të kufizuara. Ato nuk i perceptojnë gjitha gjërat, padyshim mendja e njeriut është e kufizuar nuk kap çdo gjë. Që kur Allahu i Lartësuar i ka krijuar njerëzit e deri

më sot, vazhdon të jetë pjesa e mosnjohurive nga njeriu shumë më e madhe se sa pjesa e njohurive të tij. Shembull kemi shpirtin që ndodhet në trupin e njeriut, edhe pse është kaq afër nesh ne nuk kemi mundësi ta paramendojmë apo ta njohim realitetin e tij. Kështu që pasi çështja jonë është kësisoj, brenda nesh, atëherë vallë, si qëndron çështja për diçka jashtë nesh?!

Si përfundim, kuptojmë që mendja e njeriut përderisa është e kufizuar, atëherë nuk ka aftësi që ta perceptojë vetë Qenien e Allahut të Lartësuar. Kësisoj, të folurit për pamjen e Allahut assesi nuk bëhet përmes imagjinatës, logjikës apo iluzioneve, por Allahun e njohim vetëm përmes Shpalljes dhe Kurani e ka të prerë këtë tematikë, siç thotë Allahut i Lartësuar: **“Asgjë nuk i përngjan Atij dhe Ai është i Gjithëdituri, Gjithëshikuesi.”** (Kuran: 42:11). Rrjedhimisht, pasi Allahu nuk është si ne dhe nuk i ngjason ndonjë gjëje,⁽¹⁸²⁾ kjo shpie detyrimisht në madhërimin e Allahut të Cilin e kemi detyrë ta duam, të shpresojmë nga Ai dhe të frikësohemi prej dënimit të Tij. Kjo Madhështi e Tij shfaqet në shesh kur e kuptojmë që shikimi i Tij në Xhenet është, pa diskutim, begatia më e madhe e banorëve të Xhenetit.





Kush e ka krijuar Allahun?!

Sikur të bëhej kjo pyetje se kush e ka krijuar Allahun, atëherë do bëhej gjithashtu pyetja se kush e ka krijuar Krijuesin, apo jo? Kështu që, patjetër duhet ta kuptojmë që nga cilësitë e Krijuesit është se Ai nuk është i krijuar, por është Ai, Allahu që i ka krijuar të gjitha krijesat. Sikur të ishte Krijuesi i krijuar, atëherë nuk do ta adhuronim, apo bindeshim urdhrave të Tij. Gjegjesisht, pyetja se kush e ka krijuar Allahun është pyetje jo e saktë, pyetje boshe, e kështu pyetjet boshe janë të pakuptimta. Ngjashëm sikur të të pyesë ty ndokush, sa është gjatësia e brinjës së katërt të trekëndëshit? Nuk është e çuditshme që këtu nuk ka hapësirë për përgjigje, pasi vet emri i trekëndëshit tregon që i ka vetëm tri brinjë. Kësisoj, ana e gabimit të pyetjes se kush e ka krijuar Allahun është pasi fjala *i krijuar* dhe fjala *Allahu* nuk bashkohen në asnjë mënyrë. Allahu, Zoti, nuk krijohet, procesi i krijimit bie mbi krijesat, e kurrsesi mbi Krijuesin, askush nuk mundet të krijoj Zotin, pasi atëherë do të ishte edhe Ai gjithashtu një krijesë. Allahu ekziston dhe është Ai i Cili nuk ka pasur fillim dhe para të Cilit nuk ka pasur asgjë dhe është Ai i Cili nuk ka mbarim dhe pas të Cilit nuk ka asgjë.

Ta zëmë që po supozojmë - në diskutim e sipër - që ndodhet një “krijues” i Allahut të Lartësuar! Atëherë do të rrjedhë pyetja e pambarim, po “krijuesin” e “krijuesit” të Krijuesit kush e krijoi? Më pas, po “krijuesin” e “krijuesit” të “krijuesit” të Krijuesit kush e krijoi?! E kështu me radhë, cikël të pyetjeve të pafundme, e padyshim kjo është e pamundur. Sa për afrim do të marrim shembullin e ushtarit dhe plumbit. Një ushtar dëshiron të gjuajë në shenjë, por që të gjuajë në shenjë duhet paraprakisht të marrë lejen e ushtarit që gjendet sipër tij. Ndërsa ushtari në fjalë që t’i japë leje që ai të gjuajë, duhet edhe ky gjithashtu të kërkojë lejen e ushtarit që gjendet sipër tij; e kështu me radhë deri në pafundësi. Tani shtrohet pyetja: ushtari a do ta gjuajë plumbin në shenjë apo jo? Natyrisht që jo, pasi asnjëherë nuk do të mbërrijë tek ushtari që t’i japë lejen të gjuajë në shenjë. Sikur të mbaronte vargu i personave te një njeri, që nuk ka sipër tij askënd tjetër, me fjalë të tjera s’ka nevojë të marrë leje që të gjuajë, atëherë ai do të jepte leje për shtimin në shenjë dhe do të mbaronte çështja me plumbin e gjuajtur. Kësisoj pa këtë njeri, pa marrë parasysh se sa është numri i personave, plumbi nuk do të gjuhej, sepse ata janë sikur zerot të radhitura njëra pas tjetrës, sado shumë që të jenë ato, edhe sikur të mbërrijnë një cak që s’i shihet fundi, përsëri pa vlerë do të mbesin, derisa të mos vendoset para tyre numri një apo një shifër tjetër përveç zeros.⁽¹⁸³⁾



Nga ka ardhur Allahu? Sa është mosha e Tij?

Pasi e mësove tani, o i dashur, që Allahu nuk është i krijuar, atëherë gjithsesi Ai as nuk lind dhe as nuk është i lindur. Ai nuk ka fillim dhe as fund. Kësisoj, Ai nuk ka moshë siç kemi ne njerëzit, sepse Allahu është Krijuesi, Madhështori, është Ai që nuk ka nevojë për asgjë, i Madhi, është Zotëruesi i fuqisë, shumë i Fuqishëm, i Plotfuqishmi, Mëshirëbërësi, i Cili i ka gjithë emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta, i ka cilësitë të plota nga çdo anë pa asnjë mangësi. Pra, Allahu i Lartësuar është Ai që e solli në ekzistencë botën, krijesat dhe tërë gjithësinë.



Çfarë kishte përpara Allahut?

Allahu është i Pari, i Cili nuk ka pasur fillim dhe para të Cilit nuk ka pasur asgjë. Ai është i Fundit, i Cili nuk ka mbarim dhe pas të Cilit nuk ka asgjë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi (me argumente) dhe i Padukshmi (me sy). Ai është i Dijshëm për çdo gjë!”** (Kuran, 57:3).⁽¹⁸⁴⁾

Allahu i Lartësuar nuk përkufizohet nga koha e as nga vendi. Koha si krijesë e Allahut nuk dallon nga krijesat e tjera. Nuk është e mundur për krijesat që ta përkufizojnë apo rrethojnë Krijuesin e tyre të Lartësuar, por Allahu është jashtë krijesave të Tij, Ai i ka të gjitha cilësitë e plota dhe të bukura. Është e udhës që të merret parasysh këshilla profetike, në këtë rast, siç përcjell Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti ﷺ ka thënë: *“I vjen shejtani ndonjërit prej jush dhe i thotë: -Kush e krijoi këtë? Po këtë kush e krijoi? Derisa t’i thotë: -Kush e krijoi Zotin tënd? Nëse çështja mbërrin këtu, atëherë le të kërkojë besimtari mbrojtjen e Allahut ndaj shejtanit të mallkuar dhe le të ndalojë aty.”*⁽¹⁸⁵⁾ Të kërkuarit e mbrojtjes së Allahut në këtë rast dhe orientimit të mendimeve të fëmijës në një çështje tjetër në formë jo të drejtpërdrejtë, që të mos vazhdojë të hutohet me këto lloj pyetjesh është gjithashtu nga përgjigjet e rëndësishme, në këtë rast. Mënjanimi i mendimeve nuk është si pasojë e mosprezencës së përgjigjes, por është me qëllim të mbylljes së portës së vesveseve.



A është Allahu mashkull apo femër?

Siç e qartësua dhe më herët, duhet të përqipemi shumë që ta largojmë të menduarit e shumtë të fëmijës rreth Qenies së Allahut, duke ia orientuar mendimet e tij në gjëra nga të cilat përfiton dhe i sjellin dobi. Pëlqehet këtu që t’i sqarohet fëmijës se çështja e gjinisë, mashkull apo femër është nga domosdoshmëritë e dallimit në mes të grupeve dhe llojeve të krijesave, të gjallesave. Allahu është Ai që u dha këtë veçori krijesave të Tij, siç thotë Ai i Lartësuar: **“Ai krijon çiftet, mashkull e femër.”** (Kuran: 53:45). I pastër dhe i Lartësuar është Allahu nga kjo ndarje, madje ka dhe krijesa të tjera të cilat nuk kanë gjini, siç janë engjëjt p.sh., apo qielli, retë, ajri, apo uji; të gjitha këto nuk kategorizohen në gjini as

mashkull e as femër. Rrjedhimisht, kur ka krijesa - me gjithë mangësitë e tyre - që nuk pranojnë të ndahen në gjini, atëherë Allahu është edhe më parësor që të mos ketë gjini, siç thotë Ai: **“Asgjë nuk i përngjan Atij dhe Ai është i Gjithëdituri, Gjithëshikuesi.”** (Kuran, 42:11).

Pse të besojmë në ekzistencën e Allahut? Çfarë e vërteton ekzistencën e Tij?

Besimi në Allahun e Madhëruar është natyrshmëri e çiltër njerëzore, të cilën s'mund ta mohoj askush. Dëshmitë për ekzistencën e Allahut janë të shumta, aq sa njerëzit vazhdojnë të zbulojnë prova të njëpasnjëshme për ekzistencën e Tij, secili sipas profesionit dhe fushës së tij të caktuar. Dëshmitë e natyrshmërisë së çiltër në brendësinë e njerëzve e vërtetojnë ekzistencën e Allahut. Allahu i Lartësuar në librin e Tij fisnik thotë: **“Drejtuhu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit.”** (Kuran, 30:30). Çdonjëri prej nesh has në një forcë të brendshme që i flet për madhësitë e Allahut, fuqinë e Tij dhe kujdesin e Tij për ne.

Ndërsa dëshmitë shkencore reale të perceptuara nga shqisat e mbështesin ekzistencën e një sistemi të përkryer në këtë kozmos. Ky sistem i përkryer me këtë përpikëri patjetër duhet që të ketë një Krijues. Ngase kush i solli në ekzistencë të gjitha këto krijesa dhe u kujdes për to? Përgjigjja mund të jetë në disa forma:

Së pari, këto krijesa erdhën dhe u krijuan rastësisht pa ndonjë shkak të jashtëm që do i sillte ato në ekzistencë; kështu që askush nuk do të dinte se si u krijuan të gjitha këto gjëra.

Së dyti, mund të jetë që të gjitha këto gjëra e sollën veten e tyre në ekzistencë dhe u kujdesën vetë për çështjet e tyre.

Së treti, këto krijesa kanë një Krijues i cili i solli në ekzistencë.

Kur i vështrojmë këto tri mundësi e kuptojmë se *e para* dhe *e dyta* janë të pamundshme, e kështu mbetet patjetër përgjigjja *e tretë* si e vetme e qartë dhe e saktë, e cila pohon se këto krijesa i ka krijuar Krijuesi i tyre që është Allahu i Madhëruar, siç është cekur në Kuranin fisnik, kur thotë Allahu i Lartësuar: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?! A mos vallë ata kanë krijuar qiejt dhe Tokën?! Nuk është kështu, por ata nuk janë aspak të bindur.”** (Kuran, 52:35-36).

Nga argumentet e tjera të kapshme nga shqisat rreth ekzistencës së Allahut të Madhëruar është, gjithashtu, përgjigjja e Allahut ndaj lutjeve. Po ashtu, përsosmëria në krijimin e qiejve dhe të Tokës, siç thotë Allahu i Lartëmadhëruar: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.”** (Kuran, 3:190). Po ashtu, përpikëria në krijimin

e njeriut, ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?”** (Kuran, 51:21). Gjithashtu, në krijimin e yjeve, kodrave, kafshëve dhe krijesave të tjera, të gjitha tregojnë për përsosje nga Krijuesi, i lavdëruar dhe i pastër është Ai nga çdo e metë! Shenjat e Allahut janë të shpërndara në horizonte, në vetet tona, në frute e gjithandej, që të gjitha dëshmojnë për ekzistencën e Allahut, të Vetëm, Një i Pashok. Kësisoj ekzistenca e gjithë këtyre krijesave duhet të ketë një qëllim dhe cak se pse janë krijuar. Arsyeja pse janë krijuar është që ta adhurojnë Allahun të Vetëm, duke mos i shoqëruar Atij asgjë.⁽¹⁸⁶⁾

Mund t’i rrëfejmë ndodhinë e Ebu Hanifes (*Allahu e mëshiroftë!*) kur disa njerëz i kërkuar atij t’i dëshmojë *teuhidin rububijeh*⁽¹⁸⁷⁾, ku ai u drejtohet atyre dhe u thotë:

- Më lejoni - para se të flas rreth kësaj tematike - o ju njerëz! Anija në lumin Tigër, shkoi dhe u mbush me ushqim, pajisje e gjëra të tjera vetë dhe u kthye gjithashtu vetë, po ashtu vetë u ndal në port, u shkarkua dhe u kthye përsëri; të gjitha këto lëvizje u bënë pa udhëheqjen e askujt.

- Është e pamundur! S’ka mundësi kurrë! – u përgjigjën njerëzit. Atëherë u tha:

- Nëse për një anije është e pamundur, më thoni vallë, si është e mundur e gjithë kjo harmoni e çdo gjëje në këtë botë me çdo gjë që ka nën të dhe mbi të?⁽¹⁸⁸⁾ Prandaj, është e pakuptimtë dhe pamundur që i gjithë ky krijim i përsosur me përpikëri të jetë pa Krijues të Gjithëfuqishëm, të Gjithëditur.

Gjithashtu mund t’i thuhet fëmijës, atëherë kur të ndiejë dhimbje barku, a nuk e kupton se je i uritur, e vetvetiu do të kërkosë për ushqim që të ngopësh barkun? Apo kur të jesh i etur, a nuk do të kërkosë për atë që ta shuan etjen? Apo kur ta nuhasësh ndonjë aromë të këndshme a nuk do të ndihesh i lumtur? Apo kur të nuhasësh ndonjë aromë të keqe, a nuk ndihesh i shqetësuar? Apo kur t’i vështrosh lulet e trëndafilat, qiellin dhe natyrën përreth, a nuk do ta ndjesh gëzimin e harenë? Kështu pra, o i dashuri im, ne vetvetiu ndiejmë që kemi nevojë për një Zot Madhështor, tek i Cili kthehem i përgjërrohemi vazhdimisht kur të kemi nevojë për Të, që të gjejmë prehjen e sigurinë. Atëherë kur të ndihemi të pikëlluar e të mërzhitur, ne vetvetiu drejtohem tek Allahu duke e lutur Atë, e nëse do ndihemi të lumtur përsëri i drejtohem Atij me falënderim e mirënjohje.







A dëgjon Allahu, sheh apo flet si ne?

Sigurisht që Allahu flet, dëgjon dhe shikon, siç thotë Ai i Lartësuar: **“Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj, që diskutoi me ty për burrin e vet dhe iu ankua Atij.”** (Kuran, 58:1). Dhe thotë: **“(Allahu) tha: ‘Mos u frikësoni! Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh’.”** (Kuran, 20:46). Dhe thotë: **“Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju.”** (Kuran, 11:112). Mirëpo e folura e Tij nuk është si të folurit tanë, po ashtu shikimi dhe dëgjimi i tij nuk është si i yni, pasi Allahut nuk i ngjason askush nga krijesat e Tij. Ai i dëgjon të gjitha zërat sado që të jenë të ulëta, Ai i sheh të gjitha gjërat, sado që të jenë të largëta, Allahu dëgjon çdo gjë edhe sheh çdo gjë. Dëgjimi dhe shikimi i Tij nuk i përngjan dëgjimit dhe shikimit të krijesave e që është i mangët dhe i dobët. Kjo pasi Allahut **“Asgjë nuk i përngjan Atij dhe Ai është i Gjithëdituri, Gjithëshikuesi.”** (Kuran, 42:11). Do ishte mirë që ndërkohë të bëhet lidhshmëria me virtytet drejtpërdrejt me temën në fjalë, duke i thënë se Allahu dëgjon dhe sheh çdo gjë, a na takon neve të flasim gjëra që nuk e kënaqin Atë, apo të na shikojë Ai në gjendjen që nuk na takon?!(189)



A ka Allahu uri apo etje?

Allahu i Madhëruar i ka të gjitha cilësitë e plota dhe të përkryera, Atij nuk i atribuohet asnjë cilësi e mangët. Sigurisht uria dhe etja janë manifestime të mangësisë dhe dobësisë, kështu që nuk lejohet t'i atribuohen Allahut cilësitë e dobësisë. Allahu nuk ka nevojë për ushqim e pije,⁽¹⁹⁰⁾ pasi Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe nuk ka nevojë për ndonjë gjë, se sikur të kishte nevojë për ndonjë gjë, atëherë nuk do të ishte Zot. Allahu është *“Es Samed”*, është Ai të Cilit i drejtohen krijesat për çdo nevojë, meqenëse është i Fuqishëm dhe ka mundësi ta bëjë atë që i kërkohet. I Përkryeri që i ka të gjitha cilësitë të përsosura në shkallën më të lartë. Ai i Cili nuk ka asnjë të metë. I Përhershmi, që nuk ka pasur fillim dhe nuk ka mbarim. Ai që nuk ka nevojë për asgjë, por të gjitha krijesat kanë nevojë për Të. Ai që nuk ka brendësi. Ai pra nuk ha dhe nuk ka nevojë për ushqim e as për pije, i Pasur është Ai nga çdo gjë.

Mund t'i thuhet gjithashtu që nuk ka hapësirë për krahasim në mes të krijesave dhe Krijuesit. Nuk është me doemos që çdo gjë që zbulojmë apo shpikim t'i ketë edhe cilësitë tona apo formën tonë, apo jo? Kështu pra, Allahu nuk ka uri e as etje. Më lejo të të pyes diçka - i drejtohem fëmijës -, kush e ka shpikur biçikletën? Do të përgjigjet se e ka shpikur prodhuesi i saj, sigurisht. Shkëlqyeshëm, eja tani biri im (bija ime), le të imagjinojmë së bashku që biçikleta flet dhe e pyet shpikësin e saj: -Çfarë hani apo pini ju? Vallë, çfarë do t'i themi biçikletës?! Do t'i themi asaj se kjo çështje nuk është e jotja, nuk të hyn fare në punë, apo çfarë do të përfitoje tek e fundit sikur ta dije? Ta zëmë sikur po të përgjigjemi, vallë a përvetësove aftësi të tjera përveç atyre themeloreve të rolit tënd të caktuar, që janë të ecësh me shpejtësi dhe pa pengesa?

Shkëlqyeshëm! Pra kështu, o i dashuri im, Allahu na ka krijuar ne për një rol të caktuar që është: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Kuran, 51:56). Këto lloj pyetjesh nuk do të na ndihmojnë të përmbushim rolin e caktuar për ne nga Krijuesi ynë. Përkundrazi, këto pyetje do të na zhvendosin mendjet tona nga roli ynë i kërkuar nga Krijuesi në gjëra të tjera të cilat na lënë pas. T’i kthehemi shembullit tonë imagjinar të biçikletës, a thua kur do të drejtohej biçikleta që të na pyesë ne? Atëherë kur të ketë ndonjë prishje apo jo, ajo i drejtohet shpikësit të saj që t’i rregullojë të metat, sigurisht. Prandaj ne i drejtohem Allahut të Lartësuar me lutje kur të na kaplojë plogështia në adhurimin e Tij, apo kur të na godasë ndonjë dëm i caktuar.

Sa është fuqia e Allahut?

Nëse flasim për fuqinë apo forcën e kufizuar atëherë ne po flasim për një cilësi të mangët me të meta, pasi kufiri i fundit i forcës është fillimi i dobësisë së saj, kurse dobësia nuk i takon Allahut të Plotfuqishëm. Allahu ka fuqi absolute të pafundmë dhe Ai nuk është i Tillë që ta bëjë ndonjë gjë Atë të paaftë (pa mundësi për të vepruar), i pastër nga çdo e metë është Ai. Allahu i Madhëruar thotë: **“A nuk e di ti se Allahu është i Fuqishëm për (të bërë) çdo gjë?”** (Kuran, 2:106). Kur Ai do diçka i thotë asaj: bëhu, dhe bëhet! Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë, sepse Ai është Krijuesi i çdo gjëje, Ai nuk është i Tillë që ta bëjë Atë ndonjë gjë të paaftë (të pa mundur për të vepruar) në tokë e as në qiell. Fuqia e kufizuar është fuqia e krijesave, pasi është fuqi e krijuar, kurse fuqia e Krijuesit, nuk ka kufi e as mangësi, kështoj vetëm Allahut i takon e drejta për tu adhuruar, për ta lutur apo drejtuar Atij me kërkesa, sepse vetëm Ai është i Gjithëfuqishëm që t’ua plotësojë kërkesat krijesave, për t’i furnizuar ata, për t’u përmbushur dëshirat dhe për t’u kujdesur për çështjet e tyre.⁽¹⁹¹⁾

Ku është Allahu? Po madhësia e Tij sa është?

Pasi ta kuptojë fëmija në vegjëli se Allahu është Ai që e ka krijuar, se Allahu i do shumë fëmijët dhe se Ai i ka begatuar ata me shumë mirësi, mund t’i sqarohet atij që Allahu është mbi qiell. Siç thotë Allahu ﷻ: **“A jeni të sigurt se kush është mbi qiell (Allahu)...?”** (Kuran, 67:16). Pra, i Lartësuari është mbi qiell, ndërsa dituria e Tij përfshin çdo vend. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni.”** (Kuran, 57:4). Duhet pasur kujdes që të mos themi Allahu është në çdo vend, pasi kjo nënkupton që Ai është brenda çdo gjëje, pa dyshim që kjo është një e pavërtetë e madhe. Ne jemi të obliguar të pohojmë atë që është përcjellë në hadithet e sakta, siç thotë Muavije ibn el Hakem es Sulemi: “Kam pasur një tufë bagëtish të cilat i ruante një robëreshë e imja. Një ditë, dola për ta kontrolluar tufën dhe pashë që ujku e kishte grabitur një prej tyre. Unë jam njëri prej bijve të Ademit (d.m.th.: kam natyrë njerëzore), prandaj u zemërova dhe e godita rëndë robëreshën. Pastaj erdha tek i Dërguari, i

tregova për atë që bëra dhe ai e cilësoi veprimin tim gabim të madh. Unë i thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, a ta liroj nga robëria?’ Tha: ‘Ma sill këtu!’ E solla atë dhe atëherë Profeti e pyeti: ‘Ku është Allahu?’ Ajo tha: ‘Mbi qiell (në lartësi).’ I tha: ‘Kush jam unë?’ Tha: ‘Ti je i Dërguari i Allahut.’ Pas kësaj më tha: ‘Liroje, sepse ajo është besimtare’.”⁽¹⁹²⁾ Megjithëse Ai është mbi qiell, Ai ka mundësi të na shikojë dhe të na dëgjojë në çdo vend. Të theksuarit e vazhdueshëm të fëmijët që Allahu na mbikëqyr në çdoherë, e zhvillon te fëmija përmbytjen e brendshme dhe e bën tek ai mbikëqyrjen e Allahut burim të ndërgjegjes.

Kurse për sa i përket madhësisë së Tij, assesi Allahu nuk krahasohet me asgjë prej krijesave të Tij. Allahu është më i Madhi sesa çdo gjë, më i Madh se të gjitha krijesat, sado që të jenë të mëdha ato, Krijuesi i tyre është më i Madh. Ai është që i bën kodrat hi e pluhur, i lëviz detet, e urdhëron ujin të futet brenda tokës, nuk ndodhë ndonjë gjë në kozmos vetëm së me lejen dhe dëshirën e Tij, të Lartësuarit. Allahu nuk ka nevojë për krijesat, qielli është krijesë nga krijesat e Allahut, ndërsa ekzistenca e Tij mbi qiell nuk nënkupton kufizimin i Tij në qiell, Ai nuk ka nevojë për qiellin, pasi Ai është i Pasur nga çdo gjë.⁽¹⁹³⁾



Si ka mundësi që Allahu na shikon ne, ndërsa ne nuk e shohim Atë?

Shqisa e shikimit të cilën Allahu na e ka dhënë në këtë botë është e dobët, shumë gjëra nuk mund t’i shohim përmes saj; kështu që e vëren se si njeriu e përdor mikroskopin dhe mjete të tjera zmadhuese. Atëherë kur njeriu është i paafët t’i shikojë disa gjëra të krijuara, është edhe më parësore që të jetë i paafët që ta shikojë Allahun e Lartësuar. Aftësitë e njeriut në këtë botë nuk ia mundësojnë atij ta shohin Allahun. Ne nuk kemi mundësi ta shohim Allahun, mirëpo ne e besojmë Atë dhe besojmë që Ai është Mëshirëbërës dhe na do ne. Ai është i Forti, i Gjithëfuqishmi që është i aftë për çdo gjë dhe Ai di çdo gjë. Ai e di që ne tani po flasim për Të, Ai është më i Larti, shumë lart mbi ne. Ai na shikon të gjithë ne përnjëherë. Siç mund të jetë shembulli i një njeriu të hipur mbi kulm të ndërtesës i cili i vështron të gjithë njerëzit në rrugë, ndonëse ata nuk e shohin atë. Allahu i Lartësuar na shikon ne, ndërsa ne nuk e shohim atë. Ka shumë gjëra të cilat ne nuk arrijmë t’i shohim edhe pse ato janë të pranishme.

I themi fëmijës se sytë tanë nuk mund të shohin çdo gjë. Ne nuk e shohim zërin, ndonëse ne e dëgjojmë atë, ne nuk e shohim ajrin edhe pse e ndiejmë atë; e kështu pra, sytë tanë nuk mund ta shohin Allahun në këtë botë, por shpresojmë që ta shohim Allahun në Xhenet, me lejen e Allahut. Atje do të kemi sy më të mirë të cilët na e mundësojnë ta shohim Allahun e Madhëruar,⁽¹⁹⁴⁾ kështu pra, **“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë.”** (Kuran, 6:103).



A i shikon Allahu të gjithë njerëzit kur ata janë shumë?

Që t'i përgjigjemi fëmijës në këtë pyetje, praktikisht e marrim fëmijën dhe qëndrojmë me të në rrugë, më pas i themi: -Eja, shiko njerëzit dhe na trego numrin e atyre të cilët po i shikon. Dhe e fillojmë numërimin e tyre bashkë me fëmijën. Më pas e marrim fëmijën dhe ngjitemi më lart, të themi në katin e dytë të shtëpisë, i kërkojmë t'i numërojnë përsëri njerëzit të cilët po i shikon. Pastaj e marrim fëmijën dhe ngjitemi në kulm të ndërtesës dhe i kërkojmë t'i numërojnë njerëzit të cilët po i shikon. Shtuar kësaj, i sjellim fëmijës edhe një palë dylbi që t'i shikojë njerëzit me pamje edhe me të mirë dhe t'i numërojnë të gjithë me saktësi. Nga ky shembull ia sqarojmë atij që ne nuk mund t'i llogarisim gjërat përshkak të aftësive tona të kufizuara, kurse aftësia e Allahut është më e madhe dhe madhështore sesa aftësia e gjithë krijesave; gjithnjë duke ia gdhendur fëmijës **“... se Allahu është i Fuqishëm për (të bërë) çdo gjë?!”** (Kuran, 2:106).

Mund t'i parashtrojmë fëmijës një pyetje tjetër të kapshme nga shqisat ku i themi atij: -A beson se milingona mund të na shikojë ne me të gjitha detajet tona, apo ajo na shikon vetëm si një përfytyrim a hije? Do të përgjigjet që milingona nuk mund të shikojë nga ne vetëm se një pjesë të vogël të gishtit të këmbës nëse do gjendej në tokë, aq sa asaj mund t'i duket gishti sikurse një kodër e madhe. Mirë, më tutje e pyesim atë: -A mendon që milingona mund të na pyesë ne duke na thënë se si ka mundësi që ti na shikon, të gjithave përnjëherë? Përgjigjja jote do të ishte se kjo është shumë normale, pasi kjo përshtatet me aftësitë tuaja me të cilat të ka krijuar Allahu. Ndërsa aftësitë e milingonës janë të kufizuara, aq sa mund të ketë shumë shtëpi milingonash në disa anë dhe ti mund t'i vësh ato me shumë lehtësi në të gjitha ato vende në të njëjtën kohë. Kurse milingona me aftësitë e saj të kufizuara mund të mos shikojë ashtu siç shikon ti. Prandaj, pasi ramë dakord që Allahut të Lartësuar nuk i ngjason asgjë dhe që Ai është i Plotfuqishëm të bëjë çdo gjë, nuk është e përshtatshme ta pyesim Allahun - me gjithë aftësitë tona të kufizuara të dobëta - për ndonjë gjë që për Allahun është shumë e zakonshme. Fuqia e Allahut është më Madhe dhe më Madhështore se fuqia e të gjitha krijesave dhe **“...se Allahu është i Fuqishëm për (të bërë) çdo gjë?!”** (Kuran, 2:106).



A i shikon Allahu njerëzit në errësirë?

Mund t'i përgjigjemi fëmijës duke e shtyrë atë që të shikojë ndonjë skenë nga ndonjë film ku shfaqen ushtarët me pajisjet e tyre ushtarake të cilët shohin natën përmes dylbive të posaçme për shikim gjatë natës. Apo ia shfaqim fëmijës ndonjë pamje se si shohin disa kafshë dhe shpendë përgjatë natës. Në disa filma të animuar të cilët i shikon fëmija a lodra me të cilat luan, gjenden disa rreze, p.sh.: laserike, përmes të cilave qartësohet çfarë fshihet pas gjërave, gjithashtu na mundësojnë t'i shikojmë gjërat në errësirë. Pastaj i themi fëmijës, a nuk po shikon se si njeriu, kjo krijesë e dobët, apo ndonjë krijesë e thjeshtë po arrin t'i shikojë gjërat nganjëherë në errësirë? Atëherë çfarë të themi për Zotin tonë i cili e ka krijuar njeriun dhe të gjitha krijesat e tjera?!(¹⁹⁵) Allahu na ka dhënë forcën për t'i zbuluar këto gjëra, si atëherë të mos ketë Ai mundësi t'i shikojë gjërat në errësirë ndërsa Ai është i Plotfuqishmi, Gjithëvëzhguesi i çdo gjëje? Ai është më Madhështori, më i Madhi dhe fuqisë së Tij nuk i bën ballë dhe nuk arrin ta përkufizojë Atë asgjë.



Si ka mundësi që Allahu na shikon në shtëpitë tona, ndërkohë që dyert dhe dritaret e shtëpive janë të mbyllura?

Ia shfaqim fëmijës një pamje të rrezeve mjekësore dhe më pas i themi atij se njeriu, të cilin e krijoi Allahu, arriti ta shikojë kockën përmes fotografimit me rreze rëntgen, ndërkohë që ai gjendet i mbështjellë dhe i mbyllur mirë. Atëherë, si do të jetë çështja e Zotit tonë, i Cili e krijoi vet njeriun? Ai i Lartësuar sigurisht që na shikon në shtëpitë tona edhe sikur të gjitha dyert e shtëpive të jenë të mbyllura, pasi asgjë nuk i ngjason Allahut. Ai nuk është si njerëzit që ndërtesat e privojnë nga shikimi se çfarë ka brenda tyre. S'ka mundësi, në asnjë mënyrë, të jetë Krijuesi si krijesat, sepse Allahu i Lartësuar është i Gjithëfuqishëm të bëjë çdo gjë. Gjithashtu, është e udhës që kjo përgjigje t'i lidhet me virtytet e fëmijës, duke ia përforcuar anët e ndjenjës së mbikëqyrjes së Allahut dhe përkatësisë fetare të tij. (¹⁹⁶)



A i di Allahu të gjitha punët tona? A i mbikëqyr Ai të gjithë njerëzit?

Vazhdimisht duhet t'i bëhet me dije fëmijës se Allahu i ka të gjitha cilësitë e bukura dhe të përkryera nga çdo anë pa asnjë të metë. Duhet që t'i mësohet atij se fuqia e Allahut është e pakufizuar, Ai është i Gjithëfuqishmi, i Plotfuqishmi, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Allahu është i Fuqishëm për (të bërë) çdo gjë?”** (Kuran, 2:106). Pra, pasi fuqia e Tij është Madhështore, asgjë në Tokë e as në qiell nuk e bën Atë të paaftë (të pa mundur) për të vepruar ndonjë gjë. Ne nuk kemi mundësi assesi ta krahasojmë fuqinë e Tij me fuqinë e krijesave, sado që të jetë e madhe fuqia e krijesave, fuqia e Allahut është shumë më e madhe sesa ajo.

Sa për krahasim mund të marrim shembullin e kamerës dhe thjerrëzave të saj, ku ajo mund të regjistrojë çdo gjë të madhe a të vogël që është nën thjerrëzën e saj. Ndërsa, Allahu ka fuqinë më të madhe dhe Atij i takon shembulli më i Lartë, Ai mund t'i mbikëqyrë dhe vëzhgojë të gjithë njerëzit përnjëherë, në të njëjtën kohë, sepse fuqia e Tij është e pakufizuar, nuk ka fund, Allahu i Madhëruar di dhe dituria e Tij është gjithëpërfshirëse dhe e plotë nga çdo anë dhe për çdo gjë.⁽¹⁹⁷⁾

Një shembull tjetër të cilin mund ta marrim, i themi fëmijës ta zëmë që diku ndodhet një kompani shumë e madhe e cila dëshiron t'i mbikëqyrë punëtorët e saj. Dhe kështu, kompania i vendos kamerat vëzhguese duke mos i njoftuar fare punëtorët e saj, kështu ajo i mbikëqyr të gjitha sektorët e kompanisë në të njëjtën kohë. Kur robi i shkretët të cilin e ka krijuar Allahu e arrin këtë shkallë, vallë a nuk mundet Krijuesi i këtij robi t'i mbikëqyrë të gjithë robërit e Tij, në të njëjtën kohë?



Pse njeriu vdes, ndërsa Allahu është i pavdekshëm?

Vdekja është nga caktimet e Allahut të cilën ia ka caktuar krijesave të tij, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne.”** (Kuran, 29:57). Prandaj, vdekja e njeriut është fillimi i jetës së ardhshme, jetë kjo e cila është më e rëndësishmja.

Vdekja është dukuri e pandashme që tregon dobësinë e krijesave, kështu kjo dobësi nuk i takon Allahu të Lartësuar. Allahu nuk është i krijuar dhe nuk do të vdesë, ndërsa njeriu është i krijuar dhe do të vdesë. Jeta e Allahut të Lartësuar nuk është si jeta jonë, jeta jonë, në këtë botë, mbaron me vdekjen tonë, siç do vdesin të gjithë krijesat e tjera dhe do mbetet vetëm Allahu i Madhëruar. Jeta e Allahut është e plotë nga të gjitha anët që doemos rezulton që të gjitha cilësitë e Tij të jenë të plota, të përkryera nga çdo e metë, e prej tyre nga më të rëndësishmet është cilësia e jetës, që nuk vdesë kurrë.⁽¹⁹⁸⁾



A më do mua Allahu ashtu siç e dua unë Atë?

Allahu është Mëkatfalësi, Mëshirëbërësi i cili i do të mirët, të drejtë dhe të sinqertët. Thotë Allahu i Lartësuar: **“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan...”** (Kuran, 5:54). Reflektohet nga dashuria e Allahut për robërit e Tij se Ai i nderon ata, i ruan dhe kujdeset për ta, i udhëheq çështjet e tyre, i furnizon dhe ua falë atyre gjynahet. Secili prej nesh e ndien dashamirësinë e Allahut dhe bujarinë e Tij. Allahu e do robin e Tij që i bindet, i afrohet Atij dhe i mbledh shkaqet që të përfitojë dashurinë e Tij; siç janë: kujdesi i faljes së namazeve, bamirësia ndaj prindërve, lëmosha, bamirësia ndaj njerëzve, sinqeriteti, leximi i Kuranit, përmendja e Allahut në mënyrë të rregullt, si dhe shumë punë tjera të mira. Kësisoj, çdonjëri që i bën këto vepra, Allahu i Lartësuar do ta dojë atë.⁽¹⁹⁹⁾



Pyetjet që kanë të bëjnë me besimin në engjëjt



? Kush janë engjëjt? Ç'formë kanë ata?

Engjëjt janë krijesa prej krijesave të Allahut të krijuar nga drita. Allahu i ka krijuar ata para se t'i krijojë njerëzit. Ata kanë dëshirë, mendje dhe krahë. Pamja e krijimit të tyre është e bukur. Ata kanë aftësinë e shndërrimit në formën e njerëzve, as nuk hanë, as nuk pinë. Janë robër të Allahut, të cilët bëjnë çdo gjë që urdhërohen. Ndahen në shkallë-shkallë, sipas vlerës të cilën e kanë. Më i miri prej tyre është Xhibrili (*alejhis-selam*), i cili është i autorizuar për bartjen e shpalljes të profetët (*alejhimus-selam*). Pastaj vijnë Mikaili, Israfilin e të tjerë. Prej tyre janë edhe *Ruajtësit*, të cilit janë të urdhëruar t'i ruajnë robërit në çdo kohë. Numri i tyre është shumë i madh dhe secili prej tyre është i ngarkuar me ndonjë detyrë të veçantë për ta zbatuar.⁽²⁰⁰⁾

? Si i kanë emrat engjëjt?

Numri i engjëjve është tejet i madh, nuk e di numrin e tyre askush pos Allahut të Madhëruar. Nga emrat e tyre njohim: Xhibrilin, Mikailin, Israfilin, Riduanin, Malikun (*alejhimus-saletu ues-selam*). Më pas gjenden: *Mbajtësit e Arshit*, *Ruajtësit* të cilët i regjistrojnë veprat, e shumë të tjerë.⁽²⁰¹⁾

? Pse i ka krijuar Allahu ata?

Allahu i ka krijuar ata që të bëjnë mirë, janë tërë mirësi, nuk bëjnë keq, madje as që dinë të bëjnë keq. Engjëjt, në esencë, ndodheshin në qiell, por zbritja e njeriut në Tokë, i obligoi edhe ata të zbresin në Tokë, për t'i përmbushur detyrat e caktuara që ua ka obliguar Allahu; siç janë: ruajtja, kujdesi, mbikëqyrja, bartja, ndihma, kërkimi i faljes, marrjes pjesë në vendet e përmendjes së Allahut dhe detyra të tjera. Mund t'i thuhet fëmijës se engjëjt i kanë dy detyra kryesore, të cilat janë: adhurimi i Allahut të Lartësuar dhe udhëheqja e përkujdesja për çështjet e kozmosit.⁽²⁰²⁾

? Pse ne nuk i shikojmë engjëjt?

Njerëzit nuk kanë aftësi që t'i shohin engjëjt në formën e tyre të vërtetë në të cilën i ka krijuar Allahu. Kështu, engjëjt shndërrohen në formë të njeriut, me qëllim që të arrijë njeriu t'i shikojë dhe të bashkëveprojë me ta. Përmendim këtu Xhibrilin (*alejhis-selam*) që u shndërrua në formën e beduinit siç na përcillet në hadithin e njohur si hadithi i Xhibrilit që erdhi të na i mësojë çështjet e fesë.⁽²⁰³⁾

? Xhindet kush janë?

Xhindet janë krijesa prej krijesave të Allahut, të cilët janë krijuar nga zjarri, janë të ngarkuar që t'i binden Allahut në urdhëresat e Tij dhe të largohen nga të ndaluarat. Janë krijesa të cilat do të vdesin siç vdesin të gjitha krijesat e tjera. Nuk kemi mundësi dhe aftësi që t'i shohim ata. Allahu i ka krijuar ata me aftësi të cilat dallojnë nga aftësitë e njeriut. Ata, p.sh.: kanë mundësi të fluturojnë, kanë mundësi të lëvizin me shpejtësi dhe kanë aftësi të shndërrohen në forma të ndryshme.⁽²⁰⁴⁾ Gjithashtu, dallon esenca nga ç'janë krijuar njerëzit prej xhindeve. Njeriu është krijuar nga dheu, xhindet janë të krijuar nga zjarri.

? Kush janë më të fortë, engjëjt apo xhindet?

Krijimi i engjëjve është i vazhdueshëm, nuk vdesin derisa të ndodhë Kiameti, kurse xhindet vdesin më herët. Pasi qenka kështu, atëherë engjëlli i vdekjes është ai që do t'i marrë shpirtat, me lejen e Allahut, derisa të vdesë edhe ai. **“Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes.”** (Kuran, 39:42).⁽²⁰⁵⁾ Kësisoj, na bëhet e qartë se engjëjt nga kjo anë janë më të fortë. Madje edhe në jetën e kësaj bote, shejtanët (nga xhindet) u frikësohen engjëjve, mu siç ndodhi në betejën e Bedrit kur shejtani i pa engjëjt të cilët i dërgoi Allahu ndihmë për besimtarët, iu tha jobesimtarëve: **“Djalli ua zbukuroi atyre veprat e këqija dhe u tha: ‘Askush në botë nuk do t’ju mund sot dhe unë jam mbrojtësi juaj.’ Mirëpo, kur u ndeshën dy ushtritë (me engjëjt përkrah besimtarëve), ai u kthye nga thembrat e tij dhe u tha (jobesimtarëve): ‘Unë nuk kam të bëj me ju; unë shoh atë që ju nuk e shihni dhe i frikësohem Allahut, sepse Allahu ndëshkon ashpër’.”** (Kuran, 8:48).

? A vdesin engjëjt?

Po, engjëjt janë krijesa nga krijesat e Allahut. Kështu që, çdo gjë do të vdesë përveç Allahut të Lartësuar, të Gjallit, të Përvetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!⁽²⁰⁶⁾ Thotë Allahu i Lartësuar: **“Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës (Qenies) së Tij!”** (Kuran, 28:88). Kësisoj, të gjithë banorët e Tokës dhe banorët e qiellit do të vdesin, aq sa nuk do të mbesë askush tjetër përveç Allahut të Lartësuar, i Cili është i Gjalli, i Përvetshëm që nuk vdes kurrë.

Pyetjet që kanë të bëjnë me besimin në libra



Ç'janë librat qiellorë?

Librat qiellorë janë ata të cilët Allahu i ka zbritur te të Dërguarit e Tij (*alejhimus-salatu ues-selam*), që t'i përcjellin porosinë e Shpalljes dhe të zbatimit të ligjeve të Tij. Ata janë udhëzim dhe mëshirë për krijesat, që të jenë të lumtur në këtë botë dhe në botën e ardhshme. Nga ata libra jemi njoftuar që Allahu ua ka zbritur fletushkat Ibrahimit (*alejhis-selam*), Davudit (*alejhis-selam*) Zeburin, Musës (*alejhis-selam*) Teuratin, Isës (*alejhis-selam*) Inxhilin dhe të Dërgurit tonë, Muhamedit ﷺ Kuranin.⁽²⁰⁷⁾



Pse ne kemi nevojë për Kuranin? Pse Kurani është shenjë mrekulie e përhershme?

Nëse ndonjë pajisje e thjeshtë e cila, tek e fundit, është prodhuar nga njerëzit ka nevojë për libra udhëzues, doracakë orientues se si të përdoret në mënyrën më të mirë, atëherë vallë, njeriu që është krijesë e Allahut, a nuk është më parësore që të ketë nevojë për libër udhëzues dhe orientues që t'ia tregojë atij rrugën e shpëtimit, suksesit dhe përmirësimit në këtë botë dhe botën tjetër. Allahu i Lartësuar thotë: **“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!”** (Kuran, 67:14).

Ndërsa të qenët e Kuranit shenjë mrekulie e përhershme është ngase Profeti Muhamed ﷺ është vula e profetësisë. Kështu që, patjetër duhej që të jetë mrekullia e tij e vazhdueshme, si pasojë se nuk ka më profet pas tij. Do duhej që të mbestë dëshmi sfiduese për krijesat deri në Ditën e Kiametit. Ndërsa provat e mrekullisë së Kuranit janë tejet të shumta. Nga më të rëndësishmet mund të theksojmë: mrekullia gjuhësore dhe retorike, ku përmes së cilës Allahu i sfidoi arabët, të cilët ishin prijatarët e gjuhës së kulluar dhe retorikës së mahnitshme. Ndërsa njerëzit dhe xhindet ishin të paaftë të sjellin diçka të ngjashëm me këtë Kuran madhështor, e këtu kemi prova për burimin hyjnor të Kuranit.⁽²⁰⁸⁾

Pse Allahu nuk e mori përsipër që t'i ruajë librat e tjerë të mëhershëm?

Duhet ta dimë që Allahu i Lartësuar bën çfarë të dojë, Ai ka urtësi, nga e cila diçka dimë e diçka jo. Disa shenja të qarta tregojnë se librat e mëhershëm nuk ishin mrekullitë kryerore të profetët e kaluar, kësaj vazhdimësie e tyre nuk ishte e kërkuar, shtuar kësaj që edhe ligjshmëria e tyre ishte e kufizuar në kohë dhe për njerëz të caktuar.⁽²⁰⁹⁾

Cilat janë provat që vërtetojnë se nga Kurani nuk ka ndryshuar asgjë?

Kjo pyetje zakonisht nuk shtrohet vetëm se nga fëmijët të cilët janë në ciklin e lartë fillor e më tej. Kështu që duhet t'u sqarohet me qetësi dhe nga një pikënisje logjike, e cila ia vërteton atij saktësinë e Kuranit. I themi atij se gjërat kur përsëriten miratohen dhe kur përhapen atëherë vërtetohen. Kurani është përcjellë tek ne në atë formë që është e pamundur ta kapë ndonjë shtrembërim, pasi është përcjellë nga një grup njerëzish të një grup tjetër njerëzisht të cilët është e pamundur që të pajtohen për ndonjë gënjeshtëri. Këtë e dinë të veçantët dhe të përgjithshmit dhe se muslimanët e trashëguan përcjelljen e Kuranit gjeneratë pas gjenerate. E mësonin së bashku në vendmësimet e tyre, e këndonin në namazet e tyre dhe ua mësonin fëmijëve të tyre, aq sa që ndonjë hoxhë i respektuar e serioz po të gabonte vetëm në një shkronjë nga Kurani, do të shpejtonin të vegjlit duke ia përmirësuar para të mëdhenjve; e kështu derisa mbërriti te ne, i pastër dhe i kulluar nga çdo shtesë, i ruajtur nga çdo mungesë a shtrembërim.

Sikurse të pranohej mohimi i këtij argumenti, atëherë do të mohoheshin të vërteta të tjera të mëdha e të sakta, siç është ekzistimi i Profetit ﷺ, shokëve të tij, sahabëve (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*) apo të famshmëve të tjerë përgjatë historisë. Këtë nuk e mohon askush nga mendjendriturit. Gjithashtu, Kurani përmban sfidën e Allahut shtruar njerëzve e xhindeve që të vijnë me një mrekulli sikur ky, e ata ishin të paaftë të bënin një gjë të tillë. Në tërë Kuranin nuk mund të gjen asnjë mospërputhje, apo kundërthënie, apo mangësi. Në të gjen vetëm se mrekulli në ndodhi, ligje e dispozita edhe fjalë... E gjitha kjo dëshmon se ai nuk e ka zanafillën nga njerëzit punët dhe fjalët e të cilëve u vihet pas ndryshimi, kundërthënia e mangësia. Prandaj ai Kurani është nga Allahu dhe Ai e ka marrë përsipër ruajtjen e tij.⁽²¹⁰⁾

Pyetjet që kanë të bëjnë me besimin në profetët



Kush janë profetët?

Ata janë njerëz nga bijtë e Ademit, Allahu u ka shpallur atyre profetësinë dhe i ka urdhëruar për ta përcjellë Shpalljen te popujt e tyre. Thirrja e tyre është që të adhurohet vetëm Allahu. I pari nga ata është Ademi (*alejhis-selam*) dhe i fundit është Profeti ynë Muhamedi ﷺ. Numri i tyre është shumë i madh dhe Allahu i ka dërguar ata te të gjithë popujt të cilët kanë jetuar në Tokë, ashtu që në çdo periudhë nga periudhat e historisë kishte profet që e thërriste popullin e tij dhe i porosiste ata të shkonin për në rrugën e drejtë të shpëtimit.



Pse i ka dërguar Allahu profetët?

Allahu i ka dërguar profetët e Tij mëshirë për njerëzit, që t'i udhëzojnë ata dhe t'ua kumtojnë atyre porositë e Zotit të tyre. Profetët janë individë të njohur shumë mirë te popujt e tyre, saqë dëshmojnë për ata vetëm se me mirësi para se t'u shpallej atyre profetësia. Allahu i ka bërë profetët shëmbëlltyra të dukshme përballë njerëzve. U mësojnë njerëzve me moralin dhe sjelljet e tyre, ua shpjegojnë atyre çfarë u bën dobi dhe çfarë u bën dëm. Kësisoj, dërgimi i profetëve, ngritja e argumenteve ndaj krijesave dhe mbledhja e njerëzve në një fe të vetme, e cila është të adhuroarit e Allahut të Vetëm të pashok.⁽²¹¹⁾ Pra, njerëzit kanë nevojë për udhëzues që ua tregojnë atyre rrugën e shpëtimit me gjuhën që e kuptojnë. Për këtë arsye, Allahu i zbriti librat tek ata profetë me gjuhën e popujve të tyre, që t'u përçohet atyre shpallja dhe që ta kuptojnë atë në mënyrë të qartë e të shpjeguar, kthjellët që u në fle zemra pa ngatërresa e turbullira.



A janë profetët të mbrojtur nga gabimet?

Profetët janë njerëz si të gjithë njerëzit, pra kanë natyrë njerëzore. Allahu i ka mbrojtur ata nga gabimet që kanë të bëjnë me Shpalljen, gjithashtu i ka mbrojtur ata të mos njollosen me ndonjë të metë në sjelljet dhe moralin e tyre, që të jenë shëmbëlltyrë e shkëlqyeshme e njerëzit t'i pasojnë ata në fjalët dhe veprat e tyre dhe në mënyrë që të mos i marrin si urë për ta diskredituar Shpalljen. Megjithatë, krahas mbrojtjes së tyre nga Allahu, ata mbeten fundi fundit njerëz, që bien në gabime të zakonshme, por këto gabime nuk e njollosin përcjelljen e tyre të Shpalljes, siç mund të jetë shembull: gabimi i përcaktimit të vendit të përshtatshëm për mbjellje, apo pozitës së duhur gjatë luftës, apo stërmundimi në rrugën e thirrjes për te Allahu.⁽²¹²⁾

Kush është Muhamedi ﷺ?

Ai është Profeti i fundit të cilin e dërgoi Allahu te të gjithë robërit e Tij. Quhet Muhamed, i biri i Abdullahit, i biri i Abdulmutalibit, nga fisi *hashimij* e pastaj *kureshij*. Ka lindur në Mekë ditën e hënë në muajin *Rabi'ul evel*, i njohur si Viti i Elefantit. Babai i ka vdekur derisa ishte në barkun e nënës së tij, ndërsa nëna i vdiq kur ishte gjashtë vjeç. U kujdes për të gjyshi i tij Abdulmutalibi, kur vdiq ai mosha e Profetit ﷺ ishte tetë vjeç. Më pas e morri nënë përkuqjesje xhaxhai i tij, Ebu Talibi, i cili e thërriste Profetin ﷺ i sinqerti, besniku, si rezultat i moralit të tij të lartë. Iu shpall profetësia kur ishte në moshën dyzet vjeçare. E filloi thirrjen e popullit të tij në Mekë për në fenë islame për trembëdhjetë vite. Kur iu shtuan mundimet emigroi për në Medine dhe qëndroi aty dhjetë vite. Aty në Medine i vëllazëroi *ensarët* dhe *muhaxherët*, e zbatoi ligjin e Allahut dhe gjykoj me të. Vdiq Profeti ﷺ në vitin e njëmbëdhjetë *hixhrij* (pas emigrimit të tij në Medine) pasi përcolli Shpalljen dhe përmbushi amanetin.⁽²¹³⁾

Çfarë e dëshmon vërtetësinë e të Dërguarit të Allahut ﷺ?

Provat e profetësisë së Muhamedit ﷺ janë tejet të shumta. Më e rëndësishmja prej tyre është Kurani famëlartë. Ky libër i mbushur me mrekulli i bën njerëzit, që vazhdojnë gjeneratë pas gjenerate, të magjepsen nga thesaret dhe perlat e tij që mahnitin mendjet e ndritura njerëzore. Gjithashtu, nga provat e profetësisë së tij është vetë biografia e tij, virtytet e tij të larta, për të cilat edhe armiqtë e cilësuan me to para miqve të tij. Ai morri nofkën: *i besueshmi besnik*. Po ashtu, nga shenjat e profetësisë së tij janë mrekullitë e tij të cilat u përcollën tek ne brez pas brezi nga njerëzit të cilët i përjetuan ato. Po ashtu, nga shenjat e vërtetësisë së tij ﷺ është kjo fe e mbushur e gjitha me plotë bukuri. Po ashtu, paralajmërimet për ardhjen e tij nga librat e mëhershëm. Po ashtu, kjo përhapje e vazhdueshme e fesë islame në çdo kohe e vend është nga shenjat e vërtetësisë së tij. Nga shenjat e vërtetësisë së tij është edhe njoftimi që bëri për popujt e kaluar dhe për ndodhitë e së ardhmes.⁽²¹⁴⁾

Si u ngrit në qiell Profeti ﷺ brenda një nate të vetme?

Profeti ﷺ është bartur mbi një kafshë të quajtur *el Berak* deri në Xhaminë e Shenjtë të largët (në Kuds), më pas është ngritur për në qiell nën shoqërimin e Xhibrililit (*alejhis-selam*). Allahu është i Gjithëfuqishëm që të bëjë çdo gjë dhe Atë asgjë në Tokë e as në qiell nuk mund ta bëjë të paaftë për të vepruar ndonjë gjë. Sikurse që sot e shohim se si njeriu me gjithë dobësinë e tij arriti të ndërtojë aeroplanin që ia kalon shpejtësisë së zërit. Apo shpikjen e mjeteve të dërgimit të imazhit në formën tre dimensionale, duke e bërë imazhin e personit në shumë vende në të njëjtën kohë. Allahu është më i Madh, më Madhështor dhe më i Fuqishëm sesa krijesat e Tij.

Pse Muhamedi ﷺ ishte profeti i fundit?

Çështja e dërgimit të profetëve është e fshehur pas urtësisë, urtësisë së udhëzimit dhe orientimit. Librat e mëhershëm i kaplonte mangësia, shtrembërimi pas vdekjes së profetëve të tyre, urtësia e Allahut e kërkonte që ta dërgonte një profet me libër të cilit nuk i vihet pas mangësia e as shtrembërimi, madje Allahu e mori përsipër Vetë ruajtjen e tij deri në Ditën e Gjykimit. Kësisoj, mrekullia e Kuranit - i cili është libër i qartë dhe argument i ngritur për të gjithë krijesat - është e vazhdueshme, e kërkon logjika që Profeti Muhamed ﷺ të jetë profeti i fundit, vula e tyre.

Pse duhet ta duam të Dërguarin ﷺ?

Dashuria për të ﷺ është nga shtyllat e besimit, madje as besimi në Allahun nuk plotësohet vetëm se duke e dashur atë. Dashuria për të ﷺ është e lidhur ngushtë me dashurinë për Allahun e Madhëruar. Allahu i Madhëruar e ka përzgjedhur atë në mes të njerëzve për ta përcjellë këtë mesazh madhështor të Shpalljes. Me të vërtetë Allahu e ka zgjedhur njeriun me prejardhjen me të mirë, me moralin më të lartë, me fjalët dhe veprat më shembullore, pasi Ai i Lartësuar është më i Dituri për atë të cilit i është besuar kumtimi i Shpalljes. Përderisa Allahu e ka përzgjedhur atë në mes të gjithë njerëzve për këtë detyrë madhore, atëherë ne e kemi detyrë që ta veçojmë atë me dashuri në mes të gjithë njerëzve. Sepse ai i njoftoi njerëzit me Zotin e tyre, ishte profeti më i mirë i dërguar te populli i tij, profeti më i mëshirshëm me kujdesin e tij, aq sa nuk gjejmë dashamirësi më shumë pas Allahut sesa nga ai ﷺ për ne.⁽²¹⁵⁾ Ai i ka duruar të gjitha vështirësitë dhe mundimet në rrugën e thirrjes së njerëzve për në fenë e Allahut dhe në mirësi. Madje i ngushtohej gjoksi ﷺ kur nuk e besonte ndokush kur e thërriste që të shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit, duke ndjerë mëshirë e keqardhje për ta. Allahu i Lartësuar thotë: **“A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kuran)?”** (Kuran, 18:6) Prandaj ai ﷺ është njeriu më meritor që ta duam pas Allahut.



Pyetjet që kanë të bëjnë me besimin në Ditën e Gjykimit



? Çfarë është Dita e Gjykimit?

Ajo është dita në të cilën Allahu i ringjallë krijesat për t'u llogaritur. Quhet edhe si Dita e Fundit, pasi nuk ka ditë tjetër pas saj. Po ashtu quhet si dita Gjykimit apo Llogarisë, sepse Allahu i merr në llogari njerëzit në atë ditë për veprat të cilat i kanë bërë në këtë botë. Kësisoj, ai që ka bërë vepra të mira dhe i është bindur Allahut, atë e fut në Xhenet dhe e kundërta, ai që ka bërë vepra të këqija dhe nuk i është nënshtruar Allahut e fut në Xhehenem. Kjo ditë është dita në të cilën mbaron jeta e botës për të gjithë njerëzit. Gjithashtu, quhet edhe si Dita e Ngritjes, sepse është një nga kuptimet e saj, pasi njerëzit ringjallen dhe ngrihen nga varret e tyre për të dhënë llogari.⁽²¹⁶⁾

? Kur është Dita e Kiametit? Pse është fshehur ajo ditë nga ne?

Askush nuk e di se kur do të ndodhë Dita e Kiametit, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Të pyesin ty për Orën (e Kiametit) se kur do të ndodhë. Çfarë rëndësie ka për ty që ta përmendësh atë? Tek Zoti yt është fundi i (dijenisë rreth) saj. Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i frikësohen asaj.”** (Kuran, 79:42-45).

Allahu e ka fshehur prej nesh këtë ditë, në mënyrë që të përpiqemi të bëjmë vepra të mira e të jemi në gatishmëri për të në çdo ditë, duke bërë sa më shumë vepra të mira e duke u larguar nga të këqijat. Sikur ta dinte njeriu se kur do të ngjajë ajo ditë, nuk do të pendohej vetëm se pak kohë para saj, e kështu do mbushej kjo botë me çrregullime edhe më shumë.⁽²¹⁷⁾

Çfarë është llogaridhënia?

Llogaridhënia është ngjarja kur Allahu do t'i mbledhë të parët e të fundit, siç e përshkruan Allahu këtë ndodhi në librin e tij Famëllartë: **“Thuaju (o Muhamed): ‘Me siguri, edhe të parët, edhe të mbramët, do të tubohen në një ditë të caktuar’.”** (Kuran, 56:49-50). Pastaj ua shfaq atyre punët e tyre, i njofton ata për to dhe i shpërblen sipas veprave të tyre. Ai që ka bërë mirë atë do e korrë, edhe ai që ka bërë keq atë do ta gjejë. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”** (Kuran, 99:7-8).

Çfarë është vdekja?

Zakonisht fëmija në moshën gjashtë vjeçare e më poshtë nuk arrin ta kuptojë tërësisht se çfarë do të thotë vdekja dhe ringjallja, apo që vdekja është përfundimi i paevitueshëm për të gjithë njerëzit njëjloj. Kurse fëmija nga mosha gjashtë vjeçare deri në tetë, shumicën e rasteve mundet ta kuptojë se çfarë është vdekja dhe që do t'i ndodhë të gjithë njerëzit. Fëmija nga mosha tetë vjeçare deri në dhjetë, arrin përfundimisht ta kuptojë kuptimin e vdekjes dhe të gjithë ringjalljes. Ndodh që fëmija të kalojë mbi ndonjë sprovë të vdekjes së ndonjë familjari, kështu do të jetë hera e parë që do të përballet me këtë fenomen. Nuk e dimë se çfarë përjetime përjeton kur të dëgjojë për varrin apo vdekjen, por zakonisht do ta kaplojë frika nga këto çështje. Kësisoj, ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe të iniciojmë sqarimin e vërtetë të kuptimit të vdekjes, pa e gënjyer fare apo pa tentuar që ta bindim se personi i vdekur ka udhëtuar apo gjëra të ngjashme, pasi nuk do të kalojë shumë kohë dhe do ta kuptojë të vërtetën nga të tjerët.

Më së miri para se t'i tregojmë fëmijës për vdekjen e ndonjë familjari, është që fëmijën ta marrim për një shëtitje duke ia shfaqur ndonjë zog të ngordhur, apo ndonjë pemë të tharë, apo ndonjë insekt të ngordhur e kështu fëmijës i bëhet e qartë kuptimi i vdekjes në formë reale dhe arrin ta perceptojë përmes shqisave. Më pastaj provojmë t'ia shpjegojmë fëmijës me thjeshtësi që i vdekuri ka shkuar të jetojë në botën e ardhshme dhe ne që të gjithë kur të vijë koha do t'u bashkohemi të gjithë atyre që vdesin para nesh. Do të jetojmë me ata në Xhenet, me lejen e Allahut.

Është e rëndësishme, gjithashtu, që t'i sqarohet fëmijës se vdekja nuk do të thotë fundi i jetës përfundimisht, por ajo është fillimi i jetës së ardhshme kur njeriu besimtar kalon në një jetë më të mirë, ndërsa keqbërësi mohues kalon te një jetë e hidhur ku korrë të mbjellat e veprave të veta të këqija. Allahu kur të na bëjë që të vdesim, kjo nuk do të thotë që Ai nuk na do neve, por na bën që të vdesim që të jetojmë në botën e ardhshme afër Tij, në Xhenetet e mrekullueshme të cilat nuk mundemi assesi t'i paramendojmë sa të bukura që janë.⁽²¹⁸⁾

Atëherë pse vdesin disa fëmijë?

Fëmijët, në përgjithësi, nuk bëjnë vepra të këqija, nuk bëjnë gabime me qëllim. Kësisoj, Allahu i kaplon ata fëmijë që vdesin me mëshirë dhe i fut në Xhenet. Atëherë kur të vdesë njeriu i mirë dhe të tretet, shpirti i tij mbetet dhe ngrihet te Krijuesi i tij Madhështor. Më pas përkujtohet emri i tij për të mirë, i mbesin veprat e tij të mira në zemrat e njerëzve. Kështu që, njeriu duhet të përgatitet për takimin me Zotin e tij dhe të bëjë vepra të mira sa më shumë duke u përmbajtur mësimëve të fesë islame.⁽²¹⁹⁾

Ku do të shkojmë pasi të vdesim?

Kur të mbarojë koha, të cilën na e ka caktuar Allahu të qëndrojmë në këtë botë, do të zhvendosemi në varr, i cili është vendi i caktuar për të vdekurit. Varri shndërrohet në kopsht prej kopshteve të Xhenetit për besimtarin që e beson Zotin e tij, i bindet Atij dhe bën vepra të mira përgjatë jetës së tij në jetën e kësaj bote, e kështu do të jetë në begati në varr derisa të ndodhë Kiameti.⁽²²⁰⁾

A dëgjon apo shikon i vdekuri? Si mund të marrim frymë nën dhe? A ushqehet apo fle i vdekuri?

Po, i vdekuri e dëgjon *selamin* kur e përshëndesim me *esselamu alejkum*, i mbërrin atij lutja kur të lutemi për të. Mirëpo ai nuk merr frymë siç marrim ne, pasi ai nuk ka nevojë për frymëmarrje, sepse jeton në një botë tjetër, ndryshe prej jetës sonë në këtë botë. Rrjedhimisht, fillimi i botës së ardhshme është jeta e varrit, siç njihet me emrin *berzah*. Ajo ka natyrë dhe rregulla të tjera nga bota jonë e tanishme. Aty nuk ka frymëmarrje, e as ushqim e pije apo punë, por ka begati të vazhdueshme apo dënim të vazhdueshëm, Allahu na ruajttë prej tij!⁽²²¹⁾

Çfarë është Xheneti dhe çfarë ka në të?

Xheneti është shtëpia e shpëtimit, është vendi i bukur në të ke çdo gjë që dëshiron, çdo gjë që do. Në Xhenet shkojnë njerëzit e mirë të cilët bëjnë vepra të mira, i ka tetë porta, të cilat janë të shkallëzuara. Hyjnë besimtarët në to sipas veprave dhe mëshirës që u takon. Pronari i veprave të mira të shumta do të jetë në një vend më të bukur dhe me të lartë sesa ai që ka më pak vepra të mira, por që të gjithë do të jetojnë në kënaqësi, begati e hare. Në Xhenet do të jetojmë të lumtur nuk do të sëmuremi asnjëherë dhe as nuk do të na kaplojë lodhja, do ta shohim Allahun e Madhëruar, do t'i shohim profetët (*alejhimus-salatu ue selam*) dhe do t'i takojmë të gjithë ata që i duam, me lejen e Allahut të Lartësuar. Aty kemi çdo gjë që duam a dëshirojmë nga: pijet, ushqimet, kënaqësitë dhe begatitë.⁽²²²⁾

? Çfarë është Xhehenemi dhe pse e ka krijuar Allahu atë?

Xhehenemi është gremina e dënimit, është vendi të cilin Allahu e ka përgatitur për të gjithë ata që bëjnë vepra të këqija dhe i dëmtojnë njerëzit, i bëjnë gjynah Allahut e nuk i binden urdhrave të Tij.

? Po përfundimi i kafshëve si është? A shkojnë në Xhenet apo në Xhehenem?

Kafshët nuk janë të obliguara me bindje ndaj Allahut. Ato janë krijesa të nënshtruara të cilat i krijoi Allahu që t'i shërbejnë njeriut. Ato nuk kanë llogari e kështu as shpërblim e as dënim. Në Ditën e Gjykimit ringjallen të gjitha kafshët të cilat i marrin të drejtat e tyre nga njëra-tjetra. Kështu dashi pa njëren brinjë i goditur në jetën e kësaj bote, e merr hakun nga dashi me brinjë. Atëherë kur të përfundojë marrja e hakut të kafshët, Allahu u thotë të bëhen pluhur dhe kështu ato bëhen.⁽²²³⁾



Pyetjet që kanë të bëjnë me besimin në paracaktimin



? Çfarë do të thotë caktimi dhe paracaktimi?

Caktimi apo paracaktimi është shtyllë prej shtyllave të besimit. Allahu i Lartësuar thotë: **“Sunduesi i qiejve dhe i Tokës, i Cili nuk ka bir e nuk ka ortak në pushtet; i Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet!”** (Kuran, 25:2). Paracaktimi i Allahut do të thotë: Dituria e plotë e Allahut, të shkruarit e Tij, dëshira e Tij dhe të krijuarit e Tij.⁽²²⁴⁾

? Si ka mundësi që Allahu e di një gjë që do të ndodhë para se të ndodhë?

Mund t’i ilustrohet përgjigjja me një shembull mjaft të thjeshtë e të prekshëm. I themi fëmijës: ndërtuesi i lojës kompjuterike me të cilën luan, i di të gjitha mundësitë që mund t’i veprojë loja edhe para se t’i bëjë ato. Nuk është çudi, sepse tashmë ai e ka ndërtuar lojën dhe i ka caktuar çdo detyrë a lëvizje të vogël apo të madhe brenda kësaj loje. Pra ai, ndërtuesi, e di çdo cep apo anë të mundësive dhe hapësirës së kësaj loje, në të cilën mund të lëvizësh ti. Allahu i takon shembulli më i Lartë, Ai i Cili e ka krijuar njeriun është i Gjithëfuqishëm t’i bëjë këto gjëra. Allahu ka fuqinë më madhështore, ka diturinë më gjithëpërfshirëse dhe është Krijuesi i Përkryer. Dituria e Tij përfshin çdo gjë që ka krijuar para se ta krijonte dhe gjatë krijimit dhe pas krijimit të saj. Allahu është Ai që ka krijuar njeriun, kohën dhe vendin. Allahu di çfarë kishte dhe çfarë do të bëhet, si dhe di se çfarë është para se të ndodhë.





A jemi ne të detyruar? A ka njeriu liri dhe vullnet të zgjedhjes në veprimet e tij?

Ne jemi në disa veprime të detyruar dhe në disa tjera kemi lirinë e zgjedhjes së veprimit apo mosveprimit të tyre. Për shembull: e kemi të imponuar lindjen apo vdekjen, gjatësinë e jetës, jemi të detyruar e jo të lirë në zgjedhjen e prindërve, të detyruar në përkatësinë e farefisit, etj. Ndërsa në anën tjetër, jemi të lirë të zgjedhim a të falemi apo jo, të besojmë apo të mos besojmë. Me gjithë këtë liri të zgjedhjes që kemi, vullneti dhe dëshira jonë është nën dëshirën dhe vullnetin e Allahut. Me fjalë të tjera, sikur Allahu të donte që të na privojë nga liria e përzgjedhjes do mund ta bënte atë dhe sikur të donte të na pengonte nga lënia e veprës do mund ta bënte. Ai e ka caktuar që njeriu të ketë lirinë e zgjedhjes dhe do llogaritet pastaj për përzgjedhjen e tij. Ky pra, është edhe kuptimi i fjalës së Allahut të Lartësuar: **“Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve!”** (Kuran, 81:29).

Mund t’i shpjegohet në mënyrë praktike tematika e zgjedhjes së veprave apo të imponimit të tyre në këtë mënyrë: Edukatori e merr një gotë të kristalit, ia afron fëmijës dhe i thotë:

- A mund ta thyesh këtë gotë duke e hedhur në dysheme?
- Sigurisht që mundem, – do të përgjigjet fëmija.
- Atëherë çfarë të pengon që mos ta thyesh atë?
- Është gabim, nuk është e udhës të bëjmë dëm, – do të thotë fëmija.

Më pas edukatori do vazhdonte sqarimin: kësisoj pra, me të vërtetë Allahu e dinte në pafillimësi që ti nuk do ta thyjeje gotën, pasi ti je djalë i mirë/vajzë e mirë dhe e dinte gjithashtu që fëmija i keq do ta thyente gotën. A të pengoi ndokush që të mos e thyjeje gotën? Apo, a e detyroi fëmijën e keq ndokush ta thyente gotën? Kështu pra është udhëzimi dhe devijimi.

Pastaj krahas kësaj i thuhet se njeriu nuk e di se çfarë i ka caktuar Allahu atij, madje ti nuk je i kërkuar ta dish atë se çfarë është shkruar për ty. Sigurisht nga ty kërkohet të besosh diturinë gjithëpërfshirëse dhe të plotë të Allahut, e nga kjo dituri rrjedhë të shkruarit e caktimeve. Rrjedhimisht, ti je përgjegjës për zgjedhjet e tua dhe se sa i bindesh urdhrave të Allahut dhe sa largohesh nga të ndaluarat e Tij; gjithsesi sipas mundësive dhe zgjedhjeve tuaja.⁽²²⁵⁾



Pse Allahu i ka udhëzuar disa njerëz, ndërsa disa të tjerë jo?

Allahu i ka udhëzuar që të gjithë njerëzit, siç e dëshmon fjala e Tij: **“Dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?”** (Kuran, 90:10). Kuptimi i këtij udhëzimi është që Allahu e ka sqaruar dhe qartësuar rrugën e drejtë për njerëzit. Kështu që e vërteta është në shesh e qartë, po ashtu e kota është e qartë. Allahu i la njeriut mundësinë e përzgjedhjes, dikush zgjedh të saktën e dikush tjetër zgjedh rrugën e gabuar.⁽²²⁶⁾



Nëse Allahu e ka shkruar në pafillimësi që prej nesh do të ketë që gabojnë e do të devijojnë, atëherë pse na dënon?

Kjo dituri është dituri hyjnore, ndërsa njerëzit nuk kanë fare pjesë në të. Njerëzit nuk kanë gjë tjetër pos supozimeve dhe iluzioneve të kota. Njeriu do të llogaritet për punët e tij për gjatë jetesës së tij në këtë botë dhe nuk ka fare hapësirë për të që ta njohë të fshehtën të cilën ia ka shkruar Allahu. Caktimet e shkruara janë argument për të kaluarën dhe jo për të ardhmen. I thuhet gjithashtu fëmijës se pasi Allahu t’i ka shkruar çështjet e tua në këtë botë, atëherë pse i bën gjërat të cilat të sjellin dobi dhe i braktis ato që të dëmtojnë në jetën e kësaj bote?!

Mund t’i ilustron me një shembull tjetër gjithashtu, duke i thënë se nëse ndokush do dëshironte të udhëtonte për në një vend, ndërsa ky vend i ka dy rrugë, njëra prej tyre është e sigurt, kurse tjetra e rrezikshme, vallë, cilën rrugë do ta zgjedhë?! Normalisht, do ta zgjedhë rrugën e sigurt. Kësisoj i ngjan edhe rrugëtimi për në botën tjetër, njeriu e përzgjedh rrugën e sigurt që e shpie në Xhenet. Rrugë kjo që është të bindurit ndaj urdhrave të Allahut dhe të larguarit nga ndalesat e Tij. Sikur të ishte caktimi argument për t’u arsyetuar ndokush, nuk do të kishim mundësi t’i kapnim kriminelët, pasi ata vazhdimisht do të arsyetoheshin që veprat e tyre kanë qenë të caktuara të ndodhin.⁽²²⁷⁾ Prandaj, njeriu duhet t’i nënshtrohet dhe bindet Allahut të Lartësuar, sepse **“Allahu nuk mund të pyetet për atë që punon, kurse ata do të pyeten.”** (Kuran, 21:23).



Pse na ka krijuar Allahu? Ç’është esenca e kozmosit? Pse i ka krijuar Allahu kafshët?

Allahu i Madhëruar thotë: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Kuran, 51:56). Jemi krijuar për një qëllim që do të na bëjë dobi, që është të adhuroarit e Allahut të Lartësuar. Rezultatet do të jenë në botën tjetër sipas veprave tona. Xheneti do të jetë vendbanim për vepërmirët, ndërsa zjarri i Xhehenemit për vepërkëqijtë. Ky kozmos, e tërë gjithësia është krijesë e Allahut të Lartësuar, është krijuar me përpikëri e dituri. Allahu i ka krijuar qiejt e Tokën, i përhap planetët, i krijoj yjet si shenja orientimi, mrekulli e stoli të qiellit. E krijoj Diellin që të na ngrohë e nxehë, që të mundësojë mbirjen e bimëve

e zhdukjen e baktereve. I krijoi kafshët të nënshtuara për njeriun, i cili ushqehet nga to dhe i shfrytëzon për bartje, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“(Ai ka krijuar) edhe kuajt, mushkat dhe gomarët, që ju t’i shaloni dhe t’i mbani për bukuri. Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini.”** (Kuran, 16:8).

Pra, përgatitja e tokës për të banuar njerëzit në të dhe krijimi i gjërave para se të krijohej njeriu, është nga ana e nderimit të cilin e ka veçuar Allahu për njeriun. Shtuar kësaj, të gjitha këto gjëra e lavdërojnë dhe madhërojnë me falënderim Allahun e Lartësuar; pra në vetvete janë në adhurim ndaj Allahut, siç thotë i Lartësuari: **“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.”** (Kuran, 17:44).⁽²²⁸⁾



A do t’i marrë Allahu në llogari ata të cilëve nuk iu dërgua ndonjë profet?

Ata do të vihen përballë provimit dhe llogarisë, e kështu do t’i sprovovë Allahu në Ditën e Gjykimit duke i urdhëruar që t’i binden Atij, nëse do t’i përgjigjen dhe binden Allahut, do të hyjnë në Xhenet dhe në të kundërtën nëse rebelohen e nuk binden do të hyjnë në Xhehenem.



Pse ekziston e keqja?

Kjo botë është vendbanim i sprovave, mund të themi që i ngjan kapitullit të parë të një romani, ndërsa kapitulli i dytë dhe i fundit është bota e ardhshme e cila është vend i korrijeve të shpërblimeve apo dënimeve pas llogarisë, gjithashtu, dhe marrje e shpagimit të atyre që u është bërë zullum prej zullumqarëve. Kështu që, ekzistimi i së keqes dhe mosdënimi i zullumqarëve në këtë botë është sprovë, që assesi nuk do të thotë se ka mbaruar çështja me kaq. Përkundrazi, patjetër që çdokush në Ditën e Gjykimit do të llogaritet e do të marrë shpërblimin apo dënimin e merituar për veprat e tij; siç e thotë Allahu: **“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”** (Kuran, 99:7-8).⁽²²⁹⁾



Pse i ka krijuar Allahu të këqijtë?

Allahu i ka krijuar njerëzit dhe u ka dhënë atyre lirinë dhe vullnetin e zgjedhjes së veprave të mira qofshin ato apo të këqijave. Pra, ti mund të jesh i sjellshëm

apo mund të zgjedhësh të jesh jo i tillë, por doemos do të marrësh përgjegjësi për rezultatet e zgjedhjeve të tua. Kjo është begati nga Allahu dhe urtësi. Të këqijtë mund të bëhen të mirë dhe roli ynë është që t'i ndihmojnë ata të bëhen të tillë, kurse nëse refuzojnë të bëhen të mirë dhe këmbëngulin në të keqen, atëherë detyra jonë është t'i mbrojmë njerëzit nga e keqja e tyre, në mënyrë që të na dojë ne Allahu i Lartësuar dhe të na shpërblejë. Allahu i Lartësuar është Krijuesi i çdo gjëje në këtë botë dhe kjo botë është vend i sprovave dhe provimit. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”** (Kuran, 67:2). Nga sprovat është edhe ekzistenca e së keqes mes shejtanëve dhe të shprishurve nga njerëzit.⁽²³⁰⁾



Pse lindin disa njerëz me të meta fizike?

Ata njerëz i sprovon Allahu me mungesa e sëmundje që të bëjnë durim që t'u shtohen veprat e mira dhe që të na i kujtojë Allahu begatitë me të cilat na ka furnizuar, pasi shumicën prej nesh i ka krijuar të shëndoshë, që ta falënderojmë Atë për këtë. Gjithashtu, të na e kujtojë dobësinë tonë përballë fuqisë madhështore të Allahut, në mënyrë që të mos tregohemi mendjemëdhenj, por të jemi modestë e kokulur duke ndihmuar njëri-tjetrin. Pas Ditës së Llogarisë ata që ishin me të meta fizike do të jetojnë vazhdimisht me shëndet të plotë në Xhenetet e bukura me lejen e Allahut.⁽²³¹⁾



Pse kemi ndarje mes të pasurit dhe të varfrit? Pse disa të këqij jetojnë në kështjella e disa të mirë në kasolle?

Çdo furnizim që ndodhet në këtë botë është nga furnizimi i Allahut të Lartësuar. Allahu i sprovon robërit e Tij, nganjëherë njeriun e mirë e furnizon që ta sprovojë dhënien e tij te të tjerët. Nganjëherë e privon ndokënd nga furnizimi që t'i sprovojë atij durimin dhe durueshmërinë e tij të mos vjedhë apo armiqësojë. Sado që të jetojë njeriu i mirë në këtë botë të përkohshme si durimtar, do t'i rritet atij shpërblimi në Ditën e Gjykimit.

Atij njeriu që i është shtuar furnizimi me bollëk, ndërsa të tjerët nuk kanë pjesë në pasurinë e tij, madje u bën dëm atyre, pa dyshim që Ai do dënohet në Ditën e Kiametit, pasi ai nuk i vlerësoi begatitë e Allahut.

Mund t'i themi fëmijës, gjithashtu, se Allahu i ka krijuar njerëzit në shkallë të ndryshme, prej tyre ka të varfër e prej tyre ka të pasur. Kjo, në mënyrë të atillë, që i pasuri të jetë i ndjeshëm dhe ta mirëkuptoj të varfrin, e kështu ta ndihmojë atë. Nga urtësia e Allahut është që njerëzit të dallojnë në çdo gjë, ashtu që gjuhët e tyre janë të ndryshme, ngjyra apo raca të shumta, punëtorë a dembelë, bujarë a koprracë, egoistë a altruistë. Dallojnë në pasurinë e tyre materiale, prej tyre ka të pasur e prej tyre të varfër, e gjithsecili prej tyre është nën sprovë, pasuria është



sprovë e po ashtu varfëria është sprovë. I pasuri sprovohet se a do të shpenzojë për të varfrit? A do të nxjerrë *zekatin*? A do të jetë bujar? A do të japë lëmoshë e sadaka? E në anën tjetër edhe i varfri sprovohet, a do të bëjë sabër? A do të punojë? A do të kërkojë furnizimin nëpër tokë? Apo do të zптоjë pasuri pa të drejtë? A do të vjedhë? Të gjithë janë në sprovë, por e garantuara për të dy palët është që furnizimi është nga Allahu i Lartësuar dhe se pasuria apo varfëria nuk i privon ata nga hyrja në Xhenet apo në Xhehenem. Të gjithë janë të ngarkuar varësisht prej asaj që posedojnë. Sikur të ishin të gjithë njerëzit të së njëjtës shtresë, të themi të pasur, nuk do t'i shërbenin njëri-tjetrit e as nuk do të kishin nevojë për njëri-tjetrin. Allahu i Lartësuar thotë: **“Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t’u shërbejnë të tjerëve.”** (Kuran, 43:32). D.m.th.: t’i shërbejnë njëri-tjetrit e kështu të vazhdojë cikli i jetës, pasi sikur të ishte vetëm një shtresë, edhe jeta do ngecte.⁽²³²⁾



Pse sëmuremi? Pse njeriun e godasin sprovat?

Allahu e sprovon çdo njeri, a do të jetë durimtar kur të sëmuret apo do të zemërohet? Allahu me të vërtetë e shpërblen atë që tregon durim me një shpërblim të hatashëm, me të cilin besimtari do të gëzohet shumë Ditën e Gjykimit. Sprovat, sëmundjet, fatkeqësitë, dhimbjet janë caktime të cilat i ka caktuar Allahu për t’u ngritur shkallët besimtarëve, që t’i pastrojë zemrat tona dhe moralin tonë nga mendjemadhësia, vetëpëlqimi e mburrja. Përgjatë këtyre peripecive besimtari afrohet te Zoti i tij me lutje e durim, e kështu i rritet besimi dhe i shtohen veprat e tij të mira, ku do ta dojë Zoti i Tij; po ashtu që njeriu t’ia dijë vlerën e mirëqenies, shëndetit e begative.

Mund t'i përafrohet fëmijës kjo temë me një shembull si vetura, bie fjala. E pyesim fëmijën se pse është prodhuar vetura? Që të lëvizë, apo jo? Atëherë çfarë të themi kur kompania prodhuese ia shton veturës frenat? A nuk bie në kundërshtim roli i saj i lëvizjes me frenat ndaluese të lëvizjes? Sigurisht që përdorimi i frenave është i domosdoshëm për sigurinë e veturës, gjersa makina është prodhuar që të lëvizë, por frenat janë ato që e ndalin atë në kohë të caktuar, që vozitësi i saj të mos dëmtohet. Ashtu siç Allahu i Lartësuar na ka krijuar që të na bëjë të lumtur me adhurimin e Tij dhe begatitë e Tij ndaj nesh, po ashtu i ka krijuar Allahu sprovat që t'ia përkujtojnë njeriut të shkujdesur detyrën madhështore për të cilën është krijuar, e kështu të zgjohet nga shkujdesja e hutia, ta kujtojë Zotin e tij, të bëjë durim e të shpresojë shpërblimin e Tij.⁽²³³⁾



A është Allahu Ai i cili i ka krijuar kafshët dhe insektet dëmtuese?

Allahu është Krijuesi i çdo gjëje, është Zoti i çdo gjëje, Ai siç i ka krijuar këto krijesa me fuqinë e Tij madhështore, po ashtu i ka krijuar ato sipas urtësisë së Tij të Plotë. Pasi Ai është Më i Urti, i Gjithëdituri, i Cili i di çështjet e tyre, ndryshe nga ne që nuk i dimë, sepse dituritë dhe njohuritë tona janë të cekëta në krahasim me diturinë dhe urtësinë e Allahut të Lartësuar. Ai thotë në Kuran: **“Ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”** (Kuran, 17:85). Pra, ne nuk mund t'i dimë të gjitha urtësitë për të cilat i ka krijuar Allahu këto kafshë, gjersa mund të theksojmë që nga urtësitë e krijimit të këtyre krijesave është nxjerrja në pah e përsosurisë së krijimit të Allahut në krijimtarinë dhe kujdesin e Tij për krijesat e Tij. Me gjithë numrin e shumë të këtyre krijesave, Ai që të gjitha i furnizon.



Gjithashtu, Ai i Madhëruari i sprovon disa me to dhe i shpërblen disa të cilët janë goditur nga to dhe trimëria e njeriut shfaqet kur t'i mbysë ato. Po ashtu, shfaqet dobësia e njeriut dhe paaftësia e tij në dhimbjet apo sëmundjen e tij, si pasojë e një krijese shumë më të vogël se ai. Pastaj kemi shfaqjen e mjekësisë dhe përvojës. Sa prej barërave shëruese janë nxjerrë nga helmet e gjarpinjve apo të llojit të tyre! Po ashtu, gjarpërinjtë i hanë minjtë të cilët i dëmtojnë të korrurat nga të mbjellat bujqësore. Pastaj shumë nga këto kafshë dëmtuese janë ushqim për kafshë të tjera dobiprurëse. E gjitha kjo formon një unazë të baraspeshuar të ekzistencës në natyrë, të cilën Allahu e ka caktuar për krijesat e Tij. ⁽²³⁴⁾

Pse duhet të falemi pesë herë brenda ditës e natës?

Adhurimet të cilat i ka bërë Allahu obligim për ne, në të vërtetë janë mjete për fisnikërimin e shpirtit të besimtarit, ngritjes së tij drejt piedestaleve të larta. Por, sa pak që punohet në këtë drejtim në përfitimin e mirësive të fshehura pas saj! ⁽²³⁵⁾ Përderisa *namazi* përfshin leximin e Kuranit, lutjen dhe *dhikrin*, e që është përmbledhës i pjesëzave të adhurimeve në mënyrën më të përkryer, atëherë namazi është më i mirë se sa leximi i Kuranit, dhikrit apo lutjes të bëra ndaras. Në namaz janë përfshirë që të gjithë llojet e adhurimeve në një trup të vetëm. ⁽²³⁶⁾



Besimtarët me të vërtetë gëzohen me namazin, sepse në të e lusin Allahun për çdo gjë që duan dhe Ai u përgjigjet atyre. Ne falemi, pasi Allahu e ka bërë detyrë e obligim për ne, kurse ne çdoherë duam që të bëjmë atë që Allahu na ka urdhëruar. Ne e adhurojmë Allahun, sepse Ai është Krijuesi dhe Furnizuesi ynë. Vetëm Ai Meriton të adhurohet prej sa e sa të mirave të shumta na i ka dhënë, të cilat nuk numërohen e as përthekohen. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato. Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Kuran, 16:18). Adhurimi i namazit, në të vërtetë, është shprehje e dashurisë dhe falënderimit tonë për Allahun ﷻ dhe pranimi i nevojës sonë për Të, që të na e ruajë mirëqenien, e të na japë sukses e ndihmë drejt mirësive, e t’i largojë të këqijat nga ne. Pa dyshim që Allahu nuk ka nevojë për adhurimin tonë, pasi Ai nuk ka nevojë për asgjë, as për veprat tona, as për ne dhe as që i hyjnë në dobi Atij.

Pra, adhurimet janë urdhra nga Allahu, i Cili kërkoi nga ne ta adhurojmë Atë ashtu siç na mësoi i Dërguari i Tij, Muhamedi ﷺ. Ky pra është edhe kuptimi i dëshmisë, *shهادetit*, që d.m.th.: e adhurojmë Allahun sipas metodikës së të Dërguarit të Tij ﷺ. Po ashtu, këto adhurime janë mjet për arritjen e shpërblimeve madhështore të cilat janë shkaqe për hyrjen tonë në Xhenet. Nga urtësia e caktuar e Allahut është që njerëzit t'i shpërblejë sipas veprave të tyre. Rrjedhimisht, Xheneti është malli i Allahut, që është shumë i shtrenjtë dhe çmimi i tij është bindja jonë ndaj Allahut të Lartësuar.⁽²³⁷⁾



E kam lutur Allahun në namaz që të rritem me shpejtësi, ndërsa Allahu nuk më është përgjigjur në lutjen time?

Lutja ka norma dhe edukatë që duhet t'i marrim në konsideratë. Nga edukata e lutjes është që të respektohen ligjet dhe rregullat, të cilat i ka vënë Allahu i Lartësuar që kjo botë të funksionojë. Ne e lusim Allahun, kurse Ai i Lartësuar bën më të mirën për atë që zgjedh për ne. Ju mund të kërkonit nga prindërit tuaj që të luani me biçikletën tuaj në rrugën e caktuar për makinat, ndërsa ai do të refuzojë prerazi, pasi ai ty ta do të mirën dhe e di që mospërgjigjja e tij në kërkesën tënde është, në të vërtetë, për të mirën tënde. Nga bujaria e skajshme e Allahut të Lartësuar është që lutjet tona i kanë tri gjendje: *e para*, të na përgjigjet Allahu dhe të na i plotësojë lutjet tona; *e dyta*, të na e largojë Allahu me lutjen tonë ndonjë sprovë a fatkeqësi që mund të na ndodhte; dhe *e treta*, e ruan Allahu lutjen tonë për Ditën e Gjykimit, që të na e plotësojë me diçka më të mirë në Xhenet.⁽²³⁸⁾



Pse nuk jam e bukur siç është shoqja ime?

Sepse Allahu e ka krijuar çdokënd në mënyrë të veçantë që dallon prej njëri-tjetrit. Çdo krijim i Allahut është i bukur, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.”** (Kuran, 95:4). Çdo njeri është i veçantë në krijimin e tij të posaçëm, atë që e ka krijuar Allahu shumë të bukur duhet ta falënderojë Allahun më shumë, kurse ajo që nuk e ka atë bukuri, duhet të jetë e kënaqur dhe ta pranojë atë. Ai që falënderon dhe bën durim ka shpërblime të mëdha te Zoti i tij.⁽²³⁹⁾



Nëse Allahu na do, atëherë pse na ndodhin fatkeqësi?

Allahu na sprovon ne, që të dallohet i miri nga i keqi. Mund ta sprovojë Allahu njeriun në mënyrë që të kthehet tek Ai e të jetë afër Tij vazhdimisht. Sprovat janë provime të cilat i sprovon Allahu të dashurit e Tij. Që t'i fisnikërojë dhe pastrojë, t'u lartësojë atyre shkallët e gjithashtu që të jenë shëmbëlltyrë për të tjerët, në mënyrë që të bëjnë durim e t'i pasojnë ata. Për këtë ka thënë Profeti ﷺ: *"Njerëzit më të sprovuar janë profetët, pastaj të tjerët pas tyre."*⁽²⁴⁰⁾ Kësisoj, njeriu sprovohet varësisht nga besimi i tij. Nëse në fenë e tij ka qëndrueshmëri e fortësi, atëherë sprovat për të do të jenë më të mëdha. Për këtë Allahu i ka sprovuar profetët me sprova marramendëse, prej tyre ka që u vranë, prej tyre u dëmtuan, prej tyre kishin sëmundje të rënda që u stërzgjatën, siç kemi shembullin e Ejubit (*alejhis-selam*). Edhe Profeti ynë ﷺ është lënduar e dëmtuar shumë në Mekë dhe Medine, megjithatë përkundër kësaj, ai bëri durim ﷺ. Pra, sprovat bien mbi besimtarët varësisht nga besimi i tyre i lartë apo devotshmëria e tyre e qëndrueshme.⁽²⁴¹⁾ Gjithashtu, duhet theksuar te fëmija një çështje e ajo është që Allahu bën çfarëdo që Ai do, gjykon siç dëshiron, Allahu nuk pyetet, por Ai i pyet të tjerët, sepse Ai është Gjykatësi më i Drejtë.



Këto ishin pyetjet më të shpeshta. Do të gëzoheshim shumë nëse na kontaktoni në adresën elektronike për pyetje të tjera të reja, apo për propozimin e ndonjë tjetër modeli përgjigjesh.

Abdullah ibn Hamed er Rekaf

E-mail: jrakaf@gmail.com

Epilog

Së fundi, disa porosi të cilat i shoh si shumë të rëndësishme për fushën e edukimit:

- Duhet bërë përpjekje të shumta për shtimin e njohurive të prindërve, pasi ata janë bërthama esenciale për nxjerrjen e një gjenerate premtuese të edukuar e të formuar në mënyrë të shëndoshë. Kjo mund të bëhet përmes seminareve dhe ligjëratave të shpeshta.
- Organizimi dhe përgatitja e programeve të mediave si dhe prodhimi i filmave të animuar, që kanë karakter islam të një cilësie të lartë, që sfidon botën e teknologjisë moderne, përmes artit të regjisë, që të ngjallë interesim për t'u shikuar.
- Nxitja e mbajtjes së seminareve dhe kërkimeve shkencore në fushën e programeve të mediave që kanë synim fëmijën, me qëllim që të ndihmojë në arritjen e produkteve tona të veçanta që përshkojnë me identitetin tonë dhe, në të njëjtën kohë, japin një model alternativ zbavitës.⁽²⁴²⁾
- Vazhdon ende të jetë e varfër dhe e dobët prodhimtaria jonë kulturore për fëmijë. Shumica e gjërave që kemi janë vetëm përkthime që përmbajnë kontekste e kultura të ndryshme. Kësisoj, duhet shtuar përpjekjet për mbushjen e kësaj zbrazëtie në bibliotekat tona.
- Përgatitja e programeve praktike për fëmijë në fushën e edukimit të besimit. Gjithashtu, trajnimi i edukatorëve dhe këshilltarëve, posaçërisht në këtë fushë, në atë mënyrë që të jenë orientimet për edukatorët e këshilltarët drejtuar niveleve të ndryshme të edukatës apo njohurive të fëmijëve, duke marrë parasysh dhe dallimin e moshave.
- Zhvillimi i programeve zyrtare mësimore, në mënyrë që të përmbajnë përbërës edukativë e njohuri, të cilat japin përgjigje për pyetjet bashkëkohore të fëmijëve rreth besimit, përgjigje që përkojnë me kohën dhe janë të kënaqshme e bindëse.



Fusnotat

- (1) Shënon Buhariu (2558) dhe Muslimi (1829).
- (2) Shënon Muslimi (1631) nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti ﷺ ka thënë: “Kur të vdesë njeriu i ndërpritet puna, përjashtim bën ai që ka lënë lëmoshë rrjedhëse: dituri që përfitohet prej saj ose një fëmijë të mirë i cili lutet për të.”
- (3) Shiko: “Tejsir el Kerim er Rrahman fi tefsir kelam el Menan” të Abdurrahman es-Sa’dit, f. 166.
- (4) Shiko: “El Usretu ue devruhe fi tenmijetil-kajim el ixhtime’ajeh lede et tiftl fi merhaletit-tufuleh el mute’hirah” të El-Hasen el-Iziz, punim diplome i gradës së masterit në shkencën e Psikologjisë Sociale, Universiteti Tazivezu, Algjeri, f. 22.
- (5) Shiko: “Ed daveh meherat ue funun” të Shehata Sakër, f. 271.
- (6) Shiko: “Et-Terbijetu el Islamiye – Usuluha ue menhexhuha ue mualimiha,” Atif es-Sejjid, f. 13; si dhe: “Et Terbijetu el islamiye el mustalah uel mefhum” Salih Ebu Arrad, f. 27.
- (7) Shiko: “Edukimi profetik,” Dr. Muhamed ed-Dujejsh, f. 10.
- (8) “Gars usul el-iman fi nefsi et-tiftl,” Dr. Sherife el-Hazimij, f. 5.
- (9) “Gars usul el-iman fi nefsi et-tiftl,” Dr. Sherife el-Hazimij, f. 21.
- (10) “El-Kavaid el-Ashr (“Ehemul-Kavaid fi terbijeti el-ebna,”) Dr. Abdulkerim Bekkar, f. 21-23.
- (11) Shënon Buhariu (2558); Muslimi (1829).
- (12) Shënon Buhariu (7150).
- (13) “Shu’ab el-Iman,” e Bejhakiut.
- (14) Shënon Tirmidhiu (1951); Albani e ka vlerësuar të dobët në “es-Silsiletu ed-Daife” (1887).
- (15) Shënon Tirmidhiu (1952); Albani e ka vlerësuar të dobët në “es-Silsiletu ed-Daife” (1121).
- (16) “El kavaid el ashr” (Ehem el Kavaid fi terbijetil ebna), Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 17, 56, 57.
- (17) Shiko: “Thekafetu el murabij,” Vedah ibn Hadi, f. 54.
- (18) Shiko: “Ed-Davetu meherat ue funun,” Shehata Sakër, f. 241.
- (19) Shënon Tirmidhiu (2516); Albani e ka cilësuar si të saktë.

-
- (20) Shiko: “Hadithi “Ihfadhi-Ilahe jahfedhk - Diraseh Akadije” Dr. Muhamed el-Alij, f. 6.
- (21) “Tuhfetul mevdud” Ibn Kajjim, f. 229.
- (22) “Daruratu ta’lim el-akideh lin-nashi’eh,” Bender er-Rrabah, faqja “Sajdu el-fevaid;” Shiko gjithashtu: “Meshru el-ibn el-mubdi,” Rida el-Masrij, f. 4; si dhe “El-huda en-nebevij fi terbijet el-evlad,” Dr. Said el-Kahtani, f. 6; si dhe “Terbijetu esh-shebab - el-ahdaf ue el-vesail,” Dr. Muhamed ed-Duvejsh, f. 20.
- (23) Shiko: “Thekafetu el-murabij,” Vedah ibn Hadi, f. 7.
- (24) Shënon imam Ahmedi në Musned (8939); shejh Albani e ka cilësuar si të saktë.
- (25) E shënon Buhariu, nr. 6026.
- (26) E shënon Buhariu, nr. 6011.
- (27) Shiko: “Ahdaf etterbije el-islamije ue mekasiduha,” Muhamed Ali Xhabiri, (alukah.net) me datë 16.11.1427.
- (28) Shiko: “Nadharatun fi etterbije el-imanije,” Mexhdi el-Hilali, f. 11.
- (29) E shënon Muslimi, nr. 2722.
- (30) Për ta kuptuar më mirë efektin negativ të mungesës së nocionit të ibadetit (adhurimit) në metodat bashkëkohore të edukimit, shiko: “Felsefetu et terbijeh el Islamijeh” Dr. Mexhid el-Kejlani, f. 95.
- (31) E shënon Ebu Davudi, 1522, Albani e vlerëson të saktë.
- (32) E shënon Ahmedi, 8939; Albani e ka vlerësuar të saktë në “Sahih el-xhami,” 2349.
- (33) E shënon Tirmidhiu, 2018.
- (34) “Hamsetu usus imanije fi terbijetil ebna” Dr. Halid Ravsha, portali “almoslim.net,” i datës 09.01.1432 h.; Pastaj shiko edhe “Menhexh et-terbije en-nebevije lit-tifl,” Muhamed Suvejd, f. 250, 284, 352; Pastaj “En-Nebij el-Murabbij,” Dr. Ahmed el-Esmer, f. 106, 249, 305.
- (35) E shënon Buhariu (3371).
- (36) E shënon Buhariu (1358).
- (37) E shënon Buhariu (5376); dhe Muslimi (2022).
- (38) E shënon Tirmidhiu (2516).
- (39) E shënon Ebu Davudi (1425), Albani e ka vlerësuar të saktë.
- (40) E shënon Tirmidhiu (2698), Albani e ka vlerësuar të mirë (hasen).

- (41) E shënon Ibn Maxhe (61), Albani e ka vlerësuar të saktë.
- (42) Sijeru el-A'lam en-Nubela (2/305).
- (43) Musanefi i Abdurrezakut (7977).
- (44) Shiko: "Daruratu ta'lim el-akideh lin-nashi'eh," Bender er-Rrabah, portal i "Sajdul-fevaid;" Shih gjithashtu: "Terbijetu el-Evlad fil-Islam," Abdullah el-Ulvan, 1/151.
- (45) "Menhexh el-Islam fi terbijeti akideti en-nashi," Muhamed Hajrun Fatima, f. 201.
- (46) E shënon Buhariu (1359).
- (47) "Tetavur esh-shu'ur ed-dinij leda el-atfal uel-murahikin," Prof. Dr. Muhamed el-Hatib, f. 4.
- (48) "Ihja'u ulum ed-din" të Gazaliut, vëll. I, f. 94.
- (49) "Ihja'u ulum ed-din" të Gazaliut, vëll. III, f. 72.
- (50) Shiko: "Et-tib er-ruhanij" të Ibn el Xhevzij, f. 60.
- (51) "El Murebun ue teseulat el atëfel" të Nevel el Halifeh, f. 29-30.
- (52) "Tetavur esh-shu'ur ed-dinij led el-atfal ue el-murahikin" të prof. dr. Muhamed el Hatib, f. 6.
- (53) Shiko: "Terbijetu et-tifl fil-islam" të Sijma Ebu Rumuz, f. 48; dhe shiko: "Devr ul-enshitah gajrus-safijeh fi tenmijeh hubin nebij ﷺ lede telmidhat el-merhalet il-ibtidaijeh" të Fevzijeh el-Bakmij, f. 76.
- (54) "Et-tarik ila el-abkarijeh" të Mikdad Jelxhun, f. 39; dhe shiko: "Tetavur esh-shu'ur ed-dinij led el-atfal ue el-murahikin" të prof. dr. Muhamed el Hatib, f. 4.
- (55) "El-kauvl es-sedid sherh kitabut-teuhid" të Abdurrahman es-Sa'dij, f. 128.
- (56) "Et-terbijeh el-akad'ijeh" të Muhamed Haxhë el-Xhezairij, meuvki'u fi tarikil-islam.
- (57) "Et-tarik ila el-abkarijeh" të Mikdad Jelxhun, f. 67-68.
- (58) Shiko: "Nadharatun fi et-terbijetil-imaniyeh" të Mexhdij el Hilelij, f. 16.
- (59) Shiko: "Menhexh et-terbijeh en-nebevijeh lit-tifl", të Muhamed Suvejd, f. 203 e më tej.
- (60) Sa i përket çështjes së adhurimit, mund të përfiton nga libri: "Melemih es-se'adeh fi terbijeti-tifl al'a el-i'bedeh", të Abdulmexhid el Bejnunij, dhe po ashtu shiko kaptinën: "el-bina'ul-i'bedij" nga libri: "Menhexh et-terbijeh en-nebevijeh lit-tifl", të Muhamed Suvejd, f. 250.

- (61) Shiko: “Et-terbijeh el-akad’ijeh” të Muhamed Haxhë el-Xhezairij, meuvki’u fi tarikil-islam; gjithashtu “Era’u Ibn el Xhevzij et-Terbevijeh”, dr. Lejli Atar, f. 324-337.
- (62) Moshë e pjekurisë të fëmijët dallon nga fëmija në fëmijë, disa e arrijnë në moshën pesë vjeçare, ndërsa shumica e arrijnë në moshën shtatë vjeçare. Si rregull, për kuptimin e moshës së pjekurisë të fëmijët, është aftësia e fëmijës që të bëjë dallimin mes dobisë dhe dëmit, si dhe të kuptuarit dhe të arsytuarit e tij se çfarë i thuhet. Ndërsa, dijetarët e fushës së edukimit e theksojnë që koha parashkollore është nga etapat më të rëndësishme për përfortimin e vlerave të larta të fëmija. Shiko: “El-usretu ue devruhe fi tenmijetil-kajim el-ixhtimaijeh lede et-tifl fi merhaletit-tufuleh el-mutehirah”, të El Husejn I’zij, f. 17.
- (63) Mund të përfitohet nga libri i dhikreve të njohur si “Mburoja e muslimanit” nga autori Se’id el Kahtanij dhe nga libri: “Edhker et-tifl el-muslim”, të Mahmud el Misrij.
- (64) Shiko: “Et Terbeijetu el Aka’idejeh” të Dr. Muhamed Haxh el Xhezairij, portali <http://islamway.com>; po ashtu shih: “et Terbijetu ed dinijeh lil atfel” të Havle Dervish, ueb-faqja: <http://saaid.net>; po ashtu shih: “Atfal el muslimin kejfe rabe’hum en nebijul emin” të Xhemel Abdurrahman, f. 40.
- (65) Shiko: “Et Terbeijetu el Aka’idejeh” të Dr. Muhamed Haxh el Xhezairij, portali <http://islamway.com>; po ashtu shiko: “Muhtesar es Savaik el Mureseleh” të Ibn Kajimit, f. 226, kur flet bukur rreth urtësisë së Allahut në krijesat e tij. Gjithashtu, mund të përfitohet nga libri: “Axha’ib halki-Lah” të Omer el Eshkar.
- (66) “Gars usul el Iman fi nefis et tifl” të Dr. Sherifeh el Hazimij, f. 65 dhe 69.
- (67) Shiko: “Menhexh et Terbijeh en Nebevijeh lit tifl”, Muhamed Suvejid, f. 379.
- (68) Shiko: “Fëmija lexon” të prof. dr. Abdulkërim Bekkar, f. 61. Profesori i ka cekur hapat praktikë rreth artit të rrëfimit të tregimeve fëmijëve. (Vërejtje! Libri është i botuar në gjuhën shqipe nga sh.b. “Fjala e bukur”);
- Mund të përfitohet gjithashtu nga libri “Eadham insan arafet’hu el beshirje” Hisham Bergesh (f. 143); po ashtu shiko: “Kejfe nezrau hub el habib ﷺ fin neshi’e” të Emine Derauv, f. 33-36. Gjithashtu shiko: “Hamsun mevkifen lin Nebij ﷺ me’as sigar”, të Dr. Ibrahim el Vedan. Mund të përfitohet gjithashtu nga libri: “Rixhel ue nisa havler Resul lil atfal” të Sejid Mubarak.
- (69) Shiko: “El Bina en Nefsi el Vixhdenij lit tifel”, dr. Salah Abdurrezak, f. 9.
- (70) Shiko: “Et Terbijetu ed Dinijeh lil atefel” Havle Dervish, dhe portali: <http://saaid.net>; Shiko po ashtu: “Kejfe uxhib an es’ileti tiflij ue uhaviruhu” të Dr. Selve Murteda, f. 108.

- (71) Shiko: “El Irtika bil Usre fi te’adhim mehabetin Nebij el Umeh ﷺ”, f. 5.
- (72) Mund të përfitohet nga libri: “Minhexh et tifël el muslim” të Mahmud el Misrij, dhe nga “Ehadith lil atëfel - lil hadaneh uel mualimin uel murabin”. Po ashtu nga: “Sherh ashere ehadith lil atfael” që të dyja të publikuara në ueb-faqen: alukah.net; po ashtu librin “Menhexh et terbiye en nebevije lit tifi” Muhamed Suvejid, f. 418.
- (73) Shiko: “Kejfe tu’alim el akideh lil atëfel” Heja es Sani’u, portali: <http://saaid.net>; shiko: “Atëfel el muslimin kejfe rabehum en nebijul emin” të Xhemal Abdurrahman, f. 143.
- (74) Shiko: “Kavaid fi telaki el masa’ib” të Omer el Mukbil, ueb-faqja e Prof. Dr. Omer el Mukbil me datë 3/12/2014; shiko: “Hal el Insan aind hulul el musibeh” të Dhafir Al Xheban, portali: <http://saaid.net>.
- (75) Shënon Ebu Davudi (4991), ndërsa Albani e cilëson si të mirë.
- (76) Shënon Ahmedi (9624), ndërsa Albani e cilëson si të mirë.
- (77) Shih: “Devrul bejt fi terbijetit tifël el muslim” Halid esh Shentut, f. 30; shiko: “Menhexh et Terbiye en Nebeëije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 90; shiko: “Es Suneh en Nebevijeh - ru’je terbevijeh”, Dr. Said Alij, f. 356; shiko: “Asalib er Resul ﷺ fi terbijetil usreh el muslimeh” Shafi el Hamidij, f. 3; shiko: “Terbijetush Shebab - el Ahadaf uel Vesail” dr. Muhamed ed Duvejsh, f. 30; shiko: “Hamsune mevkifen lin Nebij ﷺ me’as sigar” Dr. Ibrahim el Ved’an, f. 9.
- (78) Shiko: “Es Suneh en Nebevijeh - Ru’je terbevijeh” Dr. Said Ali, f. 370. Mund të përfitohet gjithashtu nga libri “Meva’idh es Sahabeh” të Dr. Omer el Mukbil.
- (79) Shiko: “Eselib er Resul ﷺ fi terbijetil usreti el muslim” Shafi el Hamidij, f. 21; shiko: “Devr el bejt fi terbijetit tifël el muslim” Halid esh Shentut, f. 25, shiko: “Eselib er Resul ﷺ fi terbijetil usreti el muslim” Shafi el Hamidij, f. 19.
- (80) Shiko: “Menhexh et Terbiye en Nebeëije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 139.
- (81) Shiko: “Gars usulul iman fi nefs et tifël” Dr. Sherife el Hazimij, f. 34-45; shiko: “Es Suneh en Nebevijeh - Ru’je terbevijeh” Dr. Said Ali, f. 406.
- (82) Shikoje kapitullin e tretë të librit: “El Kisatu fi mexhalat el atëfel ue devruhe fi tenshi’etil atëfel el ixhtimaijeh” Dr. Emel Hamedij Dekek, el Hejetu el Ameh es Suriyeh lil kitab, Damask, botimi i katërt, 2012.
- (83) Shiko: “Menhexh et Terbiye en Nebeuije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 110, 370; shiko: “Eselib er Resul ﷺ fi terbijetil usreti el muslim” Shafi el Hamidij, f. 21. Mund të përfitohet, po ashtu, nga libri “Kasas ravahe en Nebiju Muhamed ﷺ” Dr. Uthman Makanisij, dhe nga libri “30 kisah bilisen Muhamed ﷺ” Asim esh Shajiu.

- (84) Shiko: “Eselib er Resul ﷺ fi terbijetil usreti el muslim” Shafi el Hamidij, f. 46-55; shiko: “Es Suneh en Nebevijeh - Ru’je terbevijeh” Dr. Said Ali, f. 343.
- (85) Shiko: “Menhexh et Terbije en Nebeëije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 102; dhe shiko: “Mavakif terbevijeh min hedjin Nebeij ﷺ me’al atëfel” Dr. Abdulmexhid el Bejanunij f. 38.
- (86) Shënon Buhariu (5997)
- (87) Shënon Ebu Davudi (4941), ndërsa Albanin e vlerëson si të saktë.
- (88) Shënon Buhariu (5809)
- (89) Shënon Buhariu (6116)
- (90) “Terbijetun Neshi’eh fil Kuran el Kerim” Sabah et Talejan (f. 211-226); shiko: “Et Terbije fis sunetin nebevijeh” Ebu Lubebe Husejin, f. 47; shiko: “Asalibur Resul ﷺ fid dauve uet terbiye”, f. 15.
- (91) Mund të përfitohet në mësimin e besimit në formë të thjeshtësuar dhe përmbledhur nga libri: “Hedhihi akideti” Dr. Tarik el Bekrij, mexheletul fetih, (nr. 142) dhe nga “Es’ileh fil akide lil atëfel” e publikuar në ueb-faqen: alukah.net, si dhe nga pjesa e dytë e librit: “Akidetut tifëli el muslim” Lehjem Mahmud.
- (92) “El Eselib en Nebevijeh litenmijetil kajim el imanijeh ledesh shebab el muslim fi dau’i et tahadijat el muasirah” Et Tajib Ahmed esh Shenkitij, f. 84-85.
- (93) Shiko: “Kejfe nuhib Allah ue neshtak ilejhi” Mexhdij el Hilalij, f. 14.
- (94) Shiko: “Terbijetit tifëli fil Islam” Sima Ebu Ramuz, f. 50; shiko: “Atëfeluna ue hubu Allah xhele xhelehu” Dr. Amanij er Ramedij, portali: saaid.net; shiko: “Kejfe nuhib Allah ue neshtak ilejhi” Mexhdij el Hilalij, f. 22.
- (95) “El Murabune ue teseulat el atëfel” Nevel el Halifeh, f. 36-39.
- (96) “Xhevenib et terbiye el islamije el esesijeh” Mikdad Jelxhin, f. 147.
- (97) Shiko: “Terbijetun Neshi’eh fil Kuran el Kerim” Sabah et Talejan, f. 34-43; shiko: “Gars muhabete Allah fi nufus el mudëuvin” Dr. El Xhevhirah et Tarifij, f. 18.
- (98) Shiko: “Gars muhabete Allah xhele xhelehu fi nufus el mudëuvin” Dr. El Xhevhirah et Tarifij, f. 10.
- (99) “Kejfe tekuluhe li atëfelik” Paul Colman, f. 157-158. Mund të përfitohet gjithashtu nga libri: “Adhamet Allahi tea’la ue xhele ue azz” Dr. Muhamed esh Sherif.

- (100) Shiko: “Et Terbiye el Aka’idijeh” Dr. Muhamed Haxh el Xhezairij, ueb-faqja: islahway.com; shiko: “Menhexh et Terbiye en Nebevije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 212.
- (101) Shiko: “Gars muhabete Allah xhele xhelehu fi nufus el mudëuvin” Dr. El Xhevhirah et Tarifij, f. 14.
- (102) Shiko: “100 vesileh lijubuka Allah ue Resuluhu” Sejid Mubarak, f. 5.
- (103) Shënon Muslimi (2996)
- (104) “Terbijetun Neshi’eh fil Kuran el Kerim” Sabah et Talejan, f. 43-44;
- (105) Shënon Muslimi (564)
- (106) Për më shumë mund të shfletohen librat të cilat flasin për besimin ne engjëjt, prej tyre mund të cekim: “Alemul Melaiketel ebrar” Dr. Omer el Eshkar, “Alemul Melaike fi dau’is suneh en nebevijeh - diraseh mevduijeh” Nebil Ebu el Umurejni, punim diplome të gradës së masterit në Universitetin e Gazës, e publikuar në internet; gjithashtu libri “Ehemijetil iman bil melaikeh ue aletetuhe en nefsije el ixhtima’ijeh el halkijeh” Dr. Mahmud Seadet, ueb-faqja: alukah.net.
- (107) Shiko: “Alemul Melaiketel ebrar” Dr. Omer el Eshkar, f. 6.
- (108) Për më shumë mund të shfletohet libri “El Iman bil kutub” i hoxhës tonë Dr. Muhamed el Hamed dhe libri: “El Iman bil kutub” Ahmed en Nexhar.
- (109) “Tealim et tefkir” Sejf el Aiseveij, f. 121.
- (110) “Min el Ethar el imanijeh litealim ue tealum el Kuran el kerim ala el ferdi uel muxhteme’a” dr. Shaban Mukalid, ueb-faqja: alukah.net (13.6.1430 hixhrij); shiko: “Usus bina shahsijetit tifël el muslim”, Ali esh Shuhud, f. 46.
- (111) Shënon Muslimi (804)
- (112) Shënon Tirmidhiu (2914), ndërsa Albani e vlerëson si të mirë.
- (113) Shënon Buhariu (5427)
- (114) Shënon Buhariu (5027)
- (115) Shiko: “Et Terbijetil aka’idjeh” Dr. Muhamed Haxh el Xhezairij, ueb-faqja: islahway.com; shiko: “Menhexh et Terbiye en Nebevijeh lit tiftl”, Muhamed Suvejid, f. 378.
- (116) Që ta njohim ndikimin e vendmësimeve të Kuranit në formimin e personalitetit të fëmijës dhe zhvillimit të tyre, shiko: “Devru el hallakat el kuranijeh fi tenmijetj shahsijeti tifël el muslim” Abdullah Muhamed Henenu.

- (117) Shiko: “Tifëlu ibtide’ij ue turuk terbijetuhu ilmijen” Mu’tez Shehejn, ueb-faqja almoslim.net (7.7.1432 hixhrij)
- (118) Shiko: “Et terbiye el Aka’idijeh” Dr. Muhamed Haxh el Xhezairij, ueb-faqja: islahway.com; shiko: “Meherat tahbib atëfelena fil Kuran” Amina Muhamed, Mexheletul va’jul islamij (nr. 556); shiko: “Menhexh et Terbiye en Nebevije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 232.
- (119) Për më shumë mund të shfletohen librat: “Er Resul ue er Risalat” Dr. Omer el Eshkar, dhe “El Mebahith el Akadijeh el Mutealikah bil Imani bir Resul” të Ahmed en Nexhar, dhe “el Iman bir Resul ue er Risalat” Dr. Ali es Salabij.
- (120) Shiko: “Mexhmu’ul fetava ue rasail” të shejh Muhamed ibn Salih el Uthejmin, f. 145.
- (121) Shiko: “Devrul enshitah gajrus safijeh fi tenmijeti hub en Nebeij ﷺ lede telmidhat el merhaletil ibti’daijeh” Feuzijeh el Bakemij, f. 92, 98, 99.
- (122) Mund të përfitohet nga libri: “T’nejetur Resul ﷺ bil mer’atu uet tifël” të Muhamed Mus’ad Jekut dhe nga punimi shkencor: “Rahmetur Resul ﷺ bil hajavanat uet tajër” Dr. Hudhejfe es Semira’ij.
- (123) Shiko: “Devrul enshitah gajrus safijeh fi tenmijeti hub en Nebeij ﷺ lede telmidhat el merhaletil ibti’daijeh” Feuzijeh el Bakemij, f. 84.
- (124) Mund të përfitohet nga libri “Kejfe a’melehum” të Muhamed el Munexhid, f. 301, 691, 761 dhe nga libri “Er Rrahmetu fi hajetir Resul ﷺ”, f. 65.
- (125) “Te’amelus Resul ﷺ me’al atëfel terbevijen” Dr. Hisah es Sagir, f. 75-77; dhe mund të përfitohet nga libri “El Atlas et terihij siratir Resul ﷺ” Samij el Magluth, f. 199.
- (126) “Terbijetun Neshi’eh fil Kuran el Kerim” Sabah et Talejan, f. 44-59; shiko edhe: “Menhexh et Terbiye en Nebevije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 219; shiko edhe: “Usus bina shahsijetit tifël el muslim” Ala esh Shuhud, f. 22; shiko: “Devrul enshitah gajrus safijeh fi tenmijeti hub en Nebeij ﷺ lede telmidhat el merhaletil ibti’daijeh” Feuzijeh el Bakemij, f. 88.
- (127) Shiko: “Et Tifël fi sheriah el islamijeh ue menhexh et terbijetin Nebevijeh” Siham Xhabar, f. 252.
- (128) Shënon Buhariu (5439)
- (129) Shiko: “E’adham insan arefet’hul besherijeh” Hisham Bergush (f. 152), shiko: “Hamsun mevkifen lin Nebij ﷺ me’as sigar”, të Dr. Ibrahim el Vedan, f. 19.
- (130) Shënon Buhariu (3688)

- (131) Shiko: “Et Terbeijetu el Aka’idejeh” të Dr. Muhamed Haxh el Xhezairij, portali <http://islahway.com>; po ashtu shiko edhe: “Kejfe uresih huben Nebij fi kalb veledij” Halid Rusheh, ueb-faqja: saaid.net; shiko: “Atëfeluna ue hub Resululullah ﷺ” Dr. Amanij er Ramedij, portali: saaid.net; si dhe: “E’adham insan arefet’hul besherijeh” Hisham Bergush, f. 151.
- (132) “Gars usul el-iman fi nefsi et-tifl,” Dr. Sherife el-Hazimij, f. 124.
- (133) “El Murebun ue teseulat el atëfel”, Nevel el Halifeh, f. 119-121.
- (134) Për më shumë mund të shfletohet libri “El Iman bil jevmil ahir” të Dr. Muhamed el Hamed, si dhe libri: “El Iman bil jevmil ehar ue etheruhu fi hajetil muslim”, Abdullah el Etherij.
- (135) “Gars usul el-iman fi nefsi et-tifl,” Dr. Sherife el-Hazimij, f. 128.
- (136) E shënon Tirmidhiu (nr. 2516) dhe thotë se është hadith hasen-sahih.
- (137) E shënon Ahmedi (2803)
- (138) “Terbijetun Neshi’eh fil Kuran el Kerim” Sabah et Talejan, f. 33; shiko: “Ihfedhilah jahfedhk” Muhamed ed Dubejsij, f. 8; shiko edhe: “Hamsun mevkifen lin Nebij ﷺ me’as sigar”, të Dr. Ibrahim el Vedan, f. 25.
- (139) Shiko: “Et Tifël fi sheriah el islamijeh ue menhexh et terbijetin Nebevijeh” Siham Xhabar, f. 249.
- (140) Shiko: “Terbijetut tifëli fil Islam” Sima Ebu Ramuz, f. 70; për më shumë mund të përftohet nga libri “El Iman bil kada uel kader” i hoxhës tonë Dr. Muhamed el Hamed; si dhe nga libri: “El Kada uel kader” të Omër el Eshkar.
- (141) Shiko: “Te’sis aklijetil tifël” Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 10.
- (142) Shiko: “El Kavaid el ashër - ehem el kavaid fi terbijetil ebëna” të Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 33.
- (143) Shiko: “Te’sis aklijetil tifël” Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 16.
- (144) Shiko: “El Es’iletul aka’idijeh andel atëfel ue ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 11.
- (145) Shiko: “El Kavaid el ashër - ehem el kavaid fi terbijetil ebëna” të Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 36.
- (146) Shiko: “Et Tifëlu ue hubul istitëla” Omer es Seb’iu, ueb-faqja: islammemo.cc (5.1.2012), shiko po ashtu: “Dirasat fi hubil istitëla uel ibde’a uel hajel” Dr. Shakir Abdulhamid dhe Abdulatif Halifeh, f. 33.

- (147) “Es’iletul atëfel el muhrexheh ue kejfijetil ixhebeh alejhe”, Dr. Mustafe Ebu Sa’d nga faqja e tij në facebook me datë (23.5.2014); shiko: “Havle fikh et terbiye ue fudul el me’arifeh” Dr. Abdurrahman Dhekir, ueb-faqja: artoflife.net (9.7.2014).
- (148) Shiko: “Es’iletul tifël ue alekatuhe bitenmijetil kudurat el akëlîjeh ue afakuhe indet tifël” Husejn Sebehij, ueb-faqja: alukah.net (1.12.1432 hixhrij).
- (149) Es’iletul atëfel el muhrexheh ue kejfijetil ixhebeh alejhe”, Dr. Mustafe Ebu Sa’d nga faqja e tij në facebook me datë (23.5.2014)
- (150) Shiko: “Es’iletul tifël ue alekatuhe bitenmijetil kudurat el akëlîjeh ue afakuhe indet tifël” Husejn Sebehij, ueb-faqja: alukah.net (1.12.1432 hixhrij).
- (151) Es’iletul atëfel el muhrexheh ue kejfijetil ixhebeh alejhe”, Dr. Mustafe Ebu Sa’d nga faqja e tij në facebook me datë (23.5.2014)
- (152) “Ilmu nefs el merahil el umurijeh” Omer el Mefda (f. 432)
- (153) “Kejfe tekuluhe li atëfelik” Paul Colman (f. 155); shiko: “Akidetut tifël el muslm”, Hejam Mahmud, f. 56.
- (154) Shiko: “Tiflue fir rabi’ah uen nisf” Hanij el Abdulkadir, almoslim.net (1.10.1428 hixhrij).
- (155) Shiko: “Es’iletul tifël ue alekatuhe bitenmijetil kudurat el akëlîjeh ue afakuhe indet tifël” Husejn Sebehij, ueb-faqja: alukah.net (1.12.1432 hixhrij).
- (156) Shiko: “Te’sis aklijetil tifël” Dr. Abdulkarim el Bekar, f. 78.
- (157) “Bernamixh mukterah litedrib mualimat er rovdah ala ixhebeh et teseulat el ilmijeh el muhrixheh ledel atëfel”, Prof. Dr. Mehîr Saberij, f. 7.
- (158) “Mukidemeh” e Ibn Haldunit, f. 545. (libri është i botuar në gjuhën shqipe nga sh.b. “Fjala e Bukur”).
- (159) “Kejfe uxhib ala es’ileti tifëli ue uhaviruhu” Dr. Selva Murteda, f. 21-22.
- (160) “El Hivar ue bina shahsijetit tifël” Selman Halfullah, f. 77. Shiko dhe: “Menhexh et Terbiye en Nebevije lit tifël” Muhamed Suvejid, f. 119. Po ashtu shiko: “Meharat et tavasul me’al evlad” Dr. Halid el Halebij, f. 31.
- (161) Shiko: “Istratixhijetul es’ileh lite’alim et tefkir”, Mahmud Tafish esh Shukejrat, ueb-faqja e tij personale; shiko edhe: “Istratixhjet et tedris fil karn el hadij uel a’ishrin” Dr. Dheukan Ubejdat dhe Dr. Suhejla Ebu es Sumejid, f. 218.
- (162) “Kejfe uxhib ala es’ileti tifëli ue uhaviruhu” Dr. Selva Murteda, f. 73-74.
- (163) “Kejfe turabi ebna’ek fi hedhe ez zeman”, Dr. Hasen Shemsi Basha, f. 122.

- (164) “Ibnij mukteshif - kejfe ea’inuhu ala ikteshefihi”, Mensur es Sinij, f. 33.
- (165) “Es’ileti tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harek, f. 10.
- (166) “Hel tifeli mulhid”, përgatitur nga Komisioni i Thirrjes Elektronike për në Islam.
- (167) “Es’iletul atëfel el muhrexheh ue kejfijetil ixhebeh alejhe”, Dr. Mustafe Ebu Sa’d nga faqja e tij në facebook me datë (23.5.2014).
- (168) “Kejfe uxhib ala es’ileti tifeli ue uhaviruhu” Dr. Selva Murteda, f. 73.
- (169) “El-murebun ue teseulat el atëfel” të Nevel el-Halifeh, f. 126-130.
- (170) Mund të përfitohet nga nga librat e veçantë për këtë lëmi, siç mund të cekim disa, p.sh.: “Kisas tekvin shahsijetit tifël”, Fejid Berakesh, apo libra tjerë shkencorë siç janë: “Silsileh es’ileh ue exhvibeh” të cilat i ka botuar shtëpia botuese “Alimul kutub” (deri tani janë botuar 16 libra); shikoje gjithashtu librin “Fëmija lexon” nga Abdulkerim el Bekar (i botuar në gjuhën shqipe nga sh.b. “Fjala e Bukur”), ku i propozon llojet e tregimeve për çdo periudhë të moshës së fëmijës. Po ashtu, shiko librin: “Kasas ravahe en Nebiju Muhamed ﷺ” dhe librin “Kasas ravahe es Sahabe” që të dy të Dr. Uthman Mekenesij.
- (171) “Minhexh tefekur me’a Unus: texhribeh xhedideh fi i’aded menehixh testenid ilat tefekur fi bina el akideh ue tenmijet tefkir lit tifeli” Maha Shehade, f. 7. Shiko dhe: “El Irtika bil umeh fi te’adhim muhabetin nebijil umeh ﷺ”, f. 6.
- (172) “Es’iletil atëfel el muhrexheh” Aishe el Hakemij, alukah.net (17.1.1434 hixhrij).
- (173) Shiko: “el Kavaid el ashër - ehem el kavaid fi terbijetil ebëna” të Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 35; shiko edhe: “El Ishkalije el Mu’asirah fi terbijetit tifel el muslim” Said Abduadhim, f. 59.
- (174) Shiko: “Ahtauna fit terbijë” Dr. Abdurrahman el Ajid, i cili i ka përmendur një numër të madh të gabimeve dhe shkaqet që shpiejnë në to; shiko: “Havil en teravidenij” Raj Lifi dhe Uebil Uhenlun, f. 223.
- (175) Edukatorët i ndajnë periudhat e fëmijërisë në tri etapa: e para: fëmijëri e hershme që zgjatë nga mosha 3 deri 5 vjec, pastaj e dyta: fëmijëri e mesme që zgjatë nga mosha 6 deri 8 vjec, dhe e treta fëmijëri e vonshme që zgjatë nga 9 deri 12 vjet.
- (176) Shiko: “el Es’iletul aka’idijeh andel atëfel ue ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush (fq. 27).

- (177) “Hel tifëli mulhid”, përgatitur nga komisioni i thirrjes elektronike për në Islam.
- (178) Shiko: “Ed Davetu meherat ue funun” Shehateh Sakër, f. 340.
- (179) Lexohet: Xhel-le xhelehu (I Lartësuar dhe Madhëruar është Allahu.)
- (180) Mund të përfitohet nga libri: “Axhaib halkullah” Omer el Eshkar.
- (181) Shiko: “Veseil et terbevijeh el imanijeh fi da’il ilmi uel felsefe uel Islam” Dr. Mikdad Jelxhun, “Mexheletul muslim el muasir” (nr. 5); shiko dhe: “El-murebun ue teseulat el atëfel” të Nevel el-Halifeh, f. 32; shiko dhe: “El Kuran el Kerim ru’jetun terbevijeh” Dr. Said Ali, f. 19.
- (182) Shiko: “Kejfe uxhib an es’ileti tifëlij?” Merva Ashur, alukah.net (19.2.1432 hixhrij); shiko dhe: “Ibnij mukteshif - kejfe ea’inuhu ala ikteshefihi”, Mensur es Sinij, f. 30; shiko dhe: “Kejfe uxhib ala es’ileti tifëli ue uhaviruhu” Dr. Selva Murteda, f. 21-22; shiko dhe: “El Es’iletul aka’idijeh andel atëfel ue ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 30, 31.
- (183) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 29; shiko dhe: “El Mulhid ue sueluhu el hati’u men halakaAllah” Dr. Rabia Ahmed, alukah.net (18.5.1436 hixhrij); shiko dhe “Es’iletu tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harak, f. 24; shiko dhe “Shumu’un Nehar” Abdullah el Uxhejrij, f. 151.
- (184) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 49.
- (185) Shënon Buhariu (3276).
- (186) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 55; shiko dhe “E filahi shekun?” Dr. Hamed el Merzukij, f. 129; shiko dhe “El Edile ala vuxhudilah uel hikmetu min halkihi lil ibad” islamqa.info (7.4.2002); shiko dhe “Kitabullahi fi neshët il akideh el ilahijeh” Abas el Ukad, f. 211, 222.
- (187) Besimi në zotërimin e Tij (rububije) nënkupton bindjen e palëkundshme se vetëm Allahu i Lartësuar është Zoti, Krijuesi, Sunduesi dhe Urdhëruesi. (Shënim nga përkthyesi).
- (188) Shiko: “Sherhul akide et tahavijeh” Ibn Ebil Iz el Hanefij, me recensim të Ahmed Shakir, f. 35.
- (189) Shiko: “el Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush (fq. 35), shiko dhe “el Kuran el kerim rujetun terbevijeh” Dr. Said alij (fq. 43), shiko dhe: “Es’iletul atëfel ue exhvibetul aba’i uel umuhat” Mexhdi es Sejid (fq. 22).

- (190) Shiko: “el Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush (fq. 35)
- (191) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 31; shiko dhe “Muhtesar el fikhi el islamij” Muhamed et Tuvejxhrij, f. 58.
- (192) Shënon Muslimi (537)
- (193) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 32, 45.
- (194) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 37; shiko dhe: “Kejfe tekuluhe li atëfelik” Paul Colman, f. 156; shiko dhe: “Minel jevm len tehrib min es’ileti tiflik el muhrexheh”, Abdullah Abulmuatij, f. 108.
- (195) “Minel jevm len tehrib min es’ileti tiflik el muhrexheh”, Abdullah Abulmuatij, f. 103.
- (196) “Minel jevm len tehrib min es’ileti tiflik el muhrexheh”, Abdullah Abulmuatij, f. 104; shiko dhe: “Kejfe uxhib an es’ileti tifëlij?” Merva Ashur, alukah.net (19.2.1432 hixhrij)
- (197) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 42.
- (198) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 54; shiko dhe: “Allahu hajun la jemut” Muhamed Ratib en Nebulsij, ueb-faqja: nabulsi.com
- (199) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 58; shiko dhe: “Etemene en juhibuni Rabij” Amina el Xhabir, ueb-faqja: almoslim.net (19.3.1433 hixhrij).
- (200) Shiko: “Alemul melaiketih el ebrar” Omer el Eshkar, f. 9, 12, 15, 16.
- (201) Shiko: “Alemul melaiketih el ebrar” Omer el Eshkar, f. 16.
- (202) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 90); shiko dhe: “Alemul melaiketih el ebrar” Omer el Eshkar, f. 35, 52, 77); shiko dhe: “Muhadarat fil iman bil melaikah alejhimus selam” Prof. Dr. Muhamed el Xhuhenij, f. 53.
- (203) Shiko: “Hakikatul melaikah” Ahmed en Nexhar, f. 54.
- (204) Shiko: “Alemul xhin uesh shejatin” Omer el Eshkar, f. 11, 12, 22.
- (205) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 98.

- (206) Shiko: “Alemul melaiketih el ebrar” Omer el Eshkar, f. 9; shiko dhe: “Hakikatul melaikah” Ahmed en Nexhar, f. 54.
- (207) Shiko: “El Iman bil kutub” Dr. Muhamed el Hamed, f. 4-5.
- (208) Shiko: “El Islam ue mukteshafat el ilmil hadith” Muhamd es Sejid Muhamed, f. 4; shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 105; shiko dhe: “El Iëxhez el bejanij lil Kuran el kerim erkenuhu ue madhahiruhu” Dr. Husejn et Terturij, “Mexheletul islamijeh”, nr. 23, f. 225; shiko dhe: “Iëxhez el Kuran el bejanij ue delail masdaruhu er Rabenij” Dr. Salah el Halidij, f. 5.
- (209) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 105.
- (210) Shiko: “El Ediletul akëlijeh uet terihijeh ala sihati ue hifdhil Kuran el kerim” Qendra për Fetva nga ueb-faqja: islamweb.net, (21.5.2001); shiko dhe “El Ediletu ala enel Kuran kelamu Allah” Muhamed el Munexhid, islamqa.info (5.11.2001)
- (211) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 123; shiko edhe “Hikmetu irsel er Rusul” Muhamed el Uthejmin, ueb-faqja: islamëay.net.
- (212) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 131; shiko dhe: “Ismetul enbija” Muhamed ed Delimij, f. 4.
- (213) Shiko: “Usulud din el Islamij” Muhamed et Tuvexhrij, f. 74.
- (214) Shiko: “Dalail en Nubueh” Munkadh es Sekar, f. 4, 9, 18, 48, 105, 112, 128.
- (215) Shiko: “Atëfeluna ue hubur Resul ﷺ” Dr. Emanij er Ramedij, ueb-faqja: saaid.net; shiko dhe: “Mehabetun Nebij ﷺ ue te’adhimu” Abdullah el Hudejrij dhe Abdulatif el Hasen, f. 53-58.
- (216) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 68; shiko dhe: “El Jevmel ahir” Muhamed et Tuvexhrij, f. 6.
- (217) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 67.
- (218) Shiko: “Tifluke ue es’iletuhu el haraxheh”, Shehijnez Abdulfetah, f. 76; shiko dhe: “Es’iletu tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harak, f. 168.
- (219) Shiko: “Es’iletu tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harak, f. 170; shiko dhe: “Tifluke ue es’iletuhu el haraxheh”, Shehijnez Abdulfetah, f. 77.

- (220) Shiko: “Minel jevm len tehrub min es’ileti tiflik el muhrexheh”, Abdullah Abulmuatij, f. 109; shiko dhe: “Ibnij mukteshif - kejfe ea’inuhu ala ikteshefihi”, Mensur es Sinij, f. 7; “Kejfe uxhib ala es’ileti tifeli ue uhaviruhu” Dr. Selva Murteda, f. 103-104.
- (221) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 79.
- (222) Shiko: “Es’iletu tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harak, f. 168; shiko dhe: “Es’iletil atëfel el muhrexheh” Aishe el Hakemij, alukah.net (17.1.1434 hixhrij); shiko dhe: “Kejfe tekuluhe li atëfelik” Paul Colman, f. 156-157.
- (223) Shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 81; shiko dhe: “Mesir el hajavanat jevmel Kijameh” Muhamed el Munexhid islamqa.info (31.5.2001).
- (224) Shiko: “El Iman bil kada uel kader” Dr. Muhamed el Hamed, f. 36.
- (225) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 145. Shiko dhe: “Ihfadhilahe jahfedhk” Muhamed ed Dubejsi, f. 71-72). Shiko dhe: “El Iman bil kada uel kader” Dr. Muhamed el Hamed, f. 185.
- (226) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 156.
- (227) Shiko: “El Iman bil kada uel kader” Dr. Muhamed el Hamed, f. 130-134.
- (228) Shiko: “El Hikmetul min halkil hajavan uel nebat kablel insan” Qendra për Fetva në ueb-faqen: islamweb.net (18.5.2006).
- (229) Shiko: “El Kavaid el ashër - ehem el kavaid fi terbijetil ebëna” të Dr. Abdulkerim el Bekar, f. 21-22.
- (230) Shiko: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 155.
- (231) Shiko: “Rudud ala shubuhut muteadideh” Qendra për Fetva në ueb-faqen islamweb.net (7.6.2008).
- (232) Shiko: “El Murebun ue teseulat el atëfel” të Nevel el Halifeh, f. 96; shiko dhe: “El Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush, f. 160.
- (233) Shiko: “El Iman bil kada uel kader” Dr. Muhamed el Hamed, f. 152-160; shiko dhe: “Limadha halaka Allahu el insan?” Dr. Muhamed Ratib en Nebulsij, nabulsi.com.

-
- (234) Shiko: “Es’iletu tiflik el haraxheh” Ebu el Mexhd Harak (fq. 31), shiko dhe “el Hikmetu min halkil hajavan ed Darah”, Muhamed el Munexhid, islamqa.info (26/6/1999).
- (235) Shiko: “el Iman uel hajet” Dr. Jusuf el Kardavij (Fq. 6).
- (236) Shiko: “el Vebil es Sajib” Ibn el Kajim (fq. 234).
- (237) Shiko: “Es’iletu tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harak (fq. 32), shiko dhe “el Murebun ue teseulat el atëfel” të Nevel el Halifeh, (fq. 35). Shiko dhe: “el Es’iletul akadijeh indel atëfel uel ixhebeh alejhe” Dr. Besam el Amush (fq. 148, 151).
- (238) Shiko: “Es’iletu tiflik el harexheh” Ebu el Mexhd Harak, f. 35; shiko dhe: “Minel jevm len tehrub min es’ileti tiflik el muhrexheh”, Abdullah Abulmuatij, f. 111.
- (239) Shiko: “El Murebun ue teseulat el atëfel” të Nevel el Halifeh, f. 95.
- (240) E ka shënuar Albani në Sahih el Xhemiu (992).
- (241) Shiko: “Kejfe tekuluhe li atëfelik” Paul Colman, fq. 156; shiko dhe: “Idhe ehaba Allahu abden ibëtelehu, fehel hedhe sahih?” Ibn Bazi (Allahu e mëshiroftë!) në ueb-faqen e tij: binbaz.org.sa
- (242) Shiko: “Mede te’thir el beramixh el i’alemiyeh ala tesavurat el atëfel el imanijeh” Dr. Bedër el Azemij, Dr. Fehd el Lemiu, f. 24.



عرض تعريف من مركز أصول
ومجالاته وخدماته.. مشاهدة ممثلة لك



osoulcenter    
+966504442532
www.osoulcenter.com



Natyrish, vitet e para të fëmijërisë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e vizionit të fëmijës për ekzistencën, me ç'rast botëkuptimet të cilat mbillen në mentalitetin e fëmijës gjatë kësaj faze llogariten si blloqet themelore të cilat më vonë do ta ndërtojnë personalitetin e njeriut në të gjitha aspektet, andaj ato duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesat psikologjike, sociale dhe shpirtërore (fetare) që i ka fëmija. Ato janë të rëndësishme në ndërtimin e plotë të fëmijës, duke e ndihmuar atë që të niset me këmbëngulje për t'i kaluar me sukses peripecitë e jetës, për të vazhduar më tutje nëpër shtigjet e saj si një person i balancuar, produktiv dhe aktiv. Fëmija e ndërton modelin e tij personal të kësaj bote përmes asaj që sheh dhe dëgjon, duke bërë që çdo gjë që mbetet pas kësaj, prej jetës së tij, s'është tjetër veçse proces i gdhendjes dhe përmirësimit të këtij vizioni esencial, varësisht prej rrethanave nëpër të cilat ai kalon.



osoulcenter



www.osoulcenter.com

To Download This Book, please Visit:



OSOUL osoulstore.com

